



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2020

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 2 1

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2020

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Bordit	13
Fjala hyrëse e Guvernatorit	15
Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv	18
Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2020	21
1. Përmbledhje ekzekutive	22
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik	28
2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	28
3. Ekonomia e Kosovës.....	32
3.1. Sektori real	32
3.2. Sektori fiskal	36
3.3. Sektori i jashtëm.....	36
3.4. Sektori financiar	39
3.5. Projektionet makroekonomike për vitin 2021	54
4. Licencimi dhe rregullimi i sistemit financiar	56
4.1. Licencimi	56
4.2. Rregullimi	61
4.3. Korniza rregullative për IMF dhe IFJB	64
4.4. Korniza rregullative për siguruesit.....	64
4.5. Korniza Rregullative për Fondet Pensionale.....	65
5. Mbikëqyrja e sistemit financiar	66
6. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun	71
6.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme	71
6.2. Sistemi i Pagesave.....	78
6.3. Menaxhimi i Mjeteve	85
6.4. Teknologjia Informativë	91
6.5. Regjistri i Kredive të Kosovës	91
6.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar	93
6.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2020.....	94
6.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja.....	95
7. Zhvillimet e Brendshme	97
7.1. Auditimi i Brendshëm	97
7.2. Burimet Njerëzore	98
7.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së.....	99
7.4. Funkcioni i Menaxhimit të Rrezikut	100
8. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.....	102

8.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare	102
8.2. Komunikimi dhe Edukimi Financiar.....	103
8.3. Asistenca teknike	104
8.4. Integrimet Evropiane	106
9. Pasqyrat Financiare	109
10. Shtojca statistikore	161

LISTA E SHKURTESAVE

ACH	Sistemi Automatik i Pagesave Individuale (Automated Clearing House)
AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
APR	Asetet e Peshuara ndaj Riskut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambientit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. Euroepan Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	Drejtorati Gjeneral për Statistika Evropiane
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve

GBP	Poundi britanik (angl. the British pound sterling)
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
ICAAP	Procesi i Brendshëm i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. the Internal Capital Adequacy Assessment Process)
IÇI	Indeksi i Çmimeve të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IHH	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IJSHEF	Institucione Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IOPS	Organizata Ndërkombëtare për Mbikëqyrje të Pensioneve (angl. International Organisation of Pension Supervisors)
KEDS	Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës SH.A
KJP	Kreditë Joperformuese
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMB	Komercijalna Banka
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Autopërgjegjësisë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NREK	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PCB	Procredit Bank
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (angl. European System of Central Banks)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar

SEPA Area)	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pagese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Franga zvicerane (angl. Swiss Franc)
SRK	Sistemi i Regjistrit të Kontabilitetit
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommunication
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (angl. United Nations Mission in Kosovo)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

LISTA E GRAFIKËVE

1.	Shkalla e inflacionit në Eurozonë -----	29
2.	Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor -----	30
3.	Rritja vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor -----	31
4.	Norma e rritjes së BPV-së reale -----	32
5.	Norma e inflacionit -----	33
6.	Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë -----	33
7.	Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	33
8.	Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial -----	34
9.	Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë -----	34
10.	Regjistri i bizneseve -----	34
11.	Struktura e ndërmarrjeve të reja -----	34
12.	Eksportet, importet dhe bilanci tregtar -----	37
13.	Struktura e eksporteve sipas kategorive -----	37
14.	Struktura e importeve sipas kategorive -----	38
15.	Remitencat -----	38
16.	Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve -----	39
17.	Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës -----	39
18.	Asetet e bankave komerciale -----	40
19.	Norma vjetore e rritjes së kredive -----	41
20.	Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	41
21.	Kreditë sipas sektorëve ekonomikë -----	42
22.	Stoku i kredive, sipas sektorëve ekonomikë -----	42
23.	Struktura e depozitave -----	43
24.	Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	43
25.	Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	44
26.	Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve të ekonomisë -----	44
27.	Norma mesatare e interesit në depozita -----	44
28.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	44
29.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	44
30.	Profiti neto i sektorit bankar -----	45
31.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	45
32.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	45
33.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	46
34.	Asetet e sektorit pensional -----	46
35.	Investimet e FKPK-së -----	46
36.	Investimet e FSKP-së -----	47
37.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	47

38.	Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	49
39.	Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	51
40.	Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive-----	52
41.	Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomikë-----	52
42.	Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	52
43.	Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar-----	53
44.	Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë -----	53
45.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	53
46.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	53
47.	Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	53
48.	Struktura e sistemit financiar në Kosovë-----	57
49.	Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave-----	57
50.	Shpërndarja e popullësisë në Kosovë sipas regjioneve -----	57
51.	Rrjeti i siguruesve-----	58
52.	Furnizimi me para të gatshme-----	71
53.	Pranimi i parave të gatshme -----	71
54.	Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve -----	72
55.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve -----	72
56.	Pranimi i kartëmonedha euro sipas denominimeve-----	73
57.	Pranimi i monedha euro sipas denominimeve -----	73
58.	Eksporti i parave të gatshme -----	73
59.	Importi i parave të gatshme -----	73
60.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi-----	74
61.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	74
62.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim -----	74
63.	Kartëmonedhave të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara -----	74
64.	Kartëmonedha euro të falsifikuara në qarkullim sipas viteve -----	75
65.	Kartëmonedha euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve -----	75
66.	Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse-----	76
67.	Vlera e transaksioneve vendore dalëse-----	76
68.	Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse-----	76
69.	Vlera e transaksioneve vendore hyrëse -----	76
70.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse -----	77
71.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse -----	77
72.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse -----	77
73.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse -----	77
74.	Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së -----	78
75.	Numri i transaksioneve në SPN-----	79
76.	Vlera e transaksioneve në SPN-----	79

77.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SPN-----	80
78.	Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SPN -----	80
79.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre -----	80
80.	Vlera vjetore e transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre -----	80
81.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SPN-----	81
82.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SPN-----	81
83.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit-----	83
84.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit -----	83
85.	Numri i terminaleve ATM-----	83
86.	Numri i terminaleve POS-----	83
87.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	83
88.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave-----	83
89.	Portofolio e rezervave të BQK-së-----	86
90.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së -----	87
91.	Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara sipas gjendjes së tyre më 31 dhjetor të viteve përkatëse -----	87
92.	Shpërndarja e portofolios investuese në çdo fundvit -----	88
93.	Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit-----	89
94.	Struktura e investitorëve në ankande-----	90
95.	Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2018 dhe 2019 -----	90
96.	Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë në vitin 2020 -----	90
97.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së -----	92
98.	Numri i kredive të raportuara në sistemin e RKK-së-----	92
99.	Numri i kërkesave për raportet kreditore-----	92
100.	Struktura sipas edukimit-----	98

LISTA E TABELAVE

1.	Rritja reale vjetore e BPV-së reale -----	28
2.	Numri i institucioneve financiare -----	39
3.	Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	40
4.	Struktura e detyrimeve të sektorit bankar -----	42
5.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	48
6.	Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	48
7.	Prime e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	49
8.	Dëmet e paguara sipas klasave të biznesit -----	50
9.	Rezultati financiar -----	51
10.	Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave -----	58
11.	Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve -----	58
12.	Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	58
13.	Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike -----	59
14.	Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK -----	59
15.	Numri i ekzaminimeve në banka -----	66
16.	Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve -----	68
17.	Numri i ekzaminimeve -----	68
18.	Numri i ekzaminimeve -----	69
19.	Numri i ankesave gjatë tri viteve të fundit -----	70
20.	Numri i ankesave sipas statusit të ankesës -----	70
21.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	75
22.	Niveli i depozitave të klientëve kryesorë -----	77
23.	Përqendrimi i pjesëmarrësve në SPN për transaksionet e iniciuara/dërguara -----	81
24.	Vendimet e procesuara në RLLB -----	81
25.	Numri i llogarive -----	84
26.	Numri i llogarive të parasë elektronike -----	84
27.	Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave -----	84

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Fjala e Kryetarit të Bordit

Në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe me qëllim të informimit të publikut të gjerë, gjithnjë në frymën e standardeve më të larta të transparencës dhe llogaridhënies, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka hartuar Raportin Vjetor për vitin 2020. Ky Raport përfshin në detaje aktivitetin e BQK-së për vitin 2020 dhe një pasqyrë adekuate me të dhëna të rëndësishme për sistemin financiar të vendit. Po ashtu i njëjti përmban të dhëna të rëndësishme të zhvillimeve ekonomike të vendit, të rajonit dhe atyre globale.

BQK ka arritur të përmbush me sukses agjendën e saj kushtetuese dhe ligjore edhe përkundur rrethanave të pandemisë globale Covid 19 të cilat e kanë shoqëruar vitin 2020. Funkcioni dhe veprimtaria e saj gjatë kësaj periudhe është shoqëruar nga vendimmarrja profesionale dhe transparente duke respektuar parimin e ligjshmërisë si dhe standardet, parimet dhe praktikatat më të mira të qeverisjes korporative, pavarësisë funksionale dhe llogaridhënies institucionale.

Bordi i BQK-së (Bordi) si organi më i lartë vendimmarrës, në vitin 2020 ka realizuar me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e tij të parapara me legjislacionin në fuqi. Ndërlidhur me këtë, Bordi ka dhënë kontribut të rëndësishëm në avancimin e legjislacionit sekondar për sektorin financiar të vendit, si dhe ka ngritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësiave nga organet tjera vendimmarrëse të BQK-së. Në këtë kontekst, Bordi ka luajtur rol vendimtar në fuqizimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me organet tjera vendimmarrëse, gjë që ka rezultuar me efikasitet të plotë në përmbushjen me sukses të politikave në veçanti dhe veprimtarisë së institucionit në përgjithësi.

Zhvillimi i vazhdueshëm i sektorit financiar të vendit dhe zhvillimet e reja në rrafshin evropian dhe global kanë imponuar nevojën për avancim të infrastrukturës juridike (sidomos legjislacioni sekondar) për këtë sektor. Prandaj, Bordi gjatë vitit 2020 ka ndërmarrë veprime adekuate për t'iu përgjigjur nevojave dhe rrethanave faktike që ndërlidhen me avancimin e legjislacionit përkatës, ku vend kyç zënë harmonizimi i legjislacionit financiar të vendit me atë të Unionit Evropian dhe me standardet e parimet e institucioneve financiare ndërkombëtare. Vlen të theksohet se bashkëpunimi ndërkombëtar dhe zhvillimi i personelit edhe pse në rrethana të pandemisë Covid19 është mbështetur nga Bordi në koordinim me organet tjera vendimmarrëse në BQK (përmbushja e MSA-së, rekomandimeve nga institucionet financiare evropiane dhe ndërkombëtare, ndjekja e konferencave dhe trajnimeve virtuale etj).

Andaj siç u tha më sipër dhe siç vërehet në Raportin Vjetor 2020, përkundër sfidave dhe rrethanave të zakonshme dhe atyre të pandemisë Covid19, me masat dhe veprimet e ndërmarra gjatë vitit 2020, kemi arritur që sektorin financiar ta mbajmë stabil, të qëndrueshëm dhe konkurrues, si dhe me trend rritës në të gjithë komponentët e tij (kapitali, likuiditeti, kreditimi, depozitat, akterët financiar, produktet dhe shërbimet financiare dhe shfrytëzuesit e shërbimeve financiare). Këto zhvillime kanë mundur mbështetjen efikase të ekonomisë së vendit nga sektori financiar, ulje të vazhdueshme të kostos së ndërmjetësimit financiar, rritje të besimit të qytetarëve në sektorin financiar si dhe rritje të interesimit të investitorëve të huaj në këtë sektor.

Krejt në fund, sukseset dhe rezultatet e sipërpërmendura e po ashtu edhe ato të prezantuara në këtë Raport, i atribuohen bashkërisht personelit dhe organeve vendimmarrëse të BQK-së, të cilëve u jam mirënjohës dhe falënderues që edhe në këto rrethana arritën, që me sukses të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në veçanti dhe të BQK-së në përgjithësi.

Flamur MRASORI



Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore
të Republikës së Kosovës

Fjala hyrëse e Guvernatorit

Viti 2020 ishte një vit i veçantë, si rezultat i shfaqjes dhe përhapjes së pandemisë Covid-19. Ashtu sikurse në të gjithë botën edhe në Kosovë, masat e ndërmarra për pengimin e përhapjes së pandemisë Covid-19 e ndikuan edhe rënien e aktivitetit ekonomik, duke bërë që vendi të ballafaqohet me rënie ekonomike pas një periudhe mjaft të gjatë të rritjes. Ekonomia e Kosovës vlerësohet të ketë shënuar rënie prej 3.9 përqind në vitin 2020.

Gjatë vitit 2020, ekonomia e Kosovës vazhdoi të ketë stabilitet fiskal dhe të çmimeve. Borxhi publik në vitin 2020 ka arritur në 1.5 miliardë euro apo në 21.8 përqind të BPV-së. Niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit ka shënuar normën prej 0.2 përqind në vitin 2020. Lëvizja e çmimeve në Kosovë vazhdon të përcaktohet kryesisht nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e varësisë së lart të ekonomisë së Kosovës nga importet.

Sistemi financiar, përkundër vështirësive të shkaktuara nga situata pandemike, vazhdon të jetë stabil dhe të ketë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Sektori bankar gjatë vitit 2020 u zgjerua në 11 banka, si rezultat i licencimit të një banke të re në tremujorin e fundit të vitit.

Konform kushteve të reja të cilat u krijuan në ekonominë e vendit, në fillim të pandemisë, BQK-ja u tregua proaktive duke reaguar shpejt me qëllim që të ruhet funksionimi normal dhe qëndrueshmëria e sistemit financiar dhe në të njëjtën kohë, të vihet sistemi financiar në shërbim të ekonomisë.

Që në ditët e para të masave kufizuese, BQK-ja aktivizoi Ekipin e Vazhdimësisë së Punës, i cili kishte për detyrë të monitorojë dhe të japë udhëzime që sigurojnë mbarëvajtjen e funksioneve të BQK-së dhe të sistemit financiar në përgjithësi. Në këtë mënyrë, gjatë gjithë kohës u sigurua funksionimi i rregullt i sistemit të pagesave dhe furnizimit me para të gatshme në mbarë vendin, përfshirë këtu edhe zonat të cilat kanë qenë të izoluara për një periudhë më të gjatë kohore.

Me qëllim të ballafaqimit në mënyrë sa më efektive me kushtet e krijuara, BQK-ja në vazhdimësi është koordinuar me të gjitha institucionet e Kosovës, institucionet financiare në Kosovë, odat ekonomike, si dhe institucionet financiare ndërkombëtare, duke mbajtur takime shumë të shpeshta për të siguruar ndërmarrjen e masave adekuate dhe në kohën e duhur kundrejt nevojave të ekonomisë.

BQK-ja që nga fillimi i pandemisë ishte pjesë e grupit ndërinstitucional për disenjimin e masave emergjente për t'i dalë në ndihmë ekonomisë dhe më pas edhe për të hartuar planin e rimëkëmbjes ekonomike. Si rezultat i komunikimeve tona të vazhdueshme është aprovuar RFI (Rapid Financing Instrument) nga FMN-ja, në shumë prej 52 milionë eurosh për të mbuluar nevojat urgjente dhe të përkohshme të bilancit të pagesave si rezultat i pandemisë COVID -19.

Po ashtu, pas koordinimit me bankat qendrore të regjionit, Banka Qendrore Evropiane ka aprovuar kërkesën e BQK-së për të vendosur një linjë financimi repo në shumë prej 100 milion eurosh. Kjo linjë e financimit i mundëson BQK-së të huazojë likuiditet në valutën euro nga Eurosistemi, për t'i adresuar nevojat e mundshme të likuiditetit për institucionet financiare në Kosovë në rast të mosfunksionimit të tregjeve për shkak të pandemisë COVID -19.

Duke parë se ekonomia e vendit po hynte në një krizë të theksuar, ku bizneset dhe qytetarët po ballafaqoheshin me vështirësi të mëdha financiare, BQK-ja duke u bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe në bashkëveprim me institucionet kredidhënëse në Kosovë, ndërmori një varg masash për të ndihmuar ekonominë, që të përballojë në mënyrë sa më të lehtë sfidat e kësaj krize.

Këto masa fillimisht konsistuan në aplikimin e moratoriumit për pagesat e kredive pa asnjë masë ndëshkuese për të gjithë huamarrësit, që janë ndikuar negativisht nga pandemia. Ky moratorium përkohësisht i ka liruar kredimarrësit nga ngarkesa e pagesës së kredisë, duke e përmirësuar kështu pozitën e tyre të likuiditetit për financimin e nevojave të tjera. Deri në maj të vitit 2020, 1.95 miliard euro ose 63.5% e totalit të portofolit kreditor aplikuan për moratorium të kredive ndërsa shkalla e aprovimit të këtyre aplikimeve ishte mbi 95% apo 1.87 miliard euro.

Pas përfundimit të periudhës së moratoriumit, BQK-ja ka publikuar udhëzuesit për ristrukturimin e kredive me qëllim të vendosjes së kritereve në të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredive për huamarrësit, që kanë hasur në vështirësi financiare si pasojë e pandemisë. Udhëzuesit për ristrukturimin e kredive kanë bërë të mundur që t'iu lehtësohet barra kreditore kredimarrësve pa implikuar ndonjë përkeqësim të klasifikimit të tyre në regjistrin kreditor të Kosovës.

Masat e ndërmarra nga BQK-ja u vlerësuan si shumë adekuate, si nga publiku vendor, ashtu edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar në raportin e Artikullit IV për Kosovën, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian.

Kontributi i sektorit bankar në mbështetje të ekonomisë ishte shumë i rëndësishëm edhe në aspektin e vazhdimin të kreditimit, përkundër ngritjes së nivelit të rreziqeve me të cilat u ballafaquan bankat dhe në të njëjtën kohë, të mbajë nivele të larta të likuiditetit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit. Sektori bankar vazhdon të ketë cilësi të mirë të portofolit kreditor me nivel të kredive joperformuese prej 2.7 përqind. Sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe atyre financiare jobankare gjithashtu ka vazhduar të ketë një ndikim të rëndësishëm në kreditimin e ekonomive familjare dhe bizneseve të vogla. Megjithatë, gjatë vitit 2020 portofoli kreditor i këtij sektori ka shënuar rënie vjetore prej 7.1 përqind. Rënia e aktivitetit të kreditimit në këtë sektor, përveç goditjes nga pandemia Covid-19 është e shkaktuar edhe si rezultat i revokimit të licencës së dy institucioneve mikrofinanciare, duke reflektuar edhe në portofolin kreditor.

Sektori pensional në vitin 2020 u karakterizua me ngadalësim të theksuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Në ngadalësimin e rritjes së aktivitetit të sektorit pensional ndikoi tërheqja e 10 përqind të mjeteve të Trustit nga kontributdhënësit, në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike. Për më tepër edhe kthimi negativ në investime gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 (si rezultat i efekteve të Covid-19 në ekonomi dhe tregjet financiare), ndikoi në ngadalësimin e aktivitetit të sektorit pensional. Por, humbjet e shkaktuara gjatë tremujorit të parë u kompensuan gjatë tremujorëve vijues, me kthim bruto në investime prej 160 milionë euro. Rrjedhimisht, sektori mbylli vitin me kthim pozitiv bruto nga investimet prej 72.3 milionë eurosh, pavarësisht përballjes me sfidën e shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Sektori i sigurimeve vazhdoi të ketë përmirësim që evidentohet me rritjen e shfrytëzimit të produkteve të sigurimeve në ekonominë tonë. Asetet e sektorit të sigurimeve, në vitin 2020 përfaqësuan 2.8 përqind të gjithë asetëve të sistemit financiar me një rritje vjetore prej 11.6 përqind, duke ruajtur nivelin e rritjes së vitit të kaluar që ishte në nivelin prej 11.8 përqind.

Në vazhden e aktiviteteve për rregullim të tregut të sigurimeve në vend, për shkak të gjendjes së rëndë financiare dhe mospërmbushjes së kërkesave ligjore, BQK-ja ka vendosur siguruesin Kosova e Re nën administrim të përkohshëm me qëllim të përmirësimit të gjendjes financiare të siguruesit.

Besueshmëria e konsumatorëve të shërbimeve financiare është një parakusht për një sistem financiar të shëndoshë. BQK mbetet e përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe ka vazhduar që me prioritet të lartë të trajtojë këtë fushë, duke shqyrtuar me kujdes të gjitha ankesat e konsumatorëve dhe të avancojë edukimin financiar të publikut.

BQK-ja ka një rol kyç në sigurimin e stabilitetit financiar dhe ka ndikim në parametrat kyçë të zhvillimit ekonomik. Për të arritur këtë BQK-ja me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë ka

vazhduar me avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të saj teknike dhe njerëzore, si dhe harmonizimin e kornizës rregullative me praktikat dhe standardet e vendeve të zhvilluara.

Në vijim, më lejoni të ju prezantoj Raportin Vjetor të BQK-së për vitin 2020, i cili ofron një pasqyrë të detajuar të zhvillimeve ekonomike dhe financiare, si dhe një përshkrim më të detajuar të aktiviteteve sipas funksioneve të ndryshme në BQK. Raporti po ashtu përmban raportin e auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare të audituara, të cilat konfirmojnë qeverisjen e mirë dhe menaxhimin efektiv dhe efikas të pasurive të BQK-së.

Fehmi MEHMETI



Guvernator i Bankës Qendrore
të Republikës së Kosovës

Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv

Bordi i Bankës Qendrore

Procesi i vendimmarrjes në Bordin e BQK-së udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës.

Aktivitetet e Bordit të BQK-së kanë qenë të orientuara në përmbushjen e kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Deri më 14 qershor 2020, Bordi i BQK-së ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat janë ushtruar kompetencat dhe detyrat e tij ligjore dhe rregullative.

Që nga data 15 qershor 2020 Bordi i BQK-së nuk ka pasur kuorum për punë të rregullt për shkak të përfundimit të mandatit të dy anëtarëve joekzekutivë, andaj aktiviteti i Bordit të BQK-së në gjysmën e dytë të vitit 2020 nuk ka mundur të ushtrohet sikurse përgjatë viteve të tjera.

Pas datës 15 qershor 2020, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e FMN-së, Kryetari i Bordit të BQK-së ka mbajtur takime informuese në baza të rregullta me menaxhmentin e BQK-së, Shefin e Auditimit të Brendshëm dhe sipas rastit edhe me anëtarin e jashtëm të Komitetit të Auditimit. Në këto takime, Kryetari i Bordit është informuar lidhur me operacionet dhe administrimin e BQK-së, duke përfshirë edhe auditimin e brendshëm.

Gjatë vitit 2020, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur gjithsej 8 mbledhje në të cilat janë marrë 26 vendime.

Bordi i Bankës Qendrore, si një nga organet vendimmarrëse të BQK-së, ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar bazuar në rekomandimet e Bordit Ekzekutiv, si në vazhdim:

1. Rregullore për Reklamimin e Shërbimeve Financiare;
2. Rregullore për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
3. Rregullore për Qeverisjen Korporative të Siguruesve;
4. Rregullore për Menaxhimin e Komisioneve dhe Shpenzimeve Operative të Siguruesve;
5. Rregullore për Dënimet me Gjobë për Siguruesit, Ndërmjetësuesit në Sigurime dhe Trajtuesit e Dëmeve në Sigurime;
6. Rregullore për Raportimin e Bankave;
7. Rregullore për Teknologji të Informacionit për Banka;
8. Rregullore për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja;
9. Rregullore për Regjistrimin e Institucioneve Financiare Jobankare;
10. Rregullore për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm;
11. Rregullore për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime;
12. Rregullore për Huadhënie Brenda-ditore dhe Njëditore;
13. Rregullore për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus;
14. Rregullore për Mbajtjen e Shënimeve në Fondet Pensionale dhe Ofruesit e Pensioneve;
15. Rregullore për Regjistrimin e Institucioneve Mikrofinanciare.

Bordi i Bankës Qendrore, gjithashtu ka miratuar:

- Raportin Vjetor të BQK-së për vitin 2019;

- Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2019 dhe Raportin e Auditorit të Pavarur;
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së për tremujorin e parë të vitit 2020;
- Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me ligj, Bordi i Bankës Qendrore me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin e BQK-së;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar;
- Zbatimin e aktiviteteve të nevojshme për përzgjedhjen e anëtarëve joekzekutiv të Bordit të BQK-së, dhe dërgimi i listave me kandidatët potencialë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për t'u përzgjedhur në pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së. Mirëpo përkundër kësaj, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka arritur të përzgjedh asnjërin nga kandidatët e propozuar për të plotësuar pozitën vakante në Bordin e BQK-së.

Gjithashtu, Bordi ka ushtruar edhe detyra të tjera, të cilat kanë qenë në harmoni me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2020, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Flamur Mrasori, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore;

Fehmi Mehmeti, Guvernator;

Gjatë tërë vitit 2020, 1 (një) pozitë e e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së ka qenë vakante, ndërsa nga data 15 qershor 2020 edhe 2 (dy) pozita të tjera të anëtarëve joekzekutivë të Bordit të BQK-së kanë qenë vakante.

Komiteti i Auditimit

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Statutin e Komitetit të Auditimit, vepron edhe Komiteti i Auditimit. Objektivat e Komitetit të Auditimit janë që të ndihmojë Bordin e Bankës Qendrore në lidhje me përmbushjen e përgjegjësive në relacion me veprimin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, kontrolleve të brendshme, etikën afariste dhe qeverisjen transparente, si dhe për raportin financiar të BQK-së.

Komiteti i Auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore dhe përbëhet prej tre anëtarëve (dy anëtarë joekzekutivë të zgjedhur nga radhët e Bordit të Bankës Qendrore dhe një anëtar - ekspert i jashtëm nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit).

Pas datës 15 qershor 2020, si rrjedhojë e skadimit të mandatit të dy (2) anëtarëve joekzekutivë të Bordit të BQK-së (të cilët ishin edhe anëtarë të Komitetit të Auditimit), ky organ ka mbetur jofunksional. Deri në këtë datë, Komiteti i Auditimit kishte këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Behxhet Brajshori, Kryetar i Komitetit të Auditimit;
2. Nuhi Ahmeti, Anëtar; dhe
3. Prof. Dr. Arben Dermaku, Anëtar i Jashtëm.

Gjatë periudhës sa ishte funksional (1 janar 2020 - 15 qershor 2020), KA-ja ka mbajtur gjithsej katër (4) takime. Në takimet e Komitetit janë trajtuar çështje të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me fusha të cilat gjenden nën fushëveprimin e tij në kontekst të rishikimit.

Komiteti i Auditimit, gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar një numër aktivitete, ndër të cilat:

- Ka shqyrtuar rezultatet e auditimit të prezantuara në raportet tremujore dhe vjetore të auditimit të brendshëm;
- Ka aprovuar Manualin e Auditimit të Brendshëm; si dhe ka rishikuar formularët standardë të auditimit të brendshëm;
- Ka vazhduar të kontribuojë në procesin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga vlerësues të jashtëm të pavarur dhe ka ndihmuar Menaxhmentin në këtë drejtim;
- Përmes raporteve të Auditimit të Jashtëm dhe Auditimit të Brendshëm ka dhënë siguri të arsyeshme lidhur me:
 - proceset e vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të tij, kontrollin e brendshëm dhe përgjegjësitë;
 - politikat kontabël dhe pasqyrat financiare;
 - përgjigjet e menaxhmentit sa i përket çështjeve të identifikuar nga Auditimi i Brendshëm dhe Auditori i Jashtëm, si dhe
 - ka zhvilluar aktivitete të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me fushëveprimin e tij.

Bordi Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv i BQK-së përbëhet nga Guvernatori, që është kryesues i Bordit Ekzekutiv dhe Zëvendësguvernatorët. Më 31 dhjetor 2020, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Fehmi Mehmeti, Guvernator, Lulzim Ismajli, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare dhe Sokol Havolli, Zëvendësguvernator për Mbikëqyrje Financiare. Kompetencat e Bordit Ekzekutiv janë të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Bordi Ekzekutiv është i ngarkuar me administrimin dhe ushtrimin e operacioneve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ndërsa aktiviteti i tij mbikëqyret nga Bordi i Bankës Qendrore.

Gjatë vitit 2020, Bordi Ekzekutiv ka mbajtur 33 mbledhje. Në kuadër të kompetencave të tij, Bordi Ekzekutiv gjatë vitit 2020 ka shqyrtuar dhe rekomanduar për miratim te Bordi i Bankës Qendrore rregulloret e aplikueshme për sistemin financiar të vendit, Raportin Vjetor të BQK-së, si dhe raportet, pasqyrat dhe planet financiare të BQK-së. Po ashtu gjatë vitit 2020, Bordi Ekzekutiv ka njoftuar rregullisht anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore mbi ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të dhëna.

Bordi Ekzekutiv në pajtim me legjislacionin në fuqi gjatë vitit 2020 ka miratuar katër udhëzime dhe dy udhëzues të aplikueshëm për sistemin financiar të vendit. Në të njëjtën sferë të kompetencave, Bordi Ekzekutiv në sektorin bankar ka miratuar licencimin përfundimtar të një banke të re, ndërsa në sektorin financiar jobankar ka miratuar regjistrimin e tetë institucioneve. Në anën tjetër, Bordi Ekzekutiv në vitin 2020 ka miratuar revokimin e regjistrimit të dy institucioneve financiare jobankare. Në të njëjtën periudhë, në funksion të arritjes së objektivave dhe duke u bazuar në detyrat mbikëqyrëse të realizuara nga njësitë organizative përgjegjëse, në shtatë raste janë miratuar masa ndëshkimore-administrative ndaj institucioneve financiare dhe palëve të lidhura. Në vitin 2020, Bordi Ekzekutiv ka miratuar raportimin periodik lidhur mbi zbatimin e planit strategjik të BQK-së për vitin 2019. Po ashtu Bordi Ekzekutiv ka miratuar nxjerrjen/ndryshimin dhe plotësimin e gjashtëmbëdhjetë politikave dhe rregullave të brendshme, si dhe ka mbikëqyrtuar raportimet e organeve të brendshme relevante për ushtrimin e kompetencave të tij. Bordi Ekzekutiv ka ushtruar edhe detyra të tjera në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

1. Përmbledhje ekzekutive

Ekonomia globale u përball me një ndër krizat më të mëdha në dekadat e fundit, e nxitur nga përhapja e pandemisë Covid-19 dhe masat e ndërmarra për të kufizuar përhapjen e saj. Mbyllja e kufijve dhe izolimi total i ekonomive goditi zinxhirin prodhues global, konsumin e përgjithshëm dhe tregtinë ndërkombëtare, duke shkaktuar rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik. Aplikimi i pakove mbështetëse fiskale pritet të peshojë mbi buxhetin e shteteve, përderisa perspektiva për periudhën në vazhdim mbetet e shoqëruar me pasiguri të larta si në aspektin e përmylljes së krizës shëndetësore, ashtu edhe të kostos mbi dinamikat ekonomike dhe sociale. Sipas BQE-së, ekonomia e Eurozonës për vitin 2020 është vlerësuar të jetë karakterizuar me tkurrje të aktivitetit prej 6.6 përqind, ndërsa viti 2021 pritet të shënojë rikuperim (4.0 përqind rritje të BPV-së). Presionet inflacioniste ishin të ulëta, kryesisht si pasojë e rënies së kërkesës së përgjithshme, veçanërisht rënies së turizmit, stagnimit të tregut të punës dhe mallrave, si dhe nivelit të lartë historik të kursit të këmbimit të valutës euro. Sipas vlerësimeve të Eurostat, niveli i inflacionit në Eurozonë për vitin 2020 ishte - 0.25 përqind. Vendet e Ballkanit Perëndimor po ashtu u goditën nga përhapja e pandemisë Covid-19, duke u futur në një recesion të thellë. Sipas Bankës Botërore, aktiviteti ekonomik për vitin 2020 është vlerësuar të jetë tkurrur për 4.8 përqind. Rënia më e lartë ekonomike u shënuar në Mal të Zi, ekonomia e së cilës është e varur shumë nga turizmi. Rënia në të ardhurat nga turizmi goditi edhe aktivitetin ekonomik në Shqipëri. Serbia ishte vendi që raportoi rënie më të lehtë të aktivitetit ekonomik. Presionet inflacioniste ishin në rënie edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si pasojë e rënies së kërkesës së brendshme, si dhe rënies së çmimeve të naftës dhe çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare.

Në vitin 2020, sipas vlerësimeve tremujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), ekonomia e Kosovës ka shënuar rënie vjetore prej 3.9 përqind. Rënia e ndjeshme e aktivitetit ekonomik në Kosovë është transmetuar kryesisht përmes sektorit të jashtëm të ekonomisë. Rreziqet e rritura si pasojë e pandemisë dhe masat e ndërmarra për të frenuar përhapjen e virusit konsistuan kryesisht me masa kufizuese në udhëtim. Kjo është reflektuar në rënie të aktivitetit ekonomik veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë, dinamika që u përkthye në rënie të theksuar në eksportin e shërbimeve në kuadër të bilancit të pagesave. Konkretisht, rënia e vizitave të diasporës në Kosovë si pasojë e drejtpërdrejtë e masave kufizuese për të menaxhuar me krizën shëndetësore ka rezultuar në rënie reale të eksportit të shërbimeve, duke ndikuar në thellimin e deficitit të eksporteve neto në vitin 2020. Në anën tjetër, rënia e shënuar në importin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe rritja e eksportit të mallrave ndikuan në zbutjen e deficitit tregtar. Përveç eksportit neto edhe rënia e investimeve ka ndikuar negativisht BPV-në. Konsumi, në anën tjetër, është vlerësuar të ketë shënuar rritje reale prej 6.7 përqind, mbështetur nga rritja e konsumit privat dhe konsumit publik. Sa i përket vitit 2021, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të rikuperohet drejt niveleve të para krizës, me një rritje reale prej rreth 4.4 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe neto eksportet. Megjithatë, rreziqet ndaj aktivitetit ekonomik mbesin të larta, ndërlidhur me vaksinimin masiv dhe përmylljen e pandemisë. Rënia e kërkesës së përgjithshme dhe dinamikat në çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare u reflektuan në presione të dobëta inflacioniste edhe në Kosovë. Niveli i përgjithshëm i çmimeve në vend, i shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit, ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 0.2 përqind në vitin 2020. Për vitin 2021, norma mesatare e inflacionit pritet të jetë rreth 1.6 përqind.

Statistikat e tregut të punës në Kosovë tregojnë për shkallë të lartë të normës së papunësisë, normë e cila sipas ASK-së, mbeti pothuajse e pandryshuar krahasuar me vitin paraparak. Shkalla mesatare e papunësisë deri në shtator 2020 ishte 25.60 përqind, një nivel pothuajse i ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit 2019 (25.57 përqind). Në vitin 2020, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë

punëtore në Kosovë ishte 37.3 përqind, që krahasuar me vitin 2019, tregon për një rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për 3.2 pikë përqindje.

Sektori fiskal u karakterizua me rritje më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat. Të hyrat buxhetore në vitin 2020 arritën vlerën neto prej 1.7 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 8.8 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore arritën vlerën prej 2.2 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.5 përqind. Rrjedhimisht, deficitin primar buxhetor ka arritur në 7.1 përqind të BPV-së nga 2.6 përqind sa ishte në vitin 2019. Borxhi publik ka arritur në 1.5 miliard euro, që është një rritje vjetore prej 23.9 përqind kundrejt vitit 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind, nga 17.5 përqind sa ishte në vitin 2019.

Struktura e ekonomisë së Kosovës ka ndikuar që efektet e krizës pandemike të transmetohen kryesisht përmes kanalit të sektorit të jashtëm të ekonomisë. Në vitin 2020, sektori i jashtëm i Kosovës u karakterizua me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse në 480.7 milionë euro (7.1 përqind e BPV-së), një rritje vjetore prej 20.4 përqind, kryesisht si pasojë e përgjysmimit të bilancit pozitiv të shërbimeve. Në anën tjetër, rritja e eksportit të mallrave, si dhe rënia e konsiderueshme e importit si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik ka ndikuar që deficitin në tregtinë e mallrave të shënojë rënie prej 9.4 përqind (4.5 përqind rritje në vitin 2019) dhe të zbrësë në rreth 2.8 miliardë euro (41.5 përqind e BPV-së). Remitencat e pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 980.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1 përqind, ndërsa Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë arritën vlerën prej 341.7 milionë euro, që paraqet një rritje të theksuar prej 34.2 përqind.

Sistemi financiar u karakterizua me rritje të aktivitetit gjatë vitit 2020, përkundër përballjes me sfidat e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Rritja vjetore e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës prej 8.9 përqind iu atribuua kryesisht rritjes së asetëve të sektorit bankar. Asetet e sektorit bankar në vitin 2020 shënuan rritje vjetore prej 12.5 përqind dhe arritën vlerën prej 5.35 miliardë euro. Si pasojë e pasigurive që solli kufizimi i aktivitetëve ekonomike, asetet e sektorit bankar shënuan rritje të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, që kryesisht i atribuohet ecurisë me të cilën u karakterizua aktiviteti kreditor. Në Anketën e Kreditimit Bankar, bankat deklaruan që gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, dinamikat e aktivitetit kreditues u ndikuan negativisht si nga oferta ashtu edhe nga kërkesa kreditore. Sipas bankave, masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit të pandemisë Covid-19, u reflektuan në rritjen e rrezikut të perceptuar nga bankat, përkeqësimin e perspektivës së tregut vendor dhe global, rënien e cilësisë së portfolios kreditore, si dhe uljen e tolerancës së bankave ndaj rrezikut. Ndërsa, në gjysmën e dytë të vitit, bankat deklaruan lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore dhe rritje të kërkesës për kredi, dinamika që kryesisht u ndikuan nga masat e ndërmarra nga BQK për pezullimin e pagesës së kësteve të kredive dhe ristrukturimit të kredive si pasojë e pandemisë. Portofoli kreditor i sektorit bankar u zgjerua për 7.1 përqind, përderisa vlera e gjithsej kredive arriti në 3.25 miliardë euro në vitin 2020. Dinamika e rritjes gjatë këtij viti rezultoi të jetë më e ngadalësuar në krahasim me rritjet dyshifrore të katër viteve të fundit. Në të njëjtën periudhë, depozitat në sektorin bankar të Kosovës arritën vlerën prej 4.36 miliardë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 11.6 përqind (16.2 përqind në vitin 2019).

Treguesit e performancës dhe shëndetit financiar të sektorit bankar vazhduan të qëndrojnë stabil përkundër rritjes së ekspozimeve të sektorit ndaj rreziqeve, si pasojë e pandemisë. Materializimi i plotë i rritjes së pritjes të rrezikut kreditor në bilancin e gjendjes së bankave është evituar kryesisht përmes masave lehtësuese të ndërmarra nga BQK, përkatësisht moratoriumit, pezullimit të dispozitave rregullative në provizionim dhe klasifikim të rregullt kreditor, si dhe ristrukturimit të kredive. Norma e kredive joperformuese ndryshoi trendin rënës që kishte në gjashtë vitet e fundit, duke u ngritur në 2.7 përqind në dhjetor 2020, nga niveli më i ulët historik prej 2.0 përqind që shënoi në fund të vitit 2019. Rritja fillimisht i atribuohet ndryshimit metodik të vlerësimit të

rrezikut kreditor¹, ku norma e KJP-ve u ngrit në 2.5 përqind në muajin shkurt 2020. Në vijim, rritja e KJP-ve reflekton rritjen e rrezikut të nxitur nga situata pandemike. Niveli i mbulueshmerisë së kredive joperformuese me provizione në këtë periudhë ishte 139.6 përqind nga 163.5 në vitin paraprak. Profiti i realizuar gjatë vitit 2020 rezultoi të ketë qenë 79.9 milionë euro, një vlerë më e ulët krahasuar me vitin paraprak për 7.4 përqind, që kryesisht i atribuohet rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt të hyrave. Sektori bankar vazhdon të ketë nivel dhe cilësi të lartë të kapitalit. Rekomandimi i BQK-së për mos shpërndarjen e dividendës si masë për menaxhimin e pasojave të mundshme nga pandemia, si dhe ngadalësimi i kreditimit, ndikuan që kapitali të shënojë rritje më të lartë se sa kreditimi, gjë që u reflektua në rritje të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.4 përqind nga 15.8 përqind në vitin paraprak. Edhe pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet e qëndrueshme, ku raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra arriti në 39.6 përqind, që është lart mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25.0 përqind.

Sektori pensional në vitin 2020 u karakterizua me rritje të ngadalësuar të asetëve prej 1.2 përqind (17.0 përqind rritje në vitin 2019), përderisa vlera e përgjithshme e tyre arriti në 2.0 miliardë euro. Dinamikat në sektorin pensional në vitin 2020 u ndikuan nga tërheqja e 10 përqind të mjeteve të trustit nga kontributdhënësit, si masë në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike. Për më tepër edhe kthimi negativ në investime gjatë TM1 2020 (si pasojë e efekteve të Covid-19 në tregjet financiare) ndikoi në ngadalësimin e mëtejshëm të aktivitetit të sektorit pensional, megjithëse humbjet e shkaktuara gjatë tremujorit të parë u kompensuan gjatë tremujorëve vijues dhe sektori mbylli vitin me kthim pozitiv bruto nga investimet. Gjithashtu, në asetet e sektorit pensional pozitivisht kontribuan edhe kontributet e arkëtuara nga të dyja fondet.

Niveli i ndërmjetësimit të sektorit të sigurimeve, më saktësisht primet e shkruara bruto në raport me BPV-në e vendit, qëndron në një nivel të ulët prej 1.46 përqind. Asetet e sektorit të sigurimeve që përfaqësojnë 2.8 përqind të gjithëj asetëve të sistemit financiar arritën vlerën prej 219.2 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 11.6 përqind (rritje prej 11.8 përqind në vitin paraprak). Gjatë vitit 2020, vlera e primeve të shkruara nga siguruesit arriti në 99.3 milionë euro, nivel i ngjashëm me atë të vitit të kaluar (rritje vjetore prej 0.1 përqind), përderisa dëmet e paguara nga siguruesit dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) shënuan rënie vjetore prej 6.5 përqind duke zbritur vlerën në 51.5 milionë euro. Sektori i sigurimeve mbylli vitin 2020 me rezultat pozitiv financiar prej 3.4 milionë euro për dallim nga viti i kaluar, ku kishte shënuar rezultat negativ financiar prej 4.7 milionë euro. Rezultati pozitiv financiar i sektorit reflekton rënien më të lartë të shpenzimeve, si rrjedhojë e uljes së nivelit të dëmeve të ndodhura dhe zvogëlimit të shpenzimeve operative, përderisa të hyrat mbetën në nivel pothuajse të ngjashëm me vitin e kaluar. Raporti i kombinuar i sektorit gjithashtu pasqyron përmirësimin e pozitës financiare. Në dhjetor 2020, ky raport qëndroi në 98.2 përqind, duke reflektuar raportin e dëmeve ndaj primeve të fituara neto prej 54.2 përqind dhe raportin e shpenzimeve ndaj primeve të fituara neto prej 44.0 përqind, pa përfshirë të hyrat nga interesat prej investimeve.

Sektori mikrofinanciar në vitin 2020 shënoi rritje të ngadalësuar të asetëve dhe rënie të aktivitetit kredihënës, përderisa mbylli vitin me rezultat pozitiv të ulët financiar. Vlera e gjithëj asetëve të IMF-ve dhe IFJB-ve arriti në 315.3 milionë euro, që përbën një rritje të ngadalësuar vjetore prej 1.8 përqind. Gjatë vitit 2020, aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar shënoi rënie vjetore prej 7.1 përqind, me vlerën e gjithëj kredive prej 204.3 milionë euro. Aktiviteti me rënie i kreditimit të sektorit nuk reflekton vetëm ndikimin e pandemisë në këtë segment, por edhe revokimin e licencës së dy institucioneve mikrofinanciare, që është reflektuar edhe në portfolion e stokut të gjithëj kredive. Si pasojë e rënies së të hyrave (kryesisht të hyrat nga interesi në kredi) krahas

¹ Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut Kreditorprill2019.pdf (bqk-kos.org)

rënies së shpenzimeve (shpenzimet për interesa), sektori mikrofinanciar realizoi profit të ulët në vlerë prej 0.1 milion euro, krahasuar me 9.3 milionë euro fitim të realizuar një vit më parë.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 BQK-ja, ka vazhduar me avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative në funksion të mbikëqyrjes sa më efektive të institucioneve financiare. Avancimi i kornizës ligjore është bërë bazuar në nevojat për avancimin e proceseve rregullative dhe me qëllim të përafrimit me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Evropian, si rezultat i pjesëmarrjes aktive të BQK-së në Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA për Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2020, përkundër sfidave me pandeminë Covid-19 është vazhduar me zbatimin e pjesshëm të planit të ekzaminimeve të bankave, me anë të aplikimit të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Si pasojë e pandemisë, aktivitetet e mbikëqyrjes në vend të bankave kanë qenë të kufizuara dhe kjo ndikuar edhe në mosrealizimin e planit të ekzaminimeve të bankave, sipas aprovimit fillestar në fillim të vitit 2020.

Në vitin 2020, BQK ka marrë veprime konkrete me qëllim që të monitorojë për së afërmi gjendjen e bankave, si dhe të lehtësojë vështirësitë e rritura si pasojë e pandemisë si te bankat, ashtu edhe te shfrytëzuesit e produkteve financiare. Fillimisht, më 16 mars 2020, BQK mori vendim për pezullimin e përkohshëm të zbatueshmërisë së dispozitave të caktuara të rregulloreve bankare, që lidhen me çështjen e provizioneve dhe klasifikimit kreditor. Përmes këtij vendimi, klientëve iu është dhënë mundësia e shtyrjes së kësteve kreditore dhe të njëjtën kohë, ruajtja e klasifikimit ekzistues kreditor dhe mbajtja e nivelit të njëjtë të provizioneve, për t'u shqufizuar më 1 dhjetor 2020. Në ndërkohë, në qershor dhe gusht 2020, janë nxjerrë dy udhëzues me qëllim të vendosjes së kriterëve mbi të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredisë, në mënyrë që kredimarrësit në vështirësi financiare të kenë mundësinë të përmbushin detyrimet e parapara me kontratë. Në funksion të përfshirjes së të gjitha masave të ndërmarra deri më tani, në shkurt 2021, BQK-ja ka nxjerrë edhe udhëzuesin e tretë, duke dhënë edhe një afat shtesë lidhur me ristrukturimin e kredive.

Megjithë vështirësitë e ngritura si pasojë e pandemisë, BQK është angazhuar duke iu përshtatur rrethanave të reja në vitin 2020, për realizimin e ekzaminimeve të plota dhe të fokusuara të siguruesve. Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar, në vitin 2020 janë zhvilluar ekzaminimet në fonde pensionale sipas planit vjetor. Sa i përket IMF dhe IFJB, situata e krijuar me Covid-19 gjatë vitit 2020 ka ndikuar në kufizimet e ekzaminimeve në vend, sidoqoftë ato janë monitoruar në vazhdimësi qoftë përmes takimeve të numërta dhe komunikimeve të tjera të vazhdueshme, po ashtu edhe nga perspektiva e mbikëqyrjes nga jashtë.

Sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, për zbatimin sa më efektiv në praktikë të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit është konsideruar e nevojshme, analizimi i nevojës për nxjerrjen e akteve udhëzuese nga ana e BQK-së. Pas rishikimit të Rregullores së BQK-së për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, gjatë vitit 2020, është finalizuar edhe udhëzimi në lidhje me plotësimin e deklaratimit të prejardhjes së fondeve dhe përcaktimit të së drejtës së pronësisë.

BQK luan rol kyç në mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në Kosovë. Në këtë kontekst, në kuadër të procesit të brendshëm të trajtimit të ankesave, gjatë vitit 2020, BQK-ja ka shqyrtuar 1,846 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë), ku 1,429 ankesa kanë qenë të deponuara për banka, IMF, IFJB dhe fonde pensionale, 409 ankesa kanë qenë të deponuara për siguruesit, ndërsa 8 kanë qenë ankesa të tjera.

Ngjashëm me vitet paraprake edhe gjatë vitit 2020, në kuadër të operacioneve të menaxhimit me para të gatshme, BQK siguroi furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro. Përkundër situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19,

të gjitha operacionet me para të gatshme u monitoruan dhe u menaxhuan në baza ditore, me qëllim të përshtatjes së kërkesave të shtuara për furnizim si rezultat i situatës pandemike. Gjithashtu, edhe sistemi i pagesave, për kundër situatës së krijuar si pasojë e krizës globale pandemike dhe kërkesës për t'u përshtatur me nevojat specifike të paraqitura, ka rezultuar të jetë i qëndrueshëm dhe i gatshëm të përballet me sfida të kësaj natyre, në funksion të ofrimit të shërbimeve të pagesave për Qeverinë, bizneset dhe ekonomitë familjare.

Prioriteti kryesor i BQK-së për mjetet nën menaxhim gjatë vitit 2020 ishte siguria dhe likuiditeti i mjeteve, para kthimit nga investimet. Portofoli i rezervave të menaxhuara nga BQK përbëhet nga instrumentet në portofolin likuid dhe ato në portofolin investues. Në vitin 2020, BQK për herë të parë ka plasuar marrëveshje të riblerjes me bankat komerciale vendore si instrument i ri në portofolin e investimeve të BQK-së, instrument që ndihmon likuiditetin e sektorit bankar dhe likuiditetin e gjithmbarshëm të letrave me vlerë kombëtare. Gjithashtu, në vitin 2020, BQK është bërë pjesë e marrëveshjes për riblerje të Eurosistemit përmes Deutsche Bundesbankës për bankat qendrore (EUREP), duke mundësuar marrjen hua nga pakoja e likuiditetit të Eurosistemit, kundrejt kolateralit adekuat në euro të përbërë nga letra me vlerë të tregtueshme të borxhit, të emetuara nga qeveritë qendrore të Eurozonës dhe institucionet supranacionale.

Edhe Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) ka shënuar progres gjatë vitit 2020, ku janë regjistruar 238 përdorues të ri, si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare, përderisa hulumtimi mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditorë arriti në 734,130 hulumtime.

Në funksion të realizimit të objektivave të saj, BQK-ja ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje të veçantë analizave rreth zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në vend, si dhe analizave që kanë të bëjnë me vlerësimin e stabilitetit financiar dhe rreziqeve sistemike dhe josistemike. Në vitin 2020, kriza e paprecedent shëndetësore, ekonomike dhe sociale ndikoi edhe këtë funksion të BQK-së, duke rritur peshën që kanë rekomandimet e dala nga modelet e zhvilluara nga BQK për adresimin e rreziqeve sistemike dhe josistemike, me fokus në sinjalizim të ecurive të pritura si rreth dinamikave makroekonomike ashtu edhe të ecurive në sistemin financiar dhe akterëve kryesorë në të. BQK është fokusuar në rritjen e vëllimit dhe cilësisë së analizave veçanërisht me dinamikat e reja të krijuara me situatën pandemike në vitin 2020.

Gjatë vitit 2020, pandemia Covid-19 ka krijuar vështirësi në prodhimin e shumë statistikave kryesore, pasi operacionet që kanë të bëjnë me anketimin janë vështirësuar e në disa raste janë ndërprerë terësisht, siç është rasti i anketës me emigrantët kosovarë, që vijnë në Kosovë gjatë TM2 dhe TM3 të vitit. Me gjithë vështirësitë, BQK ka vazhduar publikimin e rregullt të statistikave për sektorin monetar dhe sektorin e jashtëm, që janë përgjegjësi kryesore e BQK-së. Këtë vit, BQK-ja ka publikuar disa informata të reja në lidhje me sektorin e statistikave të llogarive financiare. Gjatë vitit 2020 janë nënshkruar dy kontrata me GOPA/Eurostatin, për avancim të statistikave lidhur me përpilimin e Indikatorëve të Procedurës së Imbalancës dhe përmirësimin e mëtejshëm të kualitetit për Statistikat për Tregtinë Ndërkombëtare në Shërbime. Progres i rëndësishëm është bërë këtë vit edhe në ndërtimin e kornizës për përpilimin e Statistikave të Llogarive Financiare (SLLF) dhe të bilancit të gjendjes sipas çasjes sektoriale.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia globale u përball me një ndër krizat më të mëdha në histori, e nxitur nga përhapja e pandemisë Covid-19 dhe masat e ndërmarra për kufizimin e përhapjes së saj. Mbyllja e kufijve dhe izolimi total i ekonomive pothuajse në të gjitha shtetet shtyu aktivitetin ekonomik drejt një rënie shumë të ndjeshme. Zinxhiri prodhues global dhe konsumi i përgjithshëm u goditën fuqishëm, me përjashtim të konsumit për mallra bazë ushqimore, duke ndikuar edhe në dobësim të ndjeshëm të tregtisë ndërkombëtare. Aplikimi i pakove mbështetëse fiskale do ta rëndojë buxhetin e shteteve, përderisa perspektiva për periudhën në vazhdim mbetet e shoqëruar me pasiguri të larta, si në aspekt të përmbylljes së krizës shëndetësore, ashtu edhe të kostos mbi dinamikat ekonomike dhe sociale.

Zhvillime të ngjashme negative janë shfaqur në të gjitha vendet e Eurozonës dhe Ballkanit Perëndimor, me dallime ndërmjet tyre në varësi të qasjes që kanë pasur vendet sa i përket masave kufizuese kundrejt përhapjes së virusit Covid-19, ndjeshmërisë së ekonomisë ndaj një situatë të tillë, si dhe suksesit të aplikimit të pakove fiskale për të lehtësuar ngarkesën në ekonomi.

Sipas BQE-së, ekonomia e Eurozonës për vitin 2020 është vlerësuar të ketë tkurrje të aktivitetit prej -6.6 përqind, ndërsa viti 2021 vlerësohet me më shumë optimizëm ku pritjet janë se do të ketë rritje ekonomike prej 3.9 përqind. Rënia ekonomike ishte më e theksuar në tremujorin e dytë të vitit prej -14.6 përqind, periudhë kjo që u karakterizua me mbylljen e parë të përgjithshme të ekonomive si reagim i kufizimit të përhapjes së valës së parë të pandemisë. Tkurrja ekonomike gjatë tremujorit të dytë të vitit ishte më e theksuar në vendet më të prekura nga virusi si Spanja (-21.6 përqind), Franca (-18.6 përqind) dhe Italia (-18.1 përqind). Ndërsa Gjermania, ndër vendet kryesore të Eurozonës, shënoi rënien më të ulët prej -11.2 përqind në tremujorin e dytë (tabela 1).

Tabela 1. Rritja vjetore e BPV-së reale

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021p
Eurozona	1.9	2.6	1.9	1.3	-6.6	4.0
Spanja	3.0	3.0	2.4	2.0	-10.8	7.2
Greqia	-0.5	1.3	1.6	1.9	-8.2	4.1
Austria	2.0	2.4	2.6	1.4	-6.6	4.6
Franca	1.1	2.3	1.8	1.5	-8.1	6.0
Gjermania	2.2	2.6	1.3	0.6	-4.9	4.2
Italia	1.3	1.7	0.9	0.3	-8.9	5.2

Burimi: BQE, Eurostat, FMN (parashikimet), shkurt 2021

Lehtësimi i masave kufizuese të vendosura në muajin mars, i shoqëruar me implementimin e pakove lehtësuese fiskale dhe masat jokonvencionale të politikës monetare, si dhe rritjes së optimizimit nga zbulimi i vaksinës kundër Covid-19, ndikuan që ekonomia globale të fillojë zbutjen e efekteve negative në tremujorin e tretë të vitit 2020. Ekonomitë e Eurozonës treguan zbutje të rënies ekonomike në -4.1 përqind, megjithëse rritja e numrit të rasteve në vjeshtë dhe intensifikimi i masave kontrolluese në shumë vende evropiane, rezultuan që tkurrja e aktivitetit ekonomik të vazhdojë edhe në tremujorin e katërt në nivelin prej -4.9 përqind.

Për dallim nga vala e parë e përhapjes së virusit kur sektori i industrisë ishte goditur më së shumti, sektori i shërbimeve është duke e vuajtur më shumë valën e dytë të përhapjes së virusit dhe masave kufizuese si kundërpërgjigje. Situata pandemike ritheksoi tutje deglobalizimin dhe rriti pasiguritë në zgjidhjen e tensioneve gjeopolitike, siç është raporti i konkurrencës në mes të fuqive

të mëdha Kinë dhe Amerikë. Zhvillimet në sektorin industrial të Eurozonës, të ndikuara negativisht nga tensionet në tregtinë ndërkombëtare vitin e mëparshëm, u përkeqësuan akoma më shumë gjatë pandemisë. Si pasojë e rënies së kërkesës së përgjithshme dhe prodhimit, vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie prej 9.7 përqind në vitin 2020 (rritje prej 2.5 përqind në vitin 2019). Në anën tjetër edhe importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie prej 9.4 përqind (rritje 3.8 përqind në vitin 2019). Për pasojë, eksportet neto kontribuan në rënien e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2020.


Presionet inflacioniste ishin të ulëta për shkak të rënies së kërkesës, veçanërisht rënies së turizmit, stagnimit të tregut të punës dhe mallrave si dhe nivelit të lartë historik të kursit të këmbimit të valutës euro. Sipas vlerësimeve të Eurostat, niveli i inflacionit në Eurozonë për vitin 2020 është -0.25 përqind. Rënia e ndjeshme e kërkesës, ndikoi edhe në rënie të shpejtë të çmimeve të naftës, për t'u rritur në muajin nëntor. Ndërsa, ndikuar nga ndryshimet e fundit në dinamikën e tregut të naftës, më konkretisht rritja e çmimit të naftës, kanë ndryshuar edhe projeksionet e Eurostat për inflacionin. Sipas parashikimeve të fundit të Eurostat, norma mesatare e inflacionit për vitin 2021 pritet të jetë 1.5 përqind (grafik 1).

Sistemi financiar ka treguar qëndrueshmëri ndaj goditjeve të Covid-19, e mbështetur nga politika lehtësuese monetare e BQE-së, e cila reagoi menjëherë ndaj shpalljes së pandemisë duke lansuar më 18 mars Programin Pandemik të Blerjes së Aseteve, në vlerë prej 750 miliardë euro, me qëllim të ofrimit të likuiditetit të nevojshëm në treg. Në dhjetor të vitit 2020, Këshilli Drejtues i BQE-së mori vendim për rikalibrimin e instrumenteve financiare në kuadër të politikës lehtësuese monetare, si përgjigje ndaj presioneve të ulëta inflacioniste, si dhe për të krijuar kushte të favorshme të financimit me qëllim të përshpejtimit të rimëkëmbjes dhe normalizimit të aktivitetit ekonomik. BQE vendosi që të rritet shuma në kuadër të Programit Pandemik të Blerjes së Aseteve në 1,850 miliardë euro, të lehtësohen kushtet për refinancim afatgjatë, ndërsa normat bazë të interesit, si norma e interesit në operacionet bazë të refinancimit, norma bazë në depozita dhe norma e kreditimit njëditor të mbeten në 0.0 përqind, -0.5 përqind dhe 0.25 përqind respektivisht, të pandryshuara që nga vendimi i fundit në shtator të vitit paraprak.

Masat e politikës monetare të BQE-së dhe paket lehtësuese të adoptuara nga qeveritë nacionale janë mbështetja kryesore e kreditimit bankar dhe qasjes në financa gjatë kohës së pandemisë. Aktiviteti kreditor në Eurozonë ndaj sektorit privat nuk barti pasojë gjatë periudhës pandemike. Norma e rritjes së kreditimit ndaj korporatave jofinanciare deri në fund të vitit ishte më i lartë në raport me periudhën para pandemisë. Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare shënoi normë vjetore të rritjes prej 6.4 përqind në dhjetor 2020 nga 6.5 përqind në shtator, ndërsa 2.4 përqind në muajin shkurt 2020. Rënia e kreditimit nga shtatori deri në dhjetor rezultoi nga dobësimi i investimeve dhe shtrëngimi i kushteve kreditore për këtë segment. Ndërsa, kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 3.5 përqind në dhjetor, e pandryshuar nga shtatori i këtij viti dhe më e ulët se para shpalljes së pandemisë, që ishte 3.8 përqind në muajin shkurt.

Sikurse vendet e Eurozonës edhe vendet e Ballkanit Perëndimor u goditën nga përhapja e pandemisë Covid-19, duke u futur në një recesion të thellë. Sipas Bankës Botërore, aktiviteti

Grafik 1. Shkalla e inflacionit në eurozonë, në përqindje



Burimi: Eurostat (2021)


ekonomik për vitin 2020 është vlerësuar të jetë tkurrur për -4.8 përqind. Sipas të dhënave të shteteve perkatëse, rënia ekonomike për vitin 2020 është mesatarisht 5.0 përqind. Rënia më e lartë ekonomike u shënua në Mal të Zi prej -13.0 përqind, ekonomia e së cilit është e varur shumë nga turizmi, sektori më i ndikuar nga masat izoluese. Rënia në të ardhurat nga turizmi goditi edhe aktivitetin ekonomik në Shqipëri, përderisa ngjashëm edhe Kosova pësoi nga rënia në të ardhurat e gjeneruara nga ardhjet e diasporës. Serbia ishte vendi që raportoi rënie më të lehtë të aktivitetit ekonomik prej 0.9 përqind (grafik 2).

Për shkak të masave izoluese të aplikuara nga muaji mars në shtetet e Ballkanit Perëndimor, kërkesa e brendshme për produkte joesenciale, investimet si dhe eksportet pësuan rënie të theksuar. Konsumi ndër vite ka qenë kontribuesi kryesor në aktivitetin ekonomik dhe goditja e kësaj kategorie në periudhën pandemike, ishte faktor ndikues i rënies ekonomike në këto vende.

Këto dhe pasiguritë e rritura politike të ndërlidhura me proceset zgjedhore në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë, si dhe vala e dytë e virusit që preku këto vende pas muajit qershor, e vështirësuan tutje rimëkëmbjen. Recesioni preku dukshëm tregun e punës, duke rritur shkallën e papunësisë dhe varfërinë në vendet e Ballkanit Perëndimor, çështje këto problematike edhe para periudhës së pandemisë. Stagnimi në tregtinë ndërkombëtare ka goditur industrinë dhe prodhimtarinë e destinuar për eksport sidomos të Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut. Zvogëlimi i neto eksporteve ka ndikuar pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Në Shqipëri, rënia e turizmit dhe rënia e çmimeve të naftës kanë ndikuar që eksportet të zvogëlohen për 29.0 përqind. Në Maqedoni, eksportet kanë rënë për 10.6 përqind si rezultat i rënies së prodhimtarisë. Importet e Malit të Zi janë zvogëluar për 19.7 përqind ndërsa eksportet për 48.5 përqind. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në raport me bruto prodhimin vendor në vendet e Ballkanit Perëndimor është rritur në -9.0 përqind nga -7.0 përqind një vit më parë. Raportin më të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse ndaj bruto prodhimit vendor e mban Mali i Zi (-25.9 përqind) ndërsa më të ulët Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia në -3.5 përqind.

Rënia e të hyrave buxhetore për shkak të mbylljes së ekonomive dhe rritja e shpenzimeve buxhetore nga pakot lehtësuese fiskale të aplikuara për zbutjen e efekteve të pandemisë, pritet të bëjnë presion të lartë në deficitin fiskal të vendeve. Sipas Bankës Botërore, deficiti fiskal mund të arrijë deri në 10 përqind të BPV në shumicën e vendeve. Ngjashëm si në Eurozonë, në valën e parë të pandemisë, pothuajse të gjithë sektorët ekonomikë shënuan rënie aktiviteti. Ndërsa, në valën e dytë, sektori i shërbimeve ishte aktiviteti që u godit më ashpër në të gjitha vendet e Ballkanit.

Grafik 2. Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor




Burimi: FMN, Agjensionet Statistikore nacionale (2021)

Presionet inflacioniste ishin në rënie edhe në Ballkanin Perëndimor, si rezultat i rënies së kërkesës së brendshme, si dhe rënies së çmimeve të naftës dhe çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare vjetore e inflacionit e shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) në Mal të Zi ishte -0.8 përqind, Bosnjë dhe Hercegovinë -1.6 përqind, ndërsa në Shqipëri dhe Serbi qëndroi në 2.2 përqind, përkatësisht 1.6 përqind. Maqedonia shënoi nivelin më të lartë të inflacionit prej 2.3 përqind (grafik 3).

Në përgjigje të krizës së nxitur nga pandemia, bankat qendrore të tri vendeve të Ballkanit Perëndimor (Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia) kanë aplikuar masa lehtësuese të politikës monetare, duke zvogëluar normat bazë të interesit për të mbështetur në këtë mënyrë ekonominë

dhe ruajtur stabilitetin financiar. Aktiviteti kreditor i sektorit bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor shënoi normë pozitive të rritjes prej mesatarisht 5.3 përqind deri në dhjetor 2020. Normën më të lartë të rritjes së kreditimit e shënuan sektori bankar i Serbisë me 11.5 përqind, ai i Kosovës me rritje prej 7.1 përqind dhe sektori bankar i Shqipërisë me 5.8 përqind. Cilësinë më të lartë të portfolios kreditore vazhdon ta mbajë Kosova, me normë të kredive joperformuese prej 2.7 përqind, ndërsa me nivelin më të lartë të kredive joperformuese karakterizohet Shqipëria me 8.1 përqind dhe Bosnja dhe Hercegovina me 6.7 përqind.² Po ashtu edhe depozitat në sektorin bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor shënuan normë të rritjes, përveç depozitave të sektorit bankar të Malit të Zi që u zvogëluan për 3.0 përqind. Përsheptim të rritjes së depozitave shënoi sektori bankar i Serbisë (17.0 përqind nga 9.4 përqind një vit më parë) dhe i Shqipërisë (7.8 përqind nga 1.1 përqind).

Grafik 3. Rritja vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor



Burimi: FMN, Agjensionet Statistike nacionale (2021)

Në tregjet e këmbimit valutor, euro përgjithësisht u vlerësua kundrejt valutave kryesore (përfshirë frangun zviceran) por edhe ndaj valutave të vendeve të rajonit përjashtuar dinarin serb. Tkurrja e theksuar e ekonomisë së SHBA-së gjatë tremujorit të dytë të vitit dhe pasiguritë rreth zgjedhjeve presidenciale ndikuan në forcimin e euros ndaj dollarit amerikan me normë mesatare prej 1.9 përqind. Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj sterlinës britanike është vlerësuar për 1.4 përqind, ndërsa ndaj frangut zviceran është zhvlerësuar për 3.8 përqind. Kundrejt monedhave të rajonit si lekut shqiptar dhe denarit maqedon, euro është vlerësuar me 0.6 përqind përkatësisht 0.3 përqind, ndërsa ndaj dinarit serb është zhvlerësuar për 0.2 përqind kundrejt vitit paraprak.

² Të dhënat e fundit për B&H janë sipas shtator 2020.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Sektori real

3.1.1 Bruto Prodhimi Vendor

Aktiviteti ekonomik në Kosovë u karakterizua me një goditje të paprecedentë në vitin 2020. Kriza shëndetësore si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe masat që u ndërmorën për ruajtjen e shëndetit të publikut, kryesisht në kontekst të kufizimit të lëvizjes dhe distancimit fizik, u reflektuan në rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik.


Sipas vlerësimeve të ASK-së, aktiviteti ekonomik në Kosovë ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 1.3 përqind në tremujorin e parë dhe ka shënuar rënie prej 9.3 përqind dhe 7.3 përqind në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2020. Vlerësimet e ASK-së për tremujorin e katërt sugjerojnë se në këtë tremujor është shënuar rritje e aktivitetit ekonomik prej 0.7 përqind. Rrjedhimisht, vlerësimet preliminare sugjerojnë se në vitin 2020, BPV-ja nominale ka shënuar rënie për 4.0 përqind krahasuar me vitin 2019, ndërsa në terma realë, BPV-ja ka shënuar rënie prej 3.9 përqind (grafik 4). Rënia më e lartë e aktivitetit ekonomik është shënuar në sektorin e transportit dhe magazinimit (-25.5 përqind), ndërtimtarisë (-24.3 përqind) si dhe hoteleve dhe restoranteve (-21.8 përqind). Ndërsa, rritje reale është vlerësuar të ketë shënuar sektori i shëndetësisë dhe aktiviteteve të punës sociale (16.9 përqind), industria përpunuese (11.7 përqind), informimi dhe komunikimi (10.0 përqind), furnizimi me energji elektrike dhe gaz (9.4 përqind), industria nxjerrëse (4.6 përqind), etj.

Rënia e ndjeshme e aktivitetit ekonomik në Kosovë është transmetuar kryesisht përmes sektorit të jashtëm të ekonomisë. Rreziqet e rritura si pasojë e pandemisë dhe masat e ndërmarra për të frenuar përhapjen e virusit kanë konsistuar kryesisht me kufizime në udhëtim, gjë që është reflektuar në rënie të aktivitetit ekonomik veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë si pasojë e rënies së shënuar në eksportin e shërbimeve në kuadër të bilancit të pagesave. Rënia e vizitave të diasporës në Kosovë si pasojë

e drejtpërdrejtë e masave kufizuese të ndërmarra për të menaxhuar me krizën shëndetësore, si në Kosovë ashtu edhe në vendet ku është e koncentruar diaspora kosovare kanë rezultuar në rënie reale të eksportit të shërbimeve për 41.4 përqind, që rrjedhimisht ka ndikuar në thellimin e deficitit të eksporteve neto prej 17.5 përqind në vitin 2020. Komponentët tjerë kanë ndikuar në zbutjen e deficitit tregtar. Importi i mallrave dhe importi i shërbimeve kanë shënuar rënie reale prej 3.8 përqind përkatësisht 19.9 përqind, ndërsa eksporti i mallrave ka shënuar rritje reale për 21.4 përqind.

Përveç eksportit neto edhe rënia e investimeve prej 18.8 përqind e ka ndikuar negativisht BPV-në. Investimet kapitale të Qeverisë shënuan rënie prej 28.4 përqind në vitin 2020. Indikacioni i rënies së investimeve gjatë vitit 2020 është edhe rënia e importit të mallrave të ndërmjetme prej 7.9 përqind. Konsumi në anën tjetër, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, ka shënuar rritje reale prej 6.7 përqind, mbështetur nga rritja e konsumit privat prej 7.0 përqind dhe konsumit publik prej 4.4 përqind. Remitencat, si një burim i rëndësishëm i financimit të konsumit privat, shënuan rritje prej 15.1 përqind (6.4 përqind në vitin 2019).

Grafik 4. Norma e rritjes së BPV-së reale



Burimi: ASK (2021)


3.1.2 Çmimet

Rënia e kërkesës së përgjithshme dhe dinamikat në çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare u reflektuan në presione të dobëta inflacioniste në Kosovë. Niveli i përgjithshëm i çmimeve në vend, i shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit, ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 0.2 përqind në vitin 2020 (grafik 5). Në këtë ngadalësim të rritjes së çmimeve kanë ndikuar kryesisht çmimet e transportit të cilat shënuan rënie për -5.8 përqind, çmimet e veshmbathjes (-0.9 përqind), çmimet e rekreacionit dhe kulturës (-0.6 përqind), çmimet e energjisë elektrike, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (-0.1 përqind), etj.

Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike shënuan rritje prej 1.7 përqind, që është normë dukshëm më e ulët krahasuar me vitin 2019 ku ishte shënuar rritje prej 5.4 përqind. Si rezultat i peshës së lartë që e kanë në shportën e konsumatorit kosovar, çmimet e ushqimit kanë kontribuar më së shumti në ngadalësimin e rritjes së përgjithshme të çmimeve. Në anën tjetër, si rezultat i situatës pandemike, shërbimet shëndetësore kanë shënuar rritjen më të lartë (4.7 përqind), pasuar nga çmimet e restoranteve dhe hoteleve (2.2 përqind), mjetet e komunikimit (1.9 përqind), etj. (grafik 6).


Lëvizja e çmimeve në Kosovë përcaktohet kryesisht nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Indeksi i çmimeve të importit shënoj rënie mesatare prej 1.9 përqind në vitin 2020 (grafik 7). Çmimet e produkteve minerale, si dhe çmimet e produkteve të tekstilit shënuan rënie më të lartë (-15.9 përkatësisht -13.8 përqind), ndërsa çmimet e produkteve bimore shënuan rritjen më të lartë (13.9 përqind). Me rënie është karakterizuar edhe indeksi i çmimeve të prodhimit, i cili shënoi rënie mesatare prej 0.6 përqind. Rënia më e lartë e çmimeve të prodhimit është shënuar kryesisht te nxjerrja e xehes së metalit (-11.4 përqind), prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve (-4.5 përqind), prodhimi i metaleve (-3.4 përqind), prodhimi i mobileve (-3.3 përqind), etj. Ndërsa, me rritje më të lartë të çmimeve u karakterizuan prodhimi i mjeteve motorike (6.5 përqind), prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (6.4 përqind), etj.

Grafik 5. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2021)

Grafik 6. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2021)

Grafik 7. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2021)

3.1.3 Pozicioni financiar i ndërmarrjeve

Sektori i industrisë së bashku me sektorin e tregtisë përbëjnë dy sektorët ekonomikë me pjesëmarrjen më të lartë në qarkullimin e gjithsej ndërmarrjeve dhe indekset e këtyre dy sektorëve³ kanë shënuar rënie gjatë vitit 2020.

Grafik 8. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2017=100)




Burimi: ASK (2021)

Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial ka shënuar rënie mesatare prej 1.2 përqind, i ndikuar nga rënia e indeksit të furnizimit me ujë dhe indeksit të industrisë nxjerrëse (grafik 8), ndërsa indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë, shënoi rënie mesatare prej 16.5 përqind. Me rënie janë karakterizuar pothuajse të gjithë komponentët përbërës (grafik 9).

Në vitin 2020 janë regjistruar më pak ndërmarrje të reja dhe janë mbyllur dukshëm më pak ndërmarrje. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 9,805 apo 2.0 përqind më pak sesa në vitin 2019, ndërsa u mbyllën 1,326 ndërmarrje apo 25.0 përqind më pak sesa në vitin 2019 (grafik 10).


Numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 24.5 përqind e gjithsej ndërmarrjeve të reja të regjistruara, pasuar nga sektori i prodhimit me 13.5 përqind, ndërtimitarisë me 10.6 përqind dhe hotelarisë me 10.4 përqind (grafik 11). Krahasuar me vitin 2019, në sektorin e prodhimit janë regjistruar 219 ndërmarrje më pak, në sektorin e hotelarisë 121 ndërmarrje më pak, aktivitete administrative dhe mbështetëse 79 ndërmarrje më pak, etj. Ndërsa, sektorët që

Grafik 9. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë (2015=100)




Burimi: ASK (2021)

Grafik 10. Regjistri i bizneseve



Burimi: ASK (2021)

Grafik 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2021)

³ Publikim i ASK-së: Raporti 'Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë, TM3 2020', dhe 'Statistikat Afatshkurtra të Industrisë, TM4 2020'.

shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i bujqësisë (276 ndërmarrje më shumë), ndërtimtarisë (95 ndërmarrje më shumë), tregtisë (43 ndërmarrje më shumë), etj.

3.1.4 Tregu i punës

Deri në shtator 2020, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në Kosovë ishte 37.3 përqind, që krahasuar me vitin 2019 tregon për një rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për 3.2 pikë përqindje. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore i atribuohet deri në një masë popullsisë relativisht të re (nxënës, studentë), si dhe kategorisë së punonjësve të dekurajuar, amviseve dhe personave të tjerë, të cilët nuk janë aktivë në kërkim të një pune.

Bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore, shkalla mesatare e punësimit⁴ rezultoi të jetë 27.8 përqind, që paraqet një rënie prej 2.3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019. Shkalla e punësimit, rezultoi të jetë më e lartë te meshkujt kundrejt femrave, ku 42.1 përqind e meshkujve në moshë pune ishin të punësuar kundrejt 13.5 përqind të femrave. Sipas rezultateve të anketës, shkalla e punësimit te gjinia femërore ka shënuar rënie prej 0.4 pikë përqindje, ndërsa te gjinia mashkullore është shënuar rënie dukshëm më e lartë (4.1 pikë përqindje) krahasuar me vitin 2019.

Sipas grup-moshave, popullsia e moshës mes 35-44 vjeç ka normën më të lartë të punësimit (37.2 përqind), përderisa grup-mosha 15-24 vjeç ka normën më të ulët të punësimit (10.9 përqind). Sipas nivelit arsimor, shkalla më e lartë e punësimit rezulton të jetë në mesin e fuqisë punëtore me edukim të lartë, pasuar nga arsimi i mesëm profesional dhe gjimnazi. Punëtorët që kishin të përfunduar arsimin e mesëm profesional ishin kryesisht të punësuar në sektorin privat, përderisa punëtorët që kishin të përfunduar arsimin terciar ishin të punësuar kryesisht në sektorin publik.

Diktuar edhe nga struktura e ekonomisë, shkalla e punësimit rezulton të jetë e koncentruar në sektorin e tregtisë me 17.7 përqind të gjithsej të të punësuarve, pasuar nga sektori i prodhimit me 11.4 përqind, sektori i ndërtimtarisë me 10.9 përqind, sektori i arsimit me 10.3 përqind, etj. Krahasuar me vitin 2019, të dhënat tregojnë se ka rritje të pjesëmarrjes në strukturën e të punësuarve në sektorin e tregtisë dhe të arsimit, ndërsa sektori i ndërtimtarisë dhe ai i prodhimit kanë shënuar rënie.

Përkundër pandemisë dhe tkurrjes së aktivitetit ekonomik, statistikat zyrtare të tregut të punës në Kosovë tregojnë se shkalla mesatare e papunësisë⁵ deri në shtator 2020 ishte 25.60 përqind, një nivel pothuajse i ngajshëm me periudhën e njëjtë të vitit 2019 (25.57 përqind). Tkurrja e aktivitetit ekonomik si pasojë e rënies së vlerës së shtuar nga sektorët si sektori i shërbimeve (hotele dhe restorante; argëtim dhe rekreacion), ndërtimit dhe transportit nuk rezulton të jetë përkthyer në përkeqësim të shkallës së papunësisë në vend. Dinamika të tilla mund t'i atribuohet deri në një masë faktit, që bizneset në sektorët e prekur kanë menaxhuar rënien e aktivitetit duke zvogëluar të ardhurat dhe orët e punës së punonjësve të angazhuar, kundrejt largimit të tyre nga puna.

Në baza gjinore, tregu i punës në Kosovë karakterizohet me një shkallë më të lartë të papunësisë te femrat (31.7 përqind), me grup-moshën e femrave të reja të cilat kanë shkallën më të lartë të papunësisë (59.1 përqind), ndërsa te meshkujt shkalla e papunësisë është më e ulët (23.4 përqind). Edukimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës në Kosovë. Sipas ASK-së, shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (rreth 49.3 përqind), ndërsa më e ulët për personat që kishin të përfunduar arsimin terciar (18.6 përqind).

⁴ Shkalla e punësimit paraqet përqindjen e popullsisë në moshë pune që është e punësuar.

⁵ Shkalla e papunësisë është përqindja e fuqisë punëtore, që nuk është e punësuar.

3.2. Sektori fiskal

Të hyrat buxhetore⁶ në vitin 2020 arritën vlerën neto prej 1.7 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 8.8 përqind. Ndërsa shpenzimet buxhetore⁷ arritën vlerën prej 2.2 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.5 përqind. Rrjedhimisht, deficitin primar buxhetor ka arritur në 7.1 përqind të BPV-së nga 2.6 përqind sa ishte në vitin 2019.

Në kuadër të të hyrave tatimore, të gjitha kategoritë kanë shënuar rënie. Rënie më e lartë është shënuar te të hyrat tatimore indirekte, të cilat arritën vlerën prej 1.27 miliard euro apo 10.1 përqind më pak krahasuar me vitin 2019. Të hyrat tatimore direkte shënuan rënie prej 8.6 përqind dhe arritën vlerën prej 267.2 milionë euro. Të hyrat jotatimore shënuan rënie prej 5.3 përqind dhe arritën vlerën prej 214.2 milionë euro.

Rritja e shpenzimeve buxhetore prej 6.5 përqind ishte më e ulët krahasuar me vitin 2019 kur ishte shënuar rritje prej 7.2 përqind. Kategoria që shënoi rritje të përshpejtuar të shpenzimeve ishte ajo e shpenzimeve rrjedhëse të cilat shënuan rritje prej 18.6 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rënie prej 28.4 përqind. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 38.4 përqind dhe arritën vlerën prej 867.9 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje prej 7.3 përqind dhe arritën vlerën prej 660.8 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) shënuan rritje për 0.2 përqind dhe arritën vlerën prej 296.3 milionë euro.

Borxhi publik në vitin 2020 ka arritur në 1.5 miliard euro që është për 23.9 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind nga 17.5 përqind sa ishte në 2019. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 21.5 përqind (i cili ka arritur në 961.9 milionë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 28.6 përqind. Borxhi i jashtëm publik ka arritur nivelin prej 525.8 milionë euro apo 35.3 përqind e gjithë borxhit publik.

Në vitin 2020, vlera e shpallur në ankande arriti vlerën prej 377.5 milionë euro që është për 4.9 përqind më shumë krahasuar me vitin 2019, përderisa shuma e pranuar ishte 369.9 milionë euro apo 2.7 përqind më shumë krahasuar me vitin 2019.

Kërkesa për të investuar në bono dhe obligacione qeveritare ishte më e ulët se në vitin paraprak. Kjo u reflektua në raportin e përgjithshëm të kërkesës ndaj ofertës në letrat me vlerë, e cila në vitin 2020 ishte për 1.5 herë më e lartë, krahasuar me 1.9 sa ishte në vitin e kaluar. Në vitin 2020, norma mesatare e interesit në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës shënoi rritje duke arritur në 2.1 përqind krahasuar me 1.8 përqind sa ishte në vitin 2019. Rritja e normës së interesit ndërlidhet me vazhdimin e rritjes së pjesëmarrjes së letrave me vlerë afatgjatë. Përderisa në të kaluarën struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës dominohej nga bonot e Thesarit me afat maturimi më të shkurtër, në vitin 2020 kategoritë kryesore ishin obligacionet me afat maturimi prej tre dhe pesë vitesh.

3.3. Sektori i jashtëm

Struktura e ekonomisë së Kosovës ka ndikuar që efektet e krizës pandemike të transmetohen kryesisht përmes kanalit të sektorit të jashtëm të ekonomisë. Deficitin i llogarisë rrjedhëse në vitin 2020 është rritur për 20.4 përqind duke shënuar vlerën prej 480.7 milionë euro. Në raport me BPV-në, deficitin i llogarisë rrjedhëse ishte 7.1 përqind (5.6 përqind në vitin 2019). Bilanci pozitiv i shërbimeve është përgjysmuar, ndërsa bilancet pozitive të të ardhurave parësore dhe dytësore

⁶ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga financimi.

⁷ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

shënuan rritje. Në anën tjetër, deficitin e mallrave, i cili vazhdimisht është negativ, në vitin 2020 ka shënuar rënie të konsiderueshme.

Rritja e eksportit të mallrave, si dhe rënia e konsiderueshme e importit si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik ka ndikuar, që deficitin në tregtinë e mallrave të shënoi rënie prej 9.4 përqind (4.5 përqind rritje në vitin 2019) dhe të arrijë në rreth 2.8 miliardë euro. Në raport me BPV-në, deficitin tregtar i mallrave ishte 41.5 përqind (43.9 përqind në vitin 2019). Vlera e eksportit të mallrave arriti në 475.0 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 23.8 përqind (4.4 përqind rritje në vitin 2019)


(grafik 12).⁸ Rritja e eksportit të mallrave ka ndodhur përkundër rënies së kërkesës së jashtme por edhe rënies së çmimeve të metaleve. Rritja më e lartë u shënuar tek eksporti i produkteve të industrisë kimike, produkteve të perimeve, produkteve të plastikës, etj. Po ashtu edhe metalet bazë, të cilat kanë pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 36.6 përqind), shënuan rritje të konsiderueshme (29.4 përqind). Në anën tjetër, me rënie u karakterizua eksporti i produkteve minerale, eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, etj. (grafik 13).

Gjatë vitit 2020 importi i mallrave ka shënuar rënie prej 5.7 përqind (4.5 përqind rritje në vitin 2019) dhe ka arritur në 3.3 miliardë euro. Rënia e importit i atribuohet rënies së kërkesës së përgjithshme në nivel global, dinamikë që u përkthye në rënie të çmimeve të metaleve dhe mineraleve (kryesisht derivateve të naftës) në tregjet ndërkombëtare, si dhe rënie të aktivitetit ekonomik në vend. Rënie më e lartë është shënuar tek importi i produkteve minerale, mjetet e transportit, metalet bazë, si dhe artikujt e tekstilit, ndërsa rritje më e lartë është shënuar tek importi i produkteve kimike, importi i plastikës, gomës dhe artikujve prej tyre, importi i tekstilit dhe artikujve të tekstilit, importi i makinerive dhe pajisjeve elektrike, etj. (grafik 14).

Në kuadër të bilancit të pagesave, tregtia me shërbime ishte komponenta që pësoi rënie më të madhe, si pasojë e drejtpërdrejtë e masave kufizuese të ndërmarra për të menaxhuar me krizën shëndetësore. Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 391.5 milionë euro apo 57.7 përqind më pak krahasuar me vitin 2019. Vlera e eksportit të shërbimeve shënoi rënie vjetore prej 40.7 përqind, duke zbritur në 994.0 milionë euro.

Kjo rënie e eksportit të shërbimeve përbën njërin prej kanaleve kryesore të transmetimit të krizës, kur kemi parasysh që eksporti i shërbimeve ka një pjesëmarrje të lartë në BPV-në e vendit dhe përbëhet kryesisht nga shpenzimet e diasporës gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë. Rënia e vizitave


Grafik 12. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2021)

(grafik 12).⁸ Rritja e eksportit të mallrave ka ndodhur përkundër rënies së kërkesës së jashtme por edhe rënies së çmimeve të metaleve. Rritja më e lartë u shënuar tek eksporti i produkteve të industrisë kimike, produkteve të perimeve, produkteve të plastikës, etj. Po ashtu edhe metalet bazë, të cilat kanë pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 36.6 përqind), shënuan rritje të konsiderueshme (29.4 përqind). Në anën tjetër, me rënie u karakterizua eksporti i produkteve minerale, eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, etj. (grafik 13).

Grafik 13. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2021)

⁸ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

të diasporës në Kosovë për shkak të gjendjes pandemike dhe kufizimeve përcjellëse, ka ndikuar që eksporti i shërbimeve të udhëtimit të shënoi vlerën prej vetëm 628.0 milionë euro apo 52.2 përqind më pak krahasuar me vitin 2019.

Po ashtu edhe eksporti i shërbimeve të ndërtimit, si dhe eksporti i shërbimeve të transportit u karakterizuan me rënie vjetore prej 46.1 përkatësisht 29.7 përqind. Në anën tjetër, importi i shërbimeve shënoi rënie prej 19.6 përqind dhe arriti në 602.5 milionë euro. Ndërsa tek importi i shërbimeve, rënia më e lartë është shënuar tek importi i shërbimeve të udhëtimit (-37.2 përqind), pasuar nga importi i shërbimeve të ndërtimit (-36.9 përqind), shërbimeve kompjuterike (-31.8 përqind), shërbimeve të transportit (-10.5 përqind), etj.

Grafik 14. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2021)

Llogaria e të ardhurave parësore, shënoi rritje prej 2.3 përqind. Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve⁹ shënuan rritje për 3.7 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 13.5 përqind, që i atribuohet kryesisht nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 980.1 milionë euro në vitin 2020, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1 përqind (grafik 15).

Ky përshpejtim i rritjes së remitencave ka ardhur përkundër faktit se edhe vendet ku janë të koncentruar diaspora kosovare janë goditur shumë nga kriza e pandemisë. Rritja e remitencave ka qenë dyshifrore gjatë gjithë periudhës, me përjashtim të muajit mars dhe prill 2020 kur shënuan rënie. Sa i përket kanaleve të transferimit të remitencave, pjesa dërmuese e remitencave (68.6 përqind) kanë ardhur përmes agjencive për transfer të mjeteve, të cilat shënuan rritje prej 60.0 përqind. Remitencat përmes bankave shënuan rritje prej 14.9 përqind, ndërsa si rezultat i mbylljes së kufirit, si dhe kufizimeve të tjera, remitencat përmes 'kanalit joformal' shënuan rënie për 46.0 përqind. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat u dërguan 42.3 përqind, përkatësisht 22.3 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të (6.4 përqind e gjithsej remitencave).

Grafik 15. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2021)

⁹ Kompensimi i punonjësve përfshin pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezidentë jashtë vendit. Në këtë kontekst, ky zë përfshin punëtorët sezonalë apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitarë të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

Investimet e Huaja Direkte (IHD), në vitin 2020, arritën vlerën prej 341.7 milionë euro, që paraqet një rritje prej 34.2 përqind. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, investimet në instrumente të borxhit shënuan rritje prej 29.9 përqind ndërsa kapitali dhe fondi i investimeve në aksione shënoi rritje prej 34.5 përqind (grafik 16). Rritje e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e aktiviteteve financiare, energjetikës si dhe xehtarisë dhe gurorëve. Në anën tjetër, sektori i patundshmërive, i cili përbën sektorin me pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e IHD-ve, ka shënuar rënie për 10.1 përqind në vitin 2020.

Grafik 16. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro




Burimi: BQK (2021)

3.4. Sektori financiar

3.4.1 Karakteristikat e përgjithshme

Sistemi financiar shënoi rritje të aktivitetit gjatë vitit 2020, përkundër përballjes me sfidat e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Vlera e gjithsej aseteve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 7.91 miliardë euro në vitin 2020, që përkon me një rritje vjetore prej 8.9 përqind, përkatësisht 6.0 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin paraprak (grafik 17). Sektori bankar vazhdon të ketë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend.

Grafik 17. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK (2021)

Sa i përket strukturës së sistemit financiar, numri i bankave komerciale dhe i ndihmësve financiarë u rrit gjatë vitit 2020, përderisa numri i institucioneve mikrofinanciare u zvogëluar. Numri i institucioneve në sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar mbeti i pandryshuar.

Tabela 2. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020
Bankat komerciale	10	10	10	10	11
Siguruesit	15	15	14	13	13
Fondet pensionale	2	2	2	2	2
Ndhmësit financiar	48	52	51	54	61
Ndërmjetësuesit në sigurime	15	16	13	16	16
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jobankare	16	18	22	20	18

Burimi: BQK (2021)

Sektori bankar gjatë vitit 2020 u zgjerua në 11 banka si pasojë e licencimit të një banke të re në tremujorin e fundit të vitit. Gjithashtu, ndihmësit financiarë, si sektori me numër më të madh të institucioneve, u rrit tutje në 61 institucione, megjithëse pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sistemit financiar vazhdon të qëndrojë në vetëm 0.2 përqind. Përderisa, numri i institucioneve

mikrofinanciare u zvogëlua në 16, si pasojë e tërheqjes së regjistrimit të dy institucioneve (tabela 2).


3.4.2 Sektori Bankar

Asetet

Asetet e sektorit bankar në vitin 2020 shënuan rritje vjetore prej 12.5 përqind, duke arritur vlerën prej 5.35 miliardë euro (grafik 18). Masat kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, ishin ndër faktorët kryesorë që diktuan ecurinë e zërave të bilancit të sektorit. Si pasojë e pasigurive që solli kufizimi i aktiviteteve ekonomike, asetet e sektorit bankar shënuan rritje të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, e që i atribuohet kryesisht dinamikave në aktivitetin kreditor, si zë me kontributin kryesor në asetet e sektorit bankar. Ky aktivitet u mbështet kryesisht nga depozitat të cilat përbëjnë rreth 81 përqind të gjithë detyrimeve dhe burimeve vetanake.

Pozicioni i letrave me vlerë shënoi rritje vjetore prej 11.0 përqind krahas rritjes prej 22.4 përqind në vitin paraprak. Rritje të ngadalësuar kishin edhe mjetet e mbajtura në bankat komerciale me rritje vjetore prej 27.6 përqind nga 29.3 përqind në vitin paraprak. Zëri i vetëm me rritje të përshpërtuar ishte paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, i cili u rrit për 27.0 përqind nga 14.9 përqind në vitin e kaluar. Rritja e rezervave të mbajtura nga bankat komerciale këtë vit reflekton kryesisht pasiguritë e krijuara nga gjendja pandemike dhe rrjedhimisht këto rrethana.

Grafik 18. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2021)

Tabela 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	2016		2017		2018		2019		2020	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në	457.3	12.6%	499.4	12.9%	541.8	12.9%	622.5	13.1%	790.6	14.8%
Bilanci me bankat komerciale	342.0	9.4%	296.6	7.7%	340.8	8.1%	440.6	9.3%	562.2	10.5%
Letrat me vlerë	510.3	14.0%	486.4	12.6%	430.2	10.3%	526.5	11.1%	584.3	10.9%
Kreditë bruto	2,230.0	61.3%	2,485.5	64.2%	2,755.5	65.8%	3,031.9	63.7%	3,246.6	60.6%
Asetet Fikse	58.5	1.6%	60.1	1.6%	79.6	1.9%	98.9	2.1%	116.4	2.2%
Asetet Tjera	39.0	1.1%	41.8	1.1%	37.5	0.9%	40.1	0.8%	53.2	1.0%
Gjithsej	3,637.1	100%	3,869.8	100%	4,185.5	100%	4,760.5	100%	5,353.4	100%

Burimi: BQK (2021)

Shkalla e koncentrimin në sektorin bankar ka vazhduar rënien. Asetet e tri bankave më të mëdha kanë zbritur peshën në 55.8 përqind të aseteve të sektorit nga 56.8 përqind sa ishte në vitin paraprak. Gjithashtu, indeksi Herfindal-Hirschman për asetet e sektorit bankar zbriti në 1,475 nga 1,489 në vitin e kaluar.


Kreditë

Në vitin 2020, portofoli kreditor i sektorit bankar u zgjerua për 7.1 përqind (grafik 19) përderisa vlera e gjithëj kredive arriti në 3.25 miliardë euro. Dinamika e rritjes gjatë këtij viti rezultoi jetë më e ngadalësuar në krahasim me rritjet dyshifrore të katër viteve të fundit. Në Anketën e Kreditimit Bankar, bankat deklaruan që gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, dinamikat e aktivitetit kreditues u ndikuan negativisht si nga oferta ashtu edhe nga kërkesa kreditore. Masat

e ndërmarrja nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19, u reflektuan në rritjen e rrezikut të perceptuar nga bankat, përkeqësimin e perspektivës së tregut vendor dhe global, rënien e cilësisë së portfolios kreditorë, si dhe uljen e tolerancës së bankave ndaj rrezikut. Ndërsa, në gjysmën e dytë të vitit kishte lehtësim deri në një masë të standardeve kreditorë dhe rritje të kërkesës për kredi. Në këtë dinamikë ndikim kishin masat e ndërmarrja nga BQK për pezullimin e pagesës së kësteve të kredive dhe ristrukturimit të kredive si pasojë e pandemisë. Gjithashtu, bankat deklaruan se kontribut pozitiv dha edhe mbështetja e FKGK-së në kreditim, rritja e presioneve të konkurrencës dhe qasja e favorshme në financim.¹⁰


Kreditë ndaj ndërmarrjeve në vitin 2020 shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind (grafik 20). Kreditimi ndaj pothuajse të gjithë sektorëve ekonomikë shënoi rritje, me përjashtim të sektorit të bujqësisë që shënoi rënie vjetore prej 22.1 përqind. Sektori i ndërtimit, i shërbimeve financiare, dhe i prodhimit u rritën për 61.8 përqind¹¹, 43.9 përqind, dhe 21.4 përqind respektivisht (grafik 22).

Grafik 19. Norma vjetore e rritjes së kredive



Burimi: BQK (2021)

Grafik 20. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2021)

Kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve në vitin 2020 shënuan rritje vjetore prej 4.4 përqind, ku të gjitha nënkategoritë e kredive të reja u karakterizuan me rritje, përveç kategorisë së sektorëve të tjerë. Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pasuar nga ato për prodhimtari dhe ndërtimtari (grafik 21).


Kreditimi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vitin 2020 u mbështet edhe nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë, shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes. Numri kumulativ i kredive të bankave për NVM-të, të garantuara nga FKGK, arriti në 6,103 në fund të vitit 2020 (4,052 në fund të vitit 2019). Shuma totale e kredive të garantuara në vitin 2020 shënoi 229.0 milionë euro kundrejt vlerës së garantuar prej 156.3 milionë euro në vitin paraprak. Struktura e kredive të garantuara është përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, me ç' rast dominojnë kreditë për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, të pasuara nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Për dallim me vitin paraprak sektori i bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë dhe sektori i shërbimeve kishin përfaqësim më të ulët në gjithsej portofolin e kredive të garantuara prej 9.0 përqind (10.0 përqind në dhjetor 2019) dhe 25.0 përqind (28.0 përqind në dhjetor 2019). Përderisa, sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë, sektori i prodhimit dhe sektori i ndërtimtarisë kishin rritje të peshës në gjithsej portofolin e kredive të garantuara prej 39 përqind (38 përqind në dhjetor 2019), 18 përqind (17 përqind në dhjetor 2019) dhe 9.0 përqind (7.0 përqind në dhjetor 2019).

¹⁰ Raporti i Anketës së Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit

¹¹ Rritja e theksuar e kreditimit të ndërtimtarisë i atribuohet rikategorizimit nga një bankë të një pjese të portfolios kreditorë nga zëri i shërbimeve tjera në atë të sektorit të ndërtimtarisë, të prodhimit dhe të tregtisë.


FKGK gjatë këtij viti ka nënshkruar disa marrëveshje financiare për rritjen e kapitalit me rreth 33 milionë euro nga donacionet e ndryshme, për të rritur kredidhënien në sektorin e biznesit dhe t'i ndihmojë ato në përballjen me vështirësitë e paraqitura për shkak të krizës pandemike. Po ashtu, në kuadër të Pakos për Rimëkëmbjen Ekonomike, e cila u miratua në fund të vitit 2020, përfshihen ndryshime të ligjeve ekzistuese, ku në mes të tyre bën pjesë edhe rritja e mbulesës së kredive për ndërmarrjet nga FKGK nga 50 përqind në shkallën deri në 80 përqind. Ky ndryshim pritet të reflektohet në rritjen e mëtejme të kreditimit për NVM-të në përgjithësi, e veçanërisht sektorëve më të prekur, për të tejkaluar vështirësitë e shfaqura si rezultat i pandemisë.

Grafik 21. Kreditë sipas sektorëve ekonomikë, në përqindje (2020)



Burimi: BQK (2021)

Grafik 22. Stoku i kredive, sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2021)

Kreditë për ekonomitë familjare, të cilat kanë pjesëmarrje prej 36.3 përqind në strukturën e gjithsej stokut të kredive, në vitin 2020 shënuan rritje të ngadalësuar vjetore krahasuar me rritjen dyshifrore në pesë vite me radhë. Në dhjetor 2020, rritja vjetore e tyre ishte 7.1 përqind, për 3.3 pikë përqindje më e ulët se vitin paraprak (grafik 20). Ngadalësimi i rritjes së kreditimit të ekonomive familjare i atribuohet në masë dinamikës së kredive të reja të këtij sektori, të cilat gjatë kësaj periudhe shënuan rënie prej 2.4 përqind (rënie prej 1.0 përqind në dhjetor 2019). Në kuadër të kredive të reja të ekonomive familjare, kategoria e kredive të reja hipotekare shënoi rritje të theksuar prej 12.7 përqind gjatë vitit 2020, mirëpo duke marr parasysh peshën më të lartë që kanë kreditë konsumuese në gjithsej kreditë e reja të ekonomive familjare, të cilat shënuan rënie vjetore prej 4.0 përqind, kreditë e reja për ekonomitë familjare e mbyllën vitin me rënie.

Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat në dhjetor 2020 përbënin 81.5 përqind të gjithsej detyrimeve dhe mjeteve vetanake.

Tabela 4. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2016		2017		2018		2019		2020	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	59.1	1.6%	67.2	1.7%	108.3	2.6%	67.0	1.4%	90.4	1.7%
Depozitat	2,897.8	79.7%	3,094.5	80.0%	3,362.9	80.3%	3,908.1	82.1%	4,360.7	81.5%
Huatë tjera	17.8	0.5%	16.0	0.4%	14.1	0.3%	42.1	0.9%	43.1	0.8%
Detyrimet tjera	203.4	5.6%	184.0	4.8%	169.1	4.0%	179.8	3.8%	202.2	3.8%
Borxhi i ndërruar	38.4	1.1%	37.4	1.0%	33.5	0.8%	43.4	0.9%	46.9	0.9%
Mjetet vetanake	420.6	11.6%	470.8	12.2%	497.7	11.9%	520.1	10.9%	610.2	11.4%
Gjithsej detyrimet dhe burimeve vetanake	3,637.1	100%	3,869.8	100%	4,185.5	100%	4,760.5	100%	5,353.4	100%

Burimi: BQK (2021)

Mjetet vetanake të sektorit bankar u karakterizuan me rritje vjetore të theksuar prej 17.5 përqind, si rezultat i mos-shpërndarjes së fitimit të vitit paraprak. BQK ka rekomanduar sektorin bankar për mos shpërndarjen e dividendës gjatë vitit 2020, për të krijuar kapacitete shtesë për absorbimin e humbjeve të mundshme si pasojë e efekteve të pandemisë në ekonominë e vendit.

Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 11.6 përqind, krahasuar me rritjen prej 16.2 përqind në dhjetor 2019. Depozitat e ekonomive familjare, kategoria që dominon strukturën në gjithsej depozitat në sektorin bankar, përshejtuan rritjen në 12.9 përqind nga 11.4 përqind një vit më parë, mirëpo ngadalësimi i rritjes apo edhe rënia e kategorive tjera të depozitave ndikoi në rritje të ngadalësuar të gjithsej depozitave (grafik 23).

Në të njëjtën periudhë, depozitat e ndërmarrjeve¹² shënuan rritje vjetore prej 11.1 përqind nga 25.0 përqind sa ishin një vit më parë. Rritja e depozitave të ekonomive familjare, mund t'i atribuohet, ndër të tjera, rritjes së të hyrave në ekonomi siç janë remitencat, kufizimit në shpenzime si pasojë e pasigurive të shkaktuara nga pandemia Covid-19, si dhe shpërndarja e mjeteve nga tërheqja e 10 përqind të kursimeve pensionale në FKPK (pjesë e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike) në fund të vitit. Ndërsa, ngadalësimi i rritjes së depozitave të ndërmarrjeve mund të ndërlidhet me rënien e aktivitetit ekonomik. Në dhjetor 2020, depozitat e transferueshme rritën pjesëmarrjen për 3.0 pikë përqindje në 63.9 përqind, ndërsa depozitat e afatizuara zvogëluan pjesëmarrjen në 23.4 përqind nga 26.2 përqind një vit më parë, ndikuar nga nevoja për likuiditet të mjeteve nga depozituesit në rrethana të pasigurisë së shtuar për shkak të pandemisë Covid-19.


Normat e interesit

Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita u tkurr në 4.5 përqind në krahasim me 4.8 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Norma mesatare e interesit në kredi në dhjetor 2020 u ul në 6.0 përqind, përderisa norma mesatare e interesit në depozita arriti në 1.5 përqind (grafik 24).

Normat e interesit në kredi


Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u ul në 5.9 përqind nga 6.2 përqind sa ishte në dhjetor 2019 (grafik 25). Në kuadër të kësaj kategorie, si norma e interesit në kreditë investuese, ashtu edhe ajo në kreditë jinvestuese shënuan rënie në fund të vitit.

Grafik 23. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2021)

Grafik 24. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2021)

¹² Ndërmarrjet private jofinanciare.

Sipas sektorëve të veçantë të ekonomisë, kreditë për të gjithë sektorët (sektori i bujqësisë, industrisë, shërbimeve dhe i sektorëve tjerë) u karakterizuan me rënie të normës së interesit krahasuar me një vit më parë (grafik 26).


Kreditë për ekonomitë familjare, gjithashtu shënuan rënie të normës mesatare të interesit në 6.2 përqind, nga 6.8 përqind sa ishte në dhjetor 2019.

Grafik 25. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2021)

Grafik 26. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë




Burimi: BQK (2021)

Normat e interesit në depozita


Norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat u karakterizua me rënie marginale. Në dhjetor 2020, interesi në depozita ishte 1.5 përqind, për 0.08 pikë përqindje më ulët sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 27). Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u zvogëluar për 0.2 pikë përqindje në 1.5 përqind, ndërsa norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi rritje marginale prej 0.08 pikë përqindje duke qëndruar në rreth 1.5 përqind në dhjetor 2020 (grafikët 28 dhe 29).

Grafik 27. Norma mesatare e interesit në depozita




Burimi: BQK (2021)

Grafik 28. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2021)

Grafik 29. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2021)

Performanca e sektorit bankar


Sektori bankar, përkundër përbaljes me sfidat e nxitura nga pandemia Covid-19, e mbylli vitin 2020 me rezultat financiar pozitiv, por më të ulët se ai i vitit paraprak. Profiti neto i realizuar në vitin 2020 ishte 79.9 milionë euro, për 7.4 përqind më i ulët se në vitin paraprak (grafik 30).

Grafik 30. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2021)

Grafik 31. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar




Burimi: BQK (2021)

Rënia e profitit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes më të lartë të shpenzimeve krahasuar me rritjen më të ngadalshme të të hyrave. Të hyrat e sektorit bankar arritën vlerën prej 279.3 milionë euro dhe u karakterizuan me rritje vjetore prej 6.1 përqind (grafik 31). Kontributin kryesor në rritjen e të hyrave e kishin të hyrat nga interesi, gjegjësisht, të hyrat prej kredive dhe letrave me vlerë. Njëkohësisht, të hyrat nga jointerеси shënuan rritje krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht të hyrat nga tarifat e komisionet.

Shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën në 199.4 milion euro dhe u karakterizuan me rritje vjetore prej 12.7 përqind (grafik 31). Shpenzimet u karakterizuan me rritje pothuajse në të gjitha kategoritë, por kontributin kryesor në rritje e kishin shpenzimet e provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë.

Rritja më e lartë e shpenzimeve krahasuar me rritjen e të hyrave ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit të rritet në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 31). Treguesit e profitabilitetit vazhduan trendin rënës të tri viteve të fundit, ku Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) qëndruan në 1.8 përqind dhe 15.6 përqind (grafik 32).

Grafik 32. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2021)


Treguesit e shëndetit financiarë

Pandemia Covid-19 ka ndikuar në rritjen e rreziqeve ndaj të cilave ekzpozohet sektori bankar, përkatësisht rrezikut kreditor, i cili u manifestua me përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditorë. Kreditë e klasit të dytë rritën pjesëmarrjen në 11.2 përqind në dhjetor 2020 nga 4.4 përqind në muajin janar 2020.¹³ Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive u rrit në 2.7 përqind, për 0.6 pikë përqindje më e lartë sesa në vitin paraprak. Materializimi i mëtejme i rrezikut të rritur kreditor në treguesit e cilësisë kreditorë pritet të ndodhë në vitin në vijim, pas skadimit të masave të ristrukturimit të mundësuar nga BQK. Në dhjetor 2020, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej stokut të kredive vazhdoi të jetë më i ulëti në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor. Raporti i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione ishte 139.6 përqind (grafik 33).

¹³ Klasifikimi kreditor sipas cilësisë së ekspozimeve kreditorë, sipas rregullores në fuqi, i grupon kreditë në 3 klasa kreditorë, duke filluar nga Klasa 1 që përfaqëson kreditë me cilësinë më të lartë. Klasa 3 përfshin kreditë joperformuese.

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel dhe cilësi të lartë të kapitalit. Rekomandimi i BQK-së për mos shpërndarjen e dividendës si masë për menaxhimin e pasojave të mundshme nga pandemia, si dhe ngadalësimi i kreditimit ndikuan që kapitali të shënoj rritje më të lartë sesa kreditimi, gjë që u reflektua në rritje të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.4 përqind nga 15.8 përqind në vitin paraprak. Pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivel të lartë. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra arriti në 39.6 përqind, që është lart mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25.0 përqind.

Grafik 33. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve




Burimi: BQK (2021)

3.4.3 Sektori pensional


Sektori pensional në vitin 2020 u karakterizua me ngadalësim të theksuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional arriti në 2.0 miliardë euro në fund të vitit 2020, që përkon me një rritje vjetore prej 1.2 përqind (grafik 34). Në ngadalësimin e theksuar të rritjes së aktivitetit të sektorit ndikoi tërheqja e 10 përqind të mjeteve të Trustit nga kontributdhënësit, në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike. Për më tepër edhe kthimi negativ në investime gjatë TM1 2020 (si rezultat i efekteve të Covid-19 në ekonomi dhe tregjet financiare), ndikoi në ngadalësimin e mëtejshëm të aktivitetit të sektorit pensional. Por, humbjet e shkaktuara gjatë tremujorit të parë u kompensuan gjatë tremujorëve vijues, me kthim bruto në investime prej 160 milion euro. Rrjedhimisht, sektori mbylli vitin me kthim pozitiv bruto nga investimet prej 72.3 milionë euro, pavarësisht përballjes me sfidën e shkaktuar nga pandemia Covid-19. FKPK realizoi kthim bruto në investime në vlerë prej 71.9 milionë euro, me çmim të njësisë prej 1.56 euro nga 1.51 euro sa ishte në ditën e fundit të muajit dhjetor 2019. FSKP-ja gjatë vitit 2020 realizoi kthim bruto në investime në vlerë prej 388.8 mijë euro, përderisa çmimi i njësisë u rrit në 184.4 euro nga 178.7 euro sa ishte në fund të dhjetorit 2019.

Grafik 34. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2021)

Grafik 35. Investimet e FKPK-së




Burimi: FKPK (2021)

Arkëtimet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 4.1 përqind. Vlera e kontributeve të arkëtuara në dhjetor 2020 arriti në 194.9 milion euro (187.2 milionë euro në vitin 2019). Vlera e

arkëtimeve të FKPK-së arriti në 194.4 milionë euro, ndërsa ajo e FSKP-së arriti në 554.1 mijë euro.

FKPK-ja dominon asetet e sektorit pensional me pjesëmarrje prej 99.6 përqind. FKPK-ja gjatë vitit 2020, ka rritur investimet në tregun e brendshëm, përkatësisht në instrumentin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, të cilat shënuan rritje vjetore prej 50.8 përqind, duke arritur në 451.1 milionë euro në fund të periudhës (grafik 35). Kurse, investimet në tregun e jashtëm shënuan rënie vjetore prej 8.6 përqind, duke zbritur në vlerën 1.35 miliard. Si rrjedhojë, rreth 32.0 përqind e mjeteve të FKPK-së ishin të alokuara në sektorin e brendshëm (24.8 përqind në vitin 2019) dhe pjesa tjetër në sektorin e jashtëm (fonde të përbashkëta investuese). Ngjashëm edhe mjetet e investuara prej FSKP-së, në masën më të madhe ishin të alokuara në sektorin e jashtëm (76.3 përqind). Investimet brenda vendit shënuan rritje vjetore prej 54.0 përqind kundrejt rënies vjetore prej 4.0 përqind të mjeteve të plasuar në sektorin e jashtëm. Në kuadër të investimeve brenda vendit, me rritje u karakterizua kategoria e parasë së gatshme, si dhe investimet në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës (grafik 36).


Grafik 36. Investimet e FSKP-së



3.4.4 Sektori i sigurimeve

Niveli i ndërmjetësisimit dhe densitetit të sektorit të sigurimeve ka mbetur në nivel të ngjashëm me vitin e kaluar, me ndryshime marginale krahasuar me vitet e fundit. Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, ndërmjetësimi i sektorit, vazhdon të qëndrojë në nivel relativisht të ulët krahasuar me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian, në 1.46 përqind (1.40 përqind në vitin 2019). Ngjashëm i ulët mbetet niveli i densitetit, i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori, i cili në vitin 2020 shënoi vlerën prej 54.85 euro (54.77 euro në vitin 2019).¹⁴

Grafik 37. Asetet e sektorit të sigurimeve



Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një shkallë më të ulët të koncentrimit krahasuar me sektorët tjerë të sistemit financiar të Kosovës. Indeksi i Herfindahl-it¹⁵ i kalkuluar për primet e shkruara bruto (PSHB) për vitin 2020 tregon 925 pikë (për vitin 2019 ishte 930 pikë), ndërsa po i njëjti indeks i kalkuluar duke marrë për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të

¹⁴ Sipas statistikave të publikuara në databazën e Insurance Europe, niveli i densitetit gjatë periudhës 2009-2018 në 32 vende të Evropës ishte 1,904 Euro (prime të shkruara për kokë banori), kurse niveli i depërtimit (ndërmjetësimit) në treg gjatë kësaj periudhe qëndroi në 7.25 përqind. <https://www.insuranceeurope.eu/insurancedata>

¹⁵ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n (s_i)^2$, ku S pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto) e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

ulëta, përkatësisht 845 pikë për vitin 2020 nga 853 pikë në vitin 2019. Në të njëjtën kohë, indeksi CR5¹⁶ për vitin 2020, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e sigurimeve rezulton 55.1 përqind (në vitin 2019 ishte 54.7 përqind), ndërsa i llogaritur në raport me asetet rezulton me 50.2 përqind (në vitin 2019 ishte 50.8 përqind). Koncentrimi është më i lartë te sektori i sigurimeve “jetë”, si rezultat i numrit më të vogël të siguruesve në këtë segment të tregut të sigurimit.

Asetet e sektorit të sigurimeve, në vitin 2020 përfaqësuan 2.8 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar. Vlera e gjithsej asetëve arriti në 219.2 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 11.6 përqind, duke ruajtur nivelin e rritjes së vitit të kaluar (11.8 përqind në vitin 2019) (grafik 37). Në kuadër të asetëve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Pozicioni tjetër me rritjen më të lartë ishte investimi në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës. Kurse, pozicioni i investimeve në prona, paraja e gatshme dhe depozitat në BQK shënuan rënie krahasuar me vitin e kaluar (tabela 5).

Sigurimet “jojetë”, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sektorit (91.4 përqind), shënuan rritje vjetore prej 12.0 përqind në vitin 2020. Ndërsa, sigurimet “jetë”, që përbëjnë pjesën e mbetur të asetëve, shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind.

Tabela 5. Asetet e sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2019	2020	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2019	Pjesëmarrja 2020
Paraja dhe depozitat në BQK	8.8	6.1	-31.5%	4.5%	2.8%
Depozitat në bankat komerciale	88.5	101.5	14.7%	45.0%	46.3%
Letrat me vlerë	27.6	35.7	29.4%	14.1%	16.3%
Huatë dhe të arkëtueshmet	20.9	21.9	4.7%	10.7%	10.0%
Pjesa e risiguruesit për rezervat teknike	13.1	18.4	40.0%	6.7%	8.4%
Investimet në prona	12.2	4.9	-60.3%	6.2%	2.2%
Asetet tjera	25.2	30.8	21.9%	12.9%	14.0%
Gjithsej tregu	196.5	219.2	11.6%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2021)

Sa i përket detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të madhe me gjithsej 63.7 përqind, pasuar nga ekuiteti me 26.9 përqind dhe pjesa e mbetur nga detyrimet tjera (tabela 6). Vlera e gjithsej kapitalit të siguruesve gjatë kësaj periudhe shënoi rritje të theksuar, prej 26.9 përqind, në 59.0 milionë euro.

Tabela 6. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2019	2020	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2019	Pjesëmarrja 2020
Rezervat teknike	129.4	139.6	7.9%	65.8%	63.7%
Kreditë dhe detyrimet nga letrat me vlerë të pavaruara	0.1	0.1	-29.4%	0.1%	0.0%
Llogarite tjera të pagueshme	16.0	16.1	0.8%	8.1%	7.3%
Detyrimet tjera	3.6	4.4	20.6%	1.9%	2.0%
Gjithsej kapitali i aksionarit	47.4	59.0	24.5%	24.1%	26.9%
Gjithsej tregu	196.5	219.2	11.6%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2021)

Rritja e kapitalit i atribuohet kryesisht rritjes së kapitalit aksionar të paguar, që u rrit për 7.2 milionë euro krahasuar me vitin paraprak, në 91.3 milionë euro. Ndikim në rritje, por në masë më të ulët kishte dhe fitimi i realizuar gjatë vitit 2020, në vlerë prej 3.4 milionë euro. Kurse, vlera e

¹⁶ Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 siguruesve me vlerat më të larta të asetëve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

humbjeve të akumuluar ndë vite nga sektori arriti në 43.6 milionë euro, duke neutralizuar rritjen e mëtejme të gjithsej kapitalit të sigurimeve.

Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2020 arriti në 99.3 milionë euro, duke ruajtur nivelin e arkëtimeve të vitit të kaluar (një rritje vjetore prej 0.1 përqind). Struktura e primeve të shkruara dominohet nga primet e sigurimit “jojetë” të cilat përfaqësojnë 96.4 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jojetë” në vitin 2020 arriti në 95.7 milionë euro, ngjashëm me vitin e kaluar. Përhapja e pandemisë Covid-19 në masë të madhe ka ndikuar në pothuajse përgjysmim të numrit të polisave të shitura, veçanërisht polisave kufitare. Përkundër rënies në numrin e polisave, vlera e primeve të shkruara gjatë vitit 2020 ka ruajtur nivelin e përgjithshëm të vitit të kaluar, si rrjedhojë e shitjes së polisave për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Sigurimet “jojetë” vazhdojnë të dominohen nga sigurimet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 62.3 përqind në gjithsej bruto primet e shkruara “jojetë”, ndërsa sigurimet vullnetare përbëjnë 37.7 përqind të gjithsej primeve të shkruara bruto “jojetë”.

Kurse, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jetë” arriti në 3.6 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 3.5 përqind krahasuar me vitin 2019.

Tabela 7. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në milionë euro)


Aktiviteti	2019	2020	Ndryshimi	Pjesëmarrja: 2019	Pjesëmarrja: 2020
Gjithsej Jojetë	95.7	95.7	0.0%	96.5%	96.4%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	47.0	53.8	14.6%	47.3%	54.2%
TPL+	2.5	1.8	-29.8%	2.5%	1.8%
Sigurime kufitare	8.0	4.1	-48.3%	8.0%	4.1%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	19.6	16.4	-16.3%	19.8%	16.5%
Kasko	5.4	5.5	1.2%	5.5%	5.5%
Kredi dhe garancione	4.5	4.4	-2.1%	4.6%	4.5%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	5.3	6.1	14.8%	5.3%	6.1%
Përgjegjësi e përgjithshme	3.5	3.6	4.6%	3.5%	3.7%
Gjithsej jetë	3.5	3.6	3.5%	3.5%	3.6%
Gjithsej tregu	99.2	99.3	0.1%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2021)

Në vitin 2020, produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 3.9 përqind, dhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej primet “jojetë” shënoi rritje krahasuar me vitin 2019. Rritja e pjesëmarrjes së sigurimeve të detyrueshme u ndikua kryesisht nga produktet “MTPL”. Ndërsa, sigurimet vullnetare shënuan rënie vjetore prej 5.9 përqind, njëkohësisht edhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej primet “jojetë” shënoi ulje. Rënia e pjesëmarrjes së sigurimeve vullnetare në gjithsej primet e shkruara bruto “jojetë” u ndikua nga tkurrja e primeve për produktet “Aksidenti dhe Shëndeti”, dhe “Kreditë dhe Garancionet” (tabela 7).

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rënie për 6.5 përqind, duke zbritur vlerën në 51.5 milionë euro (55.1 milionë euro në vitin 2019). Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 46.0 milionë euro (47.9

Grafik 38. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2021)

milionë euro në vitin 2019) ishin dëme të paguara nga siguruesit, ndërsa 5.5 milionë euro (7.1 milionë euro në vitin 2019) dëme të paguara nga BKS. Dëmet e paguara nga risiguruesit marrin pjesë me 10.7 përqind në gjithsej shumën e paguar të dëmeve nga siguruesit¹⁷ (15.5 përqind në vitin paraprak). Masat kufizuese të lëvizjes brenda vendit dhe mbyllja e aktiviteteve ekonomike joesenciale ndikuan në rënien e dëmeve të ndodhura dhe rrjedhimisht atyre të paguara. Po ashtu, edhe ndalimi dhe masat kufizuese të hyrjeve / daljeve në territorin e Kosovës, kanë ndikuar që të zvogëlohet edhe numri i ardhjeve të bashkatdhetarëve, që u reflektua në numrin e polisave të shitura kufitare.

Tabela 8. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në milionë euro)

Aktiviteti	2019	2020	Ndryshimi	Pjesëmarrja: 2019	Pjesëmarrja: 2020
<i>Gjithsej Jojetë</i>	47.2	45.1	-4.5%	98.5%	98.0%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	25.5	25.9	1.6%	53.3%	56.4%
TPL+	0.7	0.1	-86.1%	1.5%	0.2%
Sigurime kufitare	2.8	2.2	-21.3%	5.8%	4.8%
Marrëveshja MoU	0.4	0.3	-26.6%	0.8%	0.6%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	9.9	9.8	-1.1%	20.8%	21.4%
Kasko	3.1	3.2	0.8%	6.5%	6.9%
Kredi dhe garancione	0.8	1.8	123.8%	1.7%	3.9%
Sigurime në pronë	3.6	1.5	-58.5%	7.5%	3.2%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.3	0.3	-15.8%	0.7%	0.6%
<i>Gjithsej jetë</i>	0.7	0.9	25.6%	1.5%	2.0%
Gjithsej tregu	47.9	46.0	-4.1%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2021)

Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet “jojetë” zbriti në 45.1 milionë euro në vitin 2020 (47.2 milionë euro në vitin 2019). Kurse, shuma e dëmeve të paguara nga sigurimet “jetë” u rrit në 902.2 mijë euro nga 718.3 mijë euro sa ishte në vitin 2019, përkatësisht rritje vjetore prej 25.6 përqind.

Rënia e nivelit të dëmeve të paguara në vitin 2020 në kuadër të sigurimit “jojetë” u ndikua si prej pagesave të dëmeve të sigurimeve vullnetare, ashtu edhe atyre të detyrueshme (tabela 8). Shuma e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare u zvogëlua për 1.2 milion euro krahasuar me vitin paraprak, në 16.6 milionë euro, ose rënie vjetore prej 7.0 përqind. Kjo rënie u ndikua kryesisht nga produkti “Zjarr dhe dëmtime të tjera në pronë”. Kurse, dëmet e paguara nga sigurimet e detyrueshme, që kanë edhe pjesëmarrjen më të madhe në gjithsej portofolin e dëmeve të paguara, shënuan rënie më të ngadalësuar vjetore, prej 3.1 përqind, duke zbritur në vlerën 28.5 milionë euro.

Si rrjedhojë e zhvillimeve në të hyrat e sektorit (primeve të arkëtuara) dhe shpenzimeve (dëmet e paguara), raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara u zvogëlua për 3.7 pikë përqindje, në 51.8 përqind (grafik 38).

3.4.4.1 Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar prej 3.4 milionë euro, për dallim nga viti i kaluar ku kishte shënuar rezultat negativ financiar prej 4.7 milionë euro (tabela 9). Siguruesit “jojetë” shënuan fitime në vlerë prej 3.1 milionë euro, krahasuar me humbjet në vlerë prej 5.2 milionë euro gjatë vitit 2019. Ndërsa, siguruesit “jetë” realizuan fitim neto më të ulët, në vlerë prej 273.3 mijë euro krahasuar me 460.5 mijë euro në vitin 2019. Rezultati pozitiv financiar i sektorit reflekton rënien më të lartë të shpenzimeve, si rrjedhojë e uljes së nivelit të dëmeve të

¹⁷ Nuk përfshihet BKS-ja.

ndodhura (rënie vjetore për 7.6 përqind), dhe zvogëlimit të shpenzimeve operative (rënie vjetore për 13.5 përqind). Në anën tjetër, të hyrat që kanë burim kryesor nivelin e primeve të shkruara, mbetën në nivel pothuajse të ngjashëm me vitin e kaluar (për 136.7 mij euro arkëtime më shumë se në vitin 2019).

Tabela 9. Rezultati financiar (në milionë euro)

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020
Sigurimet Jojetë	6.2	1.0	-5.1	3.1
Sigurimet Jetë	0.2	0.6	0.5	0.3
Gjithsejtë tregu	6.4	1.6	-4.7	3.4

Burimi: BQK (2021)

Raporti i kombinuar i sektorit gjithashtu pasqyron përmirësimin e pozitës financiare. Në dhjetor 2020, ky raport qëndroi në 98.2 përqind, duke reflektuar raportin e dëmeve ndaj primeve të fituara neto prej 54.2 përqind dhe raportin e shpenzimeve ndaj primeve të fituara neto prej 44.0 përqind, pa përfshirë të hyrat nga interesat prej investimeve.

Sektori i siguruesve rriti nivelin e likuiditetit krahasuar me gjendjen në fund të vitit të kaluar, Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave qëndroi në nivel prej 102.6 përqind (96.6 përqind në vitin 2019), si rezultat i rritjes vjetore më të lartë të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 14.7 përqind, krahasuar me rritjen më të ulët prej 7.9 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve. Kurse, raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u rrit në 89.4 përqind (83.8 përqind në vitin 2019).

3.4.5 Sektori mikrofinanciar


Asetet

Në vitin 2020, asetet e sektorit mikrofinanciar arritën vlerën në 315.3 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 1.8 përqind (grafik 39). Ky rezultat në masë të madhe pasqyron revokimin e licencës së dy institucioneve mikrofinanciare/ financiare jobankare gjatë vitit të kaluar, asetet e të cilave janë duke u zbritur gradualisht nga bilanci i gjithsej sektorit.

Po ashtu, në ngadalësimin e përgjithshëm të aktivitetit kanë ndikuar edhe efektet negative të pandemisë Covid-19. Si rrjedhojë, kreditimi në vend ka shënuar rënie krahasuar me rritjen e theksuar të viteve të fundit, ndikuar si nga oferta ashtu edhe nga kërkesa për kredi. Po ashtu, niveli i huazimeve nga sektori i jashtëm ka shënuar rënie gjatë vitit 2020, që njëherësh paraqesin edhe burimin kryesor të financimit të këtij sektori.

Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar vazhdon të dominohet nga kreditë bruto (64.8 përqind) dhe lizingjet me një pjesëmarrje prej 18.2 përqind. Përderisa, kategoria e bilancit me bankat komerciale ka rritur pjesëmarrjen në gjithsej asetet e sektorit, për 5.3 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar, në 10.7 përqind në fund të dhjetorit 2020.

Grafik 39. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2021)


Kreditë

Vlera e stokut të kredive të lëshuara në vitin 2020 arriti në 204.3 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 7.1 përqind (rritje vjetore prej 19.6 përqind në vitin 2019) (grafik 40). Siç u specifikua më sipër, aktiviteti në rënie i kreditimit nuk reflekton vetëm goditjet që ka marr sektori nga pandemia Covid-19, por edhe revokimin e licencës së dy institucioneve mikrofinanciare, që është reflektuar edhe në portfolion e stokut të gjithsej kredive.

Grafik 40. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Grafik 41. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomikë




Kreditë ndaj ekonomive familjare u ndikuan më tepër nga këto zhvillime, duke u zvogëluar për 9.4 përqind, në vlerën prej 134.1 milionë euro. Kurse, kreditë ndaj korporatave jofinanciare gjatë kësaj periudhe shënuan rënie vjetore prej 2.4 përqind, duke zbritur vlerën në 70.2 milionë euro.

Aktiviteti kreditues, sipas sektorëve ekonomikë, reflekton trendin e përgjithshëm të kreditimit të korporatave jofinanciare, ku kemi ngadalësim të theksuar / rënie të kreditimit në sektorë të caktuar, përjashtuar sektorin e shërbimeve financiare, që shënoi rritje (grafik 41). Sektori i bujqësisë, tregtisë dhe shërbimeve tjera u karakterizuan me rënie, përderisa sektori i ndërtimtarisë dhe industrisë ngadalësim të rritjes.

Lizingjet

Lizingjet janë kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar. Për dallim nga zhvillimet në aktivitetin kreditues, lizingjet u zgjeruan gjatë vitit 2020 edhe pse ritmi i rritjes ishte dukshëm më i ulët se në vitin paraprak, prej 8.8 përqind (38.5 përqind rritje vjetore në vitin 2019)(grafik 42). Në ngadalësimin e rritjes së gjithsej lizingjeve ndikoi ecuria e lizingjeve financiare ('hipotekar' dhe 'për paisje') dhe lizingjeve tjera.


Grafik 42. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Normat e interesit


Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në përgjithësi nuk pësoi ndryshime të theksuara, duke zbritur në 20.3 përqind nga 20.5 përqind sa ishte në dhjetor 2019.

Grafik 43. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2021)

Grafik 44. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2021)


Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare mbeti pothuajse e pandryshuar me periudhën paraprake, në 21.6 përqind, kurse ndaj korporatave jofinanciare u zvogëlua për 0.8 pikë përqindje, në 18.3 përqind (grafik 43).

Në kuadër të kredive ndaj korporatave jofinanciare, norma mesatare e interesit u zvogëlua për sektorin e bujqësisë dhe industrisë, ndërsa u rrit për sektorin e shërbimeve, që ka normën më të ulët të interesit. Ndërsa, kreditë për sektorin e industrisë vazhdojnë të kenë normën më të lartë të interesit prej 20.3 përqind përkundër rënies prej 1.2 pikë përqindje nga viti i kaluar (grafik 44).

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar realizoi fitim më të ulët në vitin 2020, në vlerë prej 0.1 milion euro krahasuar me 9.3 milionë euro fitim të realizuar një vit më parë.


Grafik 45. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2021)


Rënia më e përshpejtuar e të hyrave krahasuar me rënien e shpenzimeve ka ndikuar në ulje të theksuar të fitimit të realizuar gjatë vitit 2020 (grafik 45). Të hyrat nga interesi në kredi shënuan rënien më të theksuar për 20.1 përqind krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i tkurrjes së aktivitetit kreditues gjatë vitit 2020. Ndërsa, rënia e shpenzimeve erdhi si rezultat i reduktimit të shpenzimeve për interesa, si rrjedhojë e zvogëlimit të huazimeve nga sektori i jashtëm (që në vitet e fundit kishte shënuar rritje të theksuar), dhe uljes së shpenzimeve tjera operative. Kurse, kategoria e vetme që shënoi rritje ishte ajo e shpenzimeve të jointerestit, e që

Grafik 46. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2021)

Grafik 47. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2021)

reflekton nivelin më të lartë të provizionimit për humbjet e mundshme nga kreditë. Rezultatet financiare gjatë vitit 2020 u reflektuan dhe në treguesit e profitabilitetit të sektorit, të cilat shënuan rënie të konsiderueshme krahasuar me periudhën e kaluar (grafik 46). Kriza pandemike ka ndikuar në rritjen e rrezikut kreditor të sektorit. Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë është rritur për 0.4 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake, duke arritur në 3.0 përqind. Niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione është rritur gjithashtu, në 142.2 përqind në dhjetor 2020 (grafik 47).

3.4.6 Ndhmësit financiarë

Sektori i ndihmësve financiarë përbën numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, megjithëse menaxhon vetëm 0.2 përqind të gjithsej aseteve. Ky sektor përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjencionet për transferim të parave (ATP). Vlera e aseteve të ndihmësve financiarë në vitin 2020 arriti në 20.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 24.8 përqind.

Të hyrat e ndihmësve financiarë shënuan rritje vjetore prej 20.0 përqind dhe arritën vlerën në 10.0 milionë euro. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiarë dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 76.1 përqind), të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 34.1 përqind. Shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 13.1 përqind, duke arritur vlerën në 5.8 milionë euro. Neto fitimi i realizuar nga këto institucione financiare në vitin 2020 arriti në 4.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 30.7 përqind. Rritja e aktivitetit të sektorit, që u reflektua dhe në të hyrat dhe fitimin e realizuar gjatë vitit 2020, është ndikuar nga dinamikat e ndërlidhura me pandeminë Covid-19. Mbyllja e kufijve tokësor dhe ajror të cilat pamundësuan ardhjen e mërgatës, si dhe rënduan gjendjen ekonomike të popullatës, ndikuan në rritjen e dërgesave të remitencave, të cilat arritën vlerë rekorde prej 980.0 milionë euro. Në masë të madhe, remitencat u dërguan përmes ATP-ve, duke ndikuar në rritjen e aktivitetit të tyre.

3.5. Projektionet makroekonomike për vitin 2021

Si rezultat i masave kufizuese për menaxhimin e përhapjes së pandemisë, aktiviteti ekonomik ka shënuar rënie prej 3.9 përqind në vitin 2020. Sa i përket vitit 2021, projektionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të rikuperohet drejt niveleve të para krizës duke shënuar rritje prej rreth 4.4 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe neto eksportet. Megjithatë, rreziqet ndaj aktivitetit ekonomik mbasin të larta, kryesisht për shkak të zhvillimeve të pandemisë dhe zhvillimeve politike.

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 2.8 përqind, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 2.8 përqind dhe konsumi publik me 2.4 përqind. Faktorët që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit privat, ndër të tjera, janë edhe rritja e remitencave, rritja e kredive si dhe Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike. Deri në fund të vitit 2021, remitencat pritet të shënojnë rritje vjetore prej rreth 11.8 përqind.

Investimet në vitin 2021 parashihet të shënojnë rritje reale prej 6.8 përqind, bazuar në parashikimet për rritje të konsiderueshme të investimeve publike por edhe të investimeve private. Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve pritet të vazhdojë të ketë kreditimi bankar, i cili po karakterizohet me ritëm më të shpejtë të rritjes dhe me norma më të ulëta të interesit. Po ashtu, ndryshimet në politikën tatimore gjatë viteve të kaluara, pritet të nxitin investimet private. Investimet publike janë duke u karakterizuar me rënie viteve të fundit, mirëpo duke u bazuar në buxhetin e vitit 2021 ku parashihet rritje e konsiderueshme e shpenzimeve kapitale, pritet që gjatë këtij viti të ketë rritje.

Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2021 pritet të kenë një kontribut të lehtë negativ në BPV krahasuar me vitin 2020 kur ishte shënuar kontribut shumë i lartë negativ. Ky

supozim mbështetet kryesisht në parashikimet e rritjes së eksportit të shërbimeve prej 40.5 përqind, ndërkohë që edhe eksporti i mallrave pritet të rritet për 35.5 përqind, si rezultat i parashikimeve për rritje të çmimeve të metaleve. Në kuadër të importeve, pritet që importi i mallrave të rritet për rreth 16.5 përqind në terma realë, ndërsa importi i shërbimeve pritet të rritet për rreth 13.9 përqind. Rrjedhimisht, deficitit tregtar i mallrave dhe shërbimeve në terma realë pritet të jetë më i lartë për 0.7 përqind krahasuar me vitin 2020.

Sa i përket inflacionit, norma mesatare pritet të jetë rreth 1.6 përqind që është nivel më i lartë krahasuar me vitin 2020. Ky nivel i inflacionit është në përputhje me parashikimet e inflacionit në Eurozonë, zhvillimit të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe pritjeve për rritje të aktivitetit ekonomik në Kosovë.

4. Licencimi dhe rregullimi i sistemit financiar

Bazuar në Ligjin për BQK-në, objektivi parësor i BQK-së është nxitja dhe mbajtja e një sistemi financiar stabil. BQK-ja angazhohet në arritjen e këtij objektivi përmes përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive si autoritet përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës.

BQK-ja, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoritet licencues, rregullues dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare në vend, angazhohet në:

- Rregullimin e hyrjes në treg të investitorëve potencialë, duke përcaktuar kritere për licencimin e institucioneve financiare dhe të atyre institucioneve, që posedojnë kapital të mjaftueshëm për mbështetjen e aktiviteteve të parapara, që prezantojnë përgatitjet e duhura për vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut, politika dhe procedura adekuate për kontrollin e tij, si dhe administratorë me nivel të lartë kualifikimi, profesionalizmi dhe etike.
- Hartimin dhe mirëmbajtjen e kornizës rregullatore të përbërë nga një tërësi kriteresh minimale dhe kërkesash rregullative të aplikueshme ndaj institucioneve financiare, në harmoni me legjislacionin primar, Direktivat Evropiane, si dhe standardet ndërkombëtare;
- Zhvillimin e një procesi mbikëqyrës efektiv, duke zbatuar parimet e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, nëpërmjet ekzaminimeve në vend, si dhe analizimin, vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave të institucioneve financiare, vlerësimin e trendëve të ardhshëm financiar; si dhe ndërmarrjen e masave përmirësuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
- Bashkëpunimin me institucionet financiare të licencuara dhe mbikëqyrura nga BQK-ja, si dhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse për bankat, që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të kryerjes së funksioneve të saj mbikëqyrëse, BQK-ja synon nivelet më të larta të integritetit, profesionalizmit, efikasitetit, transparencës dhe zhvillimit të përhershëm të kapaciteteve të saj mbikëqyrëse.


4.1. Licencimi

Sipas Ligjit për BQK-në, autoriteti i vetëm përgjegjës për rregullimin, licencimin/regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK-ja ka për qëllim që të sigurojë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës të licencimit, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues financiar të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore.

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2020, sipas llojit të institucioneve financiare të licencuara dhe regjistruara që ofrojnë shërbime financiare në Kosovë, bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të renditura sipas peshës së tyre në sistem është paraqitur në figurën 48.

Figura 48. Struktura e sistemit financiar në Kosovë



*3 IFJB me veprimtari të kredidhënies, 4 IFJB me veprimtari të pagesave dhe 2 IFJB me veprimtari të lizingut kryejnë edhe veprimtari tjera

Struktura e sistemit financiar përbëhet nga gjithsej 121 institucione financiare, të cilat janë licencuar dhe regjistruar, si dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullativ në fuqi të BQK-së.


4.1.2 Rrjeti i sistemit financiar

Në fund të vitit 2020, bankat e ushtruan veprimtarinë e tyre në gjithsej 50 degë dhe 149 zyra brenda vendit (grafik 49). Gjatë këtij viti me miratim të BQK-së janë hapur 2 degë ndërsa janë mbyllur 10 zyra. Ngushtimi i rrjetit fizik të zyrave është bërë kryesisht bazuar në vlerësim të performancës dhe efikasitetit të tyre dhe si rrjedhojë e zgjerimit të shërbimeve të automatizuara si: e-bankingut, bankomatëve, terminaleve të shitjes, mobile bankingut etj.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit bankar përfshin pothuajse të gjithë vendin përkundër ngushtimit të shënuar në raport me numrin e degëve dhe zyrave (tabela 10). Megjithatë, vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe zyrave në regionin e Prishtinës (33.0 përqind), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (28.8 përqind) siç edhe shihet në grafikun 50.


Trendi pesëvjeçar sugjeron strategji konsistente të bankave sa i përket fokusimit gjeografik të rrjetit bankar. Marr parasysh që nuk kemi ndryshim të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe në raport me përqindjen e degëve dhe zyrave bankare, përkundër ndryshimeve në raport me numrin e

Grafik 49. Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave



Burimi: BQK (2021)

Grafik 50. Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve



Burimi: ASK (2021)

degëve dhe zyrave, për arsye se ngushtimi i rrjetit është bërë në mënyrë proporcionale në të gjitha regionet.

Tabela 10. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave


Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	95	36%	38	15%	42	16%	52	20%	35	13%	262
2017	83	35%	37	16%	39	16%	47	20%	32	13%	238
2018	74	33%	35	16%	38	17%	44	20%	31	14%	222
2019	71	33%	35	16%	37	17%	44	20%	30	14%	217
2020	70	33%	34	16%	32	15%	41	19%	34	16%	211

Burimi: BQK (2021)

Siguruesit veprimtarinë e tyre e ushtrojnë përmes 67 degëve, 409 zyrave dhe 61 agjentëve brenda vendit (shih grafikun 51). Gjatë vitit 2020, kemi ngushtim të rrjetit të përgjithshëm të siguruesve në vend, gjë që reflekton strategjinë e zvogëlimit të shpenzimeve të ndjekur nga siguruesit.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit të siguruesve përfshin pothuajse të gjithë vendin, megjithatë nuk përputhet me shpërndarjen gjeografike të popullsisë. Përderisa përqendrimi më i madh i popullsisë është në regjionin e Prishtinës (28.8 përqind, shih grafikun 50) përqendrimi i rrjetit të siguruesve është në regjionin e Pejës që është një nga regjionet më pak të populluara në vend (shih grafikun 50) dhe kjo strukturë është konsistente gjatë pesë viteve të fundit (tabela 11).

Grafik 51. Rrjeti i siguruesve



Burimi: BQK (2021)

Tabela 11. Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve

Vitet	Rajoni i Prishtinës		Rajoni i Prizrenit		Rajoni i Pejës		Rajoni i Gjilanit		Rajoni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	11	15.3%	11	15.3%	21	29.2%	18	25.0%	11	15.3%	72
2017	13	17.8%	11	15.1%	20	27.4%	19	26.0%	10	13.7%	73
2018	14	18.9%	11	14.9%	20	27.0%	19	25.7%	10	13.5%	74
2019	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2020	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67

Burimi: BQK (2021)

Fondet pensionale aktivitetin e tyre e zhvillojnë vetëm përmes zyrave qendrore me lokacion në Prishtinë. Institucionet mikrofinanciare në fund të vitit 2020, aktivitetin e tyre e ushtrojnë përmes 128 zyrave të shpërndara brenda vendit. Gjatë vitit 2020 është aprovuar hapja e 2 zyrave, si dhe zhvendosja e 6 zyrave të tjera të IMF-ve.

Tabela 12. Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	27	26%	24	23%	23	22%	19	18%	12	11%	105
2017	29	26%	26	23%	24	21%	20	18%	14	12%	113
2018	32	27%	28	23%	24	20%	22	18%	14	12%	120
2019	37	29%	30	23%	24	19%	23	18%	14	11%	128
2020	38	29%	30	23%	25	19%	23	18%	14	11%	130

Burimi: BQK (2021)

Shpërndarja gjeografike e zyrave të institucioneve mikrofinanciare është e përqendruar vetëm në dy regjione të vendit konkretisht në regjionin e Prishtinës dhe të Prizrenit (tabela 12).

Institucionet financiare jobankare në fund të vitit 2020, aktivitetin e tyre e ushtruan në gjithsej 827 zyra dhe agjentë të shpërndarë brenda territorit të vendit. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të institucioneve financiare jobankare është i përqendruar në pothuajse në gjithë vendin, me përjashtim të regjionit të Mitrovicës (tabela 13).

Tabela 13. Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjiçanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	136	29%	86	18%	101	22%	103	22%	41	9%	467
2017	158	30%	97	18%	109	21%	114	22%	52	10%	530
2018	181	30%	112	19%	122	20%	129	22%	53	9%	597
2019	223	31%	127	18%	139	19%	159	22%	65	9%	713
2020	278	34%	144	17%	153	19%	173	21%	79	10%	827

Burimi: BQK (2021)

4.1.3 Aktiviteti i licencimit

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të licencimit dhe funksionimit normal të veprimtarive financiare, BQK-ja gjatë vitit 2020 ka shqyrtuar gjithsej 494 kërkesa nga të cilat 11 aplikacione për licencim/regjistrim dhe 483 kërkesa të institucioneve financiare për miratim të transaksioneve, të cilat sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë miratim paraprak të BQK-së (tabela 14). Këtu nuk përfshihen: i) kërkesat e shqyrtuara të bartura për vendimmarrje në vitin 2021; ii) shprehjet e interesimit për licencim/regjistrim, iii) kërkesat të cilat vlerësohen mirëpo nuk janë subjekt i miratimit të BQK-së dhe iv) pyetjet, njoftimet dhe vlerësimet e tjera të shqyrtuara nga BQK-ja.

Gjatë vitit 2020 ngjashëm me vitin e kaluar, BQK-ja ka pranuar kryesisht kërkesa për regjistrim të IFJB-ve.

Në përgjithësi struktura e kërkesave për licencim mbetet e ngjashme. Një rënie e lehtë është shënuar në numrin e këtyre kërkesave në krahasim me vitin paraprak (shih tabelën 14).

Tabela 14. Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK

Transaksionet	2019						2020					
	Bankë	Fonde pensionale	IF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime	Gjithsej	Bankë	Fonde pensionale	IF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime	Gjithsej
Aplikacionet	1	0	5	0	2	8	0	0	11	0	0	11
Aksionarët kryesor dhe ndryshime në kapital	0	0	3	0	1	4	0	0	3	5	2	10
Drejtorë dhe menaxherë të lartë	24	0	29	40	8	101	17	0	47	48	2	114
Auditori i jashtëm	11	2	32	18	11	74	10	2	26	14	3	55
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit	4	0	6	2	0	12	7	2	7	2	1	19
Përvetësimet e interesit të kapitalit dhe transferimi i portofolit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zgjerim i veprimtarive financiare	0	0	0	3	0	3	1	0	5	1	1	8
Hapja, zhvendosja dhe rryllja e degëve dhe zyrave brenda dhe jashtë vendit	21	0	68	44	5	138	13	0	55	27	5	100
Licencimi dhe regjistrimi i agjentëve/brokerëve	0	0	116	4	32	152	7	0	96	1	4	108
Tërheqja e licencimit/regjistrimit	0	0	72	10	2	84	0	0	53	9	0	62
Tjetër	0	0	0	3	0	3	0	0	0	6	1	7
Gjithsej	61	2	331	124	61	579	55	4	303	113	19	494

Burimi: BQK (2021)

Në kuadër të këtyre 11 aplikacioneve për licencim/regjistrim, BQK-ja gjatë vitit 2020 ka procesuar aplikacionet për licencim/regjistrim financiar si në vijim:

- Miratimin e kërkesës së IFJB AGC Faktor për likuidim vullnetar;
- Miratimin e regjistrimit të Këmbimores "Gimi" SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave;
- Aplikacionin për regjistrim të Euro Eki SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave (ky aplikacion është tërhequr nga aplikuesi);

- Miratimin e regjistrimit të ForexLena SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave;
- Refuzimin e regjistrimit të FINSER si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së lizingut dhe shërbimit të pagesave;
- Miratimin e regjistrimit të BKV SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave;
- Miratimin e regjistrimit të PreExchange SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave;
- Miratimin e regjistrimit të Dioni & AI SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave;
- Miratimin e regjistrimit të Paysera Kosova SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike, shërbimit të pagesave dhe këmbimit valutor;
- Miratimin e regjistrimit të Këmbimores Rifa SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave;
- Miratimin e regjistrimit të ForexLeo SH.P.K. si Institucion Financiar Jobankar për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave;

Në procesin licencues, BQK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për qeverisje të përgjegjshme dhe efektive, duke vlerësuar strukturat organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjësisë.

Bazuar në rregullativën në fuqi, BQK-ja ka shqyrtuar (miratuar/refuzuar):

- Miratimin e katër kërkesave për ndryshim në aksionar kryesor;
- Miratimin e 54 kërkesave të auditorit të jashtëm. Një kërkesë e tillë është refuzuar ndërsa dy të tjera janë tërhequr gjatë procesit të shqyrtimit nga institucionet të cilat i ka parashtruar;
- Miratimin e 5 kërkesave të anëtarit të jashtëm të komitetit të auditimit;
- Miratimin e 22 kërkesave për emërim të anëtarëve të ri të bordit të drejtorëve në institucione financiare. Dy kërkesa të tilla janë refuzuar ndërsa një tjetër është tërhequr gjatë procesit të shqyrtimit nga institucioni parashtrues. Po ashtu një kërkesë e tillë që është pranuar gjatë vitit 2020, nuk është finalizuar brenda këtij viti;
- Miratimin e 65 kërkesave për miratim të emërimit të menaxherëve të lartë. Tetë kërkesa të këtij lloji janë refuzuar ndërsa gjashtë nga to janë tërhequr gjatë procesit të shqyrtimit nga institucionet parashtruese. Katër kërkesa për miratim të emërimit të menaxherëve të lartë të pranuar gjatë vitit 2020 nuk janë arritur të finalizohen deri në fund të vitit;
- Miratimin e 38 kërkesave për hapjen e degëve dhe/ose zyrave të reja të institucioneve financiare. Një kërkesë e tillë është tërhequr gjatë procesit të shqyrtimit nga institucioni parashtrues;
- Miratimin e 3 kërkesave për licencim të borkerëve të ri të ndërmjetësuesve në sigurime;
- Miratimin e 96 kërkesave për licencim/regjistrim të agjentëve të ri të institucioneve financiare. Një kërkesë e këtij lloji është tërhequr gjatë procesit të shqyrtimit ndërsa për tre të tjera, procesi i shqyrtimit nuk ka arritur të finalizohet brenda vitit 2020.
- Miratimin e 33 kërkesave për mbylljen e zyrave të institucioneve financiare. Dy kërkesa të tilla të pranuar gjatë vitit 2020 nuk janë finalizuar deri në fund të këtij viti;

- Miratimin e 16 kërkesave për miratim të ndryshimeve në akte të themelimit dhe/apo statute të institucioneve financiare. Dy kërkesa të tilla janë tërhequr gjatë procesit të shqyrtimit nga institucionet parashtruese ndërsa një kërkesë e tillë nuk është arritur të finalizohet gjatë vitit 2020.
- Miratimin e një kërkesë për ndryshim të emrit të një ndërmjetësuasi në sigurime;
- Miratimin e pesë kërkesave për ndryshime në kapital;
- Miratimin e 62 kërkesave për tërheqje të licencës/regjistrimit për agjentët e institucioneve financiare;
- Miratimin e gjashtë kërkesave për zgjerim të veprimtarisë. Një kërkesë e tillë është tërhequr nga institucioni parashtrues ndërsa për një tjetër nuk është arritur të finalizohet gjatë vitit 2020;
- Miratimin e 29 kërkesave për zhvendosje të degëve dhe/ose zyrave të institucioneve financiare. Një kërkesë e këtij lloji është tërhequr gjatë procesit të shqyrtimit nga institucioni parashtrues ndërsa një-tjetër nuk është arritur të finalizohet brenda vitit 2020;
- Miratimin e katër kërkesave për shitje online të produkteve të sigurimit si dhe;
- Miratimin e kërkesës së BKS për organizim të provimit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional.

4.2. Rregullimi

4.2.1 Korniza ligjore dhe rregullative e sistemit financiar

Hartimi i akteve të reja ligjore dhe nënligjore, si dhe rishikimi i kornizes ligjore dhe rregullative në fuqi synon plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kësaj kornize, në funksion të realizimit të një mbikëqyrjeje më efektive dhe në zbatim të kërkesave ligjore për institucionet financiare të licencuara/regjistruara dhe të mbikëqyrura nga BQK-ja, nëpërmjet përafrimit me kornizën rregullative të Bashkimit Evropian, me parimet bazë për mbikëqyrjen efektive dhe dokumentet e Komitetit të Bazelit, si dhe institucionet tjera relevante.

Deri më tani, BQK-ja ka ndërtuar një kornizë rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare, si dhe e mbështetur në vazhdimësi nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID, Thesari Amerikan, KfW, GIZ, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Korniza ligjore dhe rregullative është hartuar në drejtim të përafrimit me direktivat evropiane që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Gjithashtu, BQK-ja ka vazhduar me procesin gradual drejt përafrimit me parimet bazë për mbikëqyrjen e bankave të nxjerra nga BIS – Bank for International Settlements dhe parimet bazë për mbikëqyrjen e siguresve të nxjerra nga IAIS – International Association for Insurance Supervision. Meqenëse direktivat, standardet ndërkombëtare dhe parimet e lartcekura lidhur me rregullimin e institucioneve financiare dhe fushën e veprimtarisë së tyre janë të karakterit dinamik, kjo ndikon që hartimi i kornizës ligjore dhe rregullative të jetë një proces i vazhdueshëm dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim adekuat të këtyre instrumenteve juridike për nevojat e sektorit financiar në Kosovë.

Bazuar në atë që u cek më lartë, BQK-ja ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të parapara me planin vjetor për vitin 2020 dhe me angazhimin e vazhdueshëm në përmbushjen e detyrave dhe

përgjegjësi të caktuara në kuadër të mbikëqyrjes financiare, si dhe në mbështetjen departamenteve dhe divizioneve tjera të BQK-së lidhur me kornizën ligjore dhe rregullative. Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për mbikëqyrjen e institucioneve financiare BQK-ja gjatë vitit 2020 ka realizuar aktivitetet në vijim.

4.2.2 Korniza ligjore dhe rregullative për mbikëqyrjen e bankave

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e bankave, gjatë vitit 2020 janë realizuar aktivitetet si në vijim.

4.2.2.1 Ligji i ri për Banka

Gjatë vitit 2019 BQK-ja ka përfunduar hartimin e draftit të Ligjit të ri për banka, i cili përfshin edhe komentet e pranuar nga Shoqata e Bankave. Ligji i ri është ristrukturuar në harmoni me Direktivat Evropiane, standardet ndërkombëtare bankare, si dhe praktikat legjislative regjionale. Draftimi i tij është përkrahur nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës bankare të angazhuar në kuadër të Thesarit Amerikan dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ligji i ri është proceduar te Bordi Ekzekutiv i BQK-së gjatë vitit 2019 dhe pritet që i njëjti gjatë vitit 2021 të procedohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës që më pas të procedohet në Kuvend të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

4.2.2.2 Korniza Rregulluese për Rimëkëmbje, Përmbyllje (Recovery and Resolution) dhe Likuidim të Bankave

Grupi punues brenda BQK-së ka hartuar Kapitullin e Ligjit të ri për banka që adreson pjesën e rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit bankar me mbështetjen e asistencës teknike të BERZH-it. Pas miratimit të Ligjit të ri për Banka, planifikohet të miratohen 13 rregullore të cilat janë draftuar nga grupi punues dhe që rrjedhin nga pjesa e re e draftuar në ligj, që rregullon procesin e rimëkëmbjes dhe likuidimit bankar të bazuar në Direktivën Evropiane për të njëjtin proces.

4.2.2.3 Përafrimi me rregullativën e BE lidhur me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në banka

Gjatë vitit 2020 BQK ka finalizuar draftet e Rregulloreve dhe udhëzuesve metodologjik si në vijim:

- Rregullore për treguesin e mbulimit me likuiditet;
- Rregullore për treguesin e financimit të qëndrueshëm neto;
- Udhëzimi metodologjik për zbatimin e Rregullores për treguesin e financimit të qëndrueshëm neto;
- Udhëzimi metodologjik për zbatimin e Rregullores për treguesin e mbulimit me likuiditet.

Këto dy Draft rregullore, BQK-ja i ka dërguar për komente edhe në Shoqatën e Bankave. Nga Shoqata e Bankave janë pranuar disa komente të cilat janë adresuar në draft rregulloret në ato raste kur është konsideruar e nevojshme një gjë e tillë.

Këto rregullore dhe udhëzimet janë hartuar me qëllim të përafrimit me kërkesat rregullative të BE-së. Rregullorja për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet (LCR) është bazuar në Rregulloren e BE-së 2015/61 mbi kërkesën e mbulimit me likuiditet të dt. 10 Tetor 2014 si dhe Rregulloren e BE-së 2018/1620 mbi plotësimin e rregullores 2015/61 mbi kërkesën e mbulimit me likuiditet e datës

13 korrik 2018. Ndërsa Rregullorja për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) - është bazuar në Rregulloren e BE-së 2019/876 e datës 20 Maj 2019.¹⁸

Draft rregullorja për treguesin e financimit të qëndrueshëm neto, Draft rregullorja mbi treguesin e mbulimit me likuiditet si dhe udhëzimet në zbatim të tyre pritet të miratohen brenda vitit 2021.

4.2.2.4 Korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme

BQK-ja ka vazhduar me projektin e rishikimit të kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme, në funksion të përditësimit të kërkesave për të përmirësuar praktikën e vlerësimit të pronave të paluajtshme nga ana e institucioneve financiare në përputhje me standardet evropiane (European Valuation Standards - EVS 2016). Ky projekt është zhvilluar me mbështetjen e këshilltarit nga Thesari Amerikan. Në kuadër të këtij projekti, është hartuar Rregullorja e re për vlerësimin e pronave të paluajtshme, e cila pritet të miratohet nga Bordi i BQK-së gjatë vitit 2021.

4.2.2.5 Rregullore për huadhënie brenda ditore dhe njëditore

Kjo rregullore është hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2020. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe kriteret sipas të cilave BQK mund të ofrojë hua të kolateralizuar brenda ditore dhe hua njëditore për likuiditet për bankat e kualifikuara. Qëllimi i këtyre dy lehtësirave për likuiditet është t'i mundësojë BQK-së të kryejë operacionet me bankat e kualifikuara dhe të sigurojë një funksionim të sigurt të sistemit të shlyerjes së pagesave ndërbankare.

4.2.2.6 Rregullore për teknologji të informacionit për banka

Rregullore për teknologji të informacionit është miratuar në vitin 2020. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë bankat për organizimin dhe për funksionimin e sistemeve të tyre të teknologjisë së informacionit (në tekstin e mëposhtëm TI-së), të cilat mundësojnë uljen e rrezikut operacional që mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i sistemeve të TI-së, si dhe të ruajë besueshmërinë e këtyre sistemeve në mbështetjen e veprimtarisë së bankave.

4.2.2.7 Rregullore për reklamimin e shërbimeve financiare¹⁹

Kjo rregullore është hartuar me qëllim të përcaktimit të kushteve të përgjithshme dhe specifike për reklamimin e shërbimeve financiare, detyrimet dhe përgjegjësitë e një ofruesi të shërbimeve financiare në lidhje me mesazhet reklamuese dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me këtë lloj të reklamimit, si dhe rregullon reklamimin që promovon në mënyrë të drejtpërdrejtë një ofrues të shërbimeve financiare dhe/ose tërë veprimtarinë e tij dhe jo vetëm shërbimet individuale financiare të ofruara prej tij. E njëjta është miratuar në janar 2020.

4.2.2.8 Aktet tjera të hartuara dhe/ose të miratuara për rregullimin e bankave

Gjatë vitit 2020 janë finalizuar dhe miratuar instrumentet rregullative si në vijim:

- Rregullore për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja;
- Rregullore për raportimin e bankave;

¹⁸ (REGULATION (EU) 2019/876 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 20 May 2019 amending Regulation (EU) No 575/2013 as regards the leverage ratio, the net stable funding ratio, requirements for own funds and eligible liabilities, counterparty credit risk, market risk, exposures to central counterparties, exposures to collective investment undertakings, large exposures, reporting and disclosure requirements, and Regulation (EU) No 648/2012)

¹⁹ Kjo rregullore është e zbatueshme për banka, sigurues, IMF dhe IFJB si dhe degët e huaja të këtyre lloj institucioneve.

Në vitin 2020, në kuadër të grupit punues është rishikuar edhe manuali për licencimin bankar me qëllim të adaptimit të tij me ndryshimet në rregullore për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja, i cili ende nuk është proceduar për miratim të organet vendimmarrëse të BQK-së.

4.3. Korniza rregullative për IMF dhe IFJB

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e institucioneve mikrofinanciare, si dhe institucioneve financiare jobankare gjatë vitit 2020 janë hartuar aktet ligjore dhe nënligjore si në vijim:

4.3.1 Ligji për IMF dhe IFJB

Drafti i këtij ligji është hartuar nga grupi punues ndërinstitucional në kuadër të cilit ka qenë edhe BQK-ja. Ky draft dhe është miratuar nga Qeveria gjatë vitit 2018 dhe më pas është proceduar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

4.3.2 Rregulloret e miratuara për IMF dhe IFJB

Sa i përket rregullativës së IMF-ve dhe IFJB-ve, gjatë vitit 2020 janë hartuar/rishikuar dhe miratuar Rregulloret si në vijim:

- Rregullore për regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare;
- Rregullore për regjistrimin e institucioneve financiare jobankare.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 në kuadër të grupit punues është rishikuar edhe manuali për regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare me qëllim të adoptimit me rregulloren e re për regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare, si dhe ndryshimet e bëra në rregullore për regjistrimin e institucioneve financiare jobankare, i cili ende nuk është proceduar për miratim tek organet vendimmarrëse të BQK-së.

4.4. Korniza rregullative për siguresit

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës ligjore dhe rregullative të siguresve dhe ndërmjetësuesve në sigurime gjatë vitit 2020 janë hartuar aktet ligjore dhe nënligjore si në vijim:

4.4.1 Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia

Gjatë vitit 2020 është finalizuar hartimi i plotësimeve dhe ndryshimeve të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Ligji i ri planifikohet që gjatë vitit 2021 të procedohet për miratim tek institucionet përgjegjëse.

4.4.2 Rregullore për dënimet me gjobë për siguresit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime

BQK gjatë vitit 2019 ka përfunduar draftimin e Rregullores për dënimet me gjobë për siguresit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime, e cila do ta zbatohet nën 125 të Ligjit për Sigurimet me qëllim të përcaktimit të dënimeve me gjobë, që mund të shqiptohen nga BQK-ja, në rastet kur institucionet dhe/ose individët që i përfaqësojnë, nuk kanë respektuar kërkesat e Ligjit për Sigurimet dhe/ose aktet nënligjore në zbatim të tij. E njëjta rregullore, gjatë vitit 2020, është miratuar nga organet përgjegjëse të BQK-së.

4.4.3 Udhëzimi për klasat e sigurimit

Gjatë vitit 2019, BQK ka finalizuar hartimin e Udhëzimit i cili rregullon klasifikimin e llojeve të rrezikut në klasat e veprimtarive të sigurimit, si dhe llojet e rreziqeve brenda klasave të sigurimit. Nevoja për ta nxjerrë këtë udhëzim ka rrjedhur për shkak të kërkesave të shumta nga siguruesit për sqarime rreth produkteve të ndryshme dhe cilave klasa i përkasin. I njëjti gjatë vitit 2020, është miratuar nga organet përgjegjëse të BQK-së.

4.4.4 Rregullore për qeverisjen korporative të siguruesve

BQK-ja, gjatë vitit 2019 ka finalizuar hartimin e Rregullores për qeverisje korporative të siguruesve bazuar në parimet e përcaktuara në Principet Bazë të Sigurimeve, të cilat lëshohen nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve me qëllim të përafrimit të kornizës rregulluese të BQK-së me kornizën ligjore evropiane dhe praktikatat e standardet më të mira ndërkombëtare. Kjo rregullore është miratuar në janar të vitit 2020, nga organet përgjegjëse të BQK-së.

4.4.5 Aktet tjera të hartuara dhe/ose të miratuara për rregullimin e siguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime

Në zbatim të Ligjit për Sigurimet dhe për të adresuar çështjet që janë vlerësuar si të nevojshme gjatë vitit 2020, janë hartuar plotësimet dhe ndryshimet dhe më pas janë miratuar rregulloret si në vijim:

- Rregullore për menaxhimin e komisioneve dhe shpenzimeve operative të siguruesve;
- Rregullore për zbatimin e sistemit bonus-malus;
- Rregullore për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm;
- Rregullore për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime.

Gjatë vitit 2020, në kuadër të grupit punues është rishikuar edhe manuali për licencimin e siguruesve, si dhe manuali për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime me qëllim të adaptimit të tij me ndryshimet në rregullore për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të huaja, si dhe rregulloren për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime. I njëjti ende nuk është proceduar për miratim tek organet vendimmarrëse të BQK-së.

4.5. Korniza Rregullative për Fondet Pensionale

Gjatë vitit 2020 janë hartuar dhe më pas proceduar për miratim në Bordin e BQK-së rregulloret e fushës së Fondeve pensionale si në vijim:

- Rregullore për mbajtjen e shënimeve në fondet pensionale dhe ofruesit e pensioneve (është miratuar);
- Rregullore për përcaktimin e përfituesve të pensioneve;
- Rregullore për auditimin e jashtëm të fondeve pensionale dhe ofruesve të pensionit.

5. Mbikëqyrja e sistemit financiar

Në funksion të pasqyrimin të aktivitetit të saj në fushën e mbikëqyrjes financiare, konform kërkesave që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar përkatës, në vazhdim është paraqitur aktiviteti i mbikëqyrjes financiare sipas natyrës së institucioneve financiare.

Sektori bankar

Gjatë vitit 2020, përkundër sfidave me pandeminë Covid-19 është vazhduar me zbatimin e pjesshëm të planit të ekzaminimeve të bankave, me anë të aplikimit të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Si rezultat i pandemisë, aktivitet e mbikëqyrjes në vend të bankave kanë qenë të kufizuara dhe kjo ka ndikuar edhe në mosrealizimin e planit të ekzaminimeve të bankave siç është aprovuar në fillim të vitit 2020. Gjatë vitit 2020, në banka janë kryer ekzaminime si në vijim:

Tabela 15. Numri i ekzaminimeve në banka

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka	1 ekzaminim i plotë 4 ekzaminime të fokusuar

Burimi: BQK (2021)

Raporti i ekzaminimit të plotë është përgatitur sipas llojit të rreziqeve bankare siç janë: rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit, rreziku i tregut dhe rreziku operacional. Ndërsa, nga ekzaminimet e fokusuar në banka, janë vlerësuar fusha të caktuara të rreziqeve, si dhe në një bankë është verifikuar zbatimi i SNRF 9. Nga ekzaminimet e realizuara janë dhënë rekomandime me afate kohore për zbatim. Në vazhdimësi është bërë përcjellja e përmbushjes së tyre nga banka, ku është verifikuar se ato rekomandime janë përmbushur sipas afateve të specifikuar kohore.

Masat lehtësuese të ndërmarra përgjatë periudhës Covid-19

Si rrjedhojë e situatës pandemike Covid-19, BQK-ja ka marrë veprime konkrete me qëllim që të monitorojë për së afërmi gjendjen e bankave si dhe të lehtësojë situatat që mund të paraqiten tek bankat dhe shfrytëzuesit e produkteve financiare si rezultat i pandemisë. Fillimisht, më datë 16 mars 2020, BQK-ja ka marrë vendim për pezullimin e përkohshëm të zbatueshmërisë së dispozitave të caktuara të rregulloreve bankare që lidhen me çështjen e provizioneve dhe klasifikimit kreditor. Përmes këtij vendimi, klientëve iu është dhënë mundësia e shtyrjes së kësteve kreditore dhe në të njëjtën kohë ruajtja e klasifikimit ekzistues kreditor dhe mbajtja e nivelit të njëjtë të provizioneve, për t'u shqufizuar më datë 1 dhjetor 2020.

Në ndërkohë, në qershor dhe gusht 2020, janë nxjerrë dy udhëzues me qëllim të vendosjes së kriterëve mbi të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredisë në mënyrë që kredimarrësit në vështirësi financiare të kenë mundësinë të përmbushin detyrimet e parapara me kontratë. Prosesi i ristrukturimit të kredisë së klientëve, ka pasur qëllim të rikthimit në normalitet të aktivitetit të tyre biznesor apo përmirësimit të aftësisë paguese të individëve në raport me obligimet aktuale. Sipas udhëzuesve në fjalë, ristrukturimi apo lehtësimi i pagesës së kësteve të kredisë nuk mund të jepet për një periudhë më të gjatë se 12 muaj.

Në funksion të përfshirjes së të gjitha masave të ndërmarra deri më tani, në shkurt 2021, BQK-ja ka nxjerrë edhe udhëzuesin e tretë, duke dhënë edhe një afat shtesë lidhur me ristrukturimin e kredive. Udhëzuesi specifikon kategoritë e kredive për ristrukturim që përfshinë: (i) kreditë të cilat paraprakisht nuk kanë qenë subjekt ristrukturimi për shkak të Covid-19 e ku ristrukturimi i një kredie të kësaj kategorie nuk duhet të rezultojë në zgjatje të afatit të ripagimeve mbi 9 muaj; dhe

(ii) kreditë të cilat paraprkisht kanë qenë subjekt ristrukturimi për shkak të Covid-19, me ç' rast iu janë zgjatur afatet e ripagimeve nën 9 muaj. Edhe në rastin e dytë, ristrukturimi i një kredie të kësaj kategorie mund të rezultojë në zgjatje shtesë të afatit të ripagimeve, e cila zgjatje bashkë me zgjatjen paraprake në total nuk duhet të jetë mbi 9 muaj.

Mbikëqyrja e përafërt e sektorit bankar përgjatë periudhës Covid-19

Me qëllim të informimit më për së afërmi përgjatë periudhës së pandemisë dhe konform qasjes proaktive lidhur me përcjelljen e zhvillimeve në sektorin bankar, bankave u është kërkuar raportim ditor në krahasim me raportimin mujor në periudha normale, si dhe dërgimi i raporteve të reja konform masave lehtësuese të ndërmarra. Më specifikisht, mbikëqyrja më e afërt përgjatë periudhës Covid-19 në kontekst të raportimit përfshin raportet me sa vijon:

- Raporti ditor mbi likuiditetin – përfshin raportim në frekuencë ditore përmes të cilës BQK është informuar në baza ditore mbi gjendjen e likuiditetit dhe treguesve të tjerë kryesor për ditën paraprake;
- Raporti mbi shtyrjen e kësteve kreditore – raport i ri mujor i iniciuar bazuar në vendimin e BQK-së të marsit 2020 lidhur me shtyrjen e kësteve kreditore, përmes të cilës janë përcjellë kërkesat për shtyrje, aprovimet e shtyrjeve kreditore, sipas sektorëve institucional dhe ekonomik;
- Raporti mbi ristrukturimet kreditore – përfshin raportimin në baza mujore të kredive të ristrukturuara, si derivat i udhëzuesve të aprovuar. Për më shumë, ky raport përfshin ndarjen në 21 kategori sipas klasifikimit NACE dhe specifikimit të ristrukturimit konform masave të ndërmarra dhe atë: shtyrje (vendimi i marsit), ristrukturim (bazuar në udhëzuesit) dhe ristrukturim klasik.

Përveç raportimit, nga perspektiva e mbikëqyrjes bankare, janë mbajtur takime individuale me banka lidhur me çështjen e provizioneve dhe klasifikimeve kreditore. Kjo me qëllim të matjes paraprake të peshës dhe efektit financiar në banka në rast të modifikimit apo marrjes së masave të reja lehtësuese apo eliminim të tyre.

Sektori i sigurimeve

BQK-ja ka vazhduar aktivitetin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi në funksion të mbikëqyrjes prudente për sektorin e sigurimeve, pavarësisht përballjes me Pandeminë Covid 19, Aktiviteti i mbikëqyrjes është realizuar si përmes sistemit të monitorimit dhe analizimit të raporteve financiare, si dhe të dhënave tjera të raportuara nga siguruesit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve ashtu dhe përmes mbikëqyrjes në vend – ekzaminimeve.

Për shkak të rrethanave me pandeminë Covid 19 dhe rrjedhimisht efekteve potenciale negative në afarizmin dhe performancën financiare të siguruesit, BQK ka marrë vendim për shtyrjen e planeve të rimëkëmbjes financiare për siguruesit të cilët kanë qenë subjekt i masave përkatëse administrative. Për shkak të mos përmbushjes së planit të rimëkëmbjes financiare dhe gjendjes së rëndë financiare, Bordi Ekzekutiv i BQK-së ka vendosur siguruesin Kosova e Re nën administrim të përkohshëm nga 1 nëntor 2020 deri më 30 prill 2021.

Si rezultat i mbikëqyrjes së afërt të sigurimeve dhe masave administrative të BQK-së, siguruesit edhe gjatë vitit 2020 kanë vazhduar me shtim të kapitalit. Në këtë vit janë shtuar 7.2 milionë euro, përderisa gjatë vitit 2019 ishin shtuar 6.9 milionë euro. Kjo ka ndikuar në uljen e numrit të siguruesve të cilët kanë qenë jashtë parametrave ligjor të kërkuar për kapital, solvencë dhe asetë në mbulim të provizioneve teknike. Gjithashtu, viti 2020 është përmbyllur me një rritje të provizioneve teknike prej 9.0 milionë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Si pasojë e përballjes me pandeminë COVID 19, viti 2020 ishte sfidues në organizimin dhe realizimin e ekzaminimeve në vend, mirëpo pavarësisht kësaj, BQK-ja është angazhuar duke i'u përshtatur rrethanave të reja në realizimin e ekzaminimeve të plota dhe të fokusuara. Qëllim i ekzaminimeve ka qenë vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të institucioneve përkatëse në raport me profilin e rrezikut dhe pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, në funksion të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të institucioneve. Klasifikimi i siguruesve për të qenë subjekt i ekzaminimeve është bazuar në disa faktorë duke filluar nga analizat e treguesve financiarë nga raportimet e rregullta në BQK, opinionit të pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, ekzaminimeve paraprake të realizuara, ankesave të policëmbajtësve në BQK, si dhe faktorë tjerë. Kjo ka ndikuar në prioritizimin e institucioneve më me rrezik për të qenë subjekt i ekzaminimeve të radhës nga BQK-ja dhe si rrjedhojë në ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes efektive.

Tabela 16. Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Siguruesit	3 ekzaminime të plota
	2 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2021)

BQK-ja gjatë vitit 2020 në funksion të harmonizimit me parimet bashkëkohore të mbikëqyrjes së sigurimeve, të zgjerimit dhe nxitjes së identifikimit të hershëm të rreziqeve të pranishme tek siguruesit, si dhe hartimin e rekomandimeve mbikëqyrëse prudente në funksion të ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar të siguruesve, ka filluar me implementimin e Manualit të Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Siguruesit, i cili përbën një kornizë konceptuale të avancuar lidhur me mbikëqyrjen.

Fondet pensionale

Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë të sektorit financiar, në vitin 2020 janë zhvilluar ekzaminimet në fonde pensionale sipas planit vjetor. Mbikëqyrja e BQK-së, ka pasur në fokus të punës së saj përmbushjen e objektivave dhe planet e saj të zhvillimit. Gjatë kësaj periudhe, vëmendje të posaçme ka marrë lëvizja e tregjeve financiare si pasojë e COVID-19, ndjekja e ecurisë dhe e ndikimeve mbi veprimtarinë dhe shëndetin e fondeve pensionale.

Gjatë vitit 2020, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike që lejoi tërheqjen e 10% të kursimeve pensionale. BQK-ja në bashkëpunim me akteret tjerë relevant, ka ndërmarrë të gjitha masat në krijimin e kushteve juridike dhe teknike për ekzekutimin e pagesave të 10 përqindëshit.

Sa i përket mbikëqyrjes së fondeve pensionale, gjatë vitit 2020 është realizuar një ekzaminim i plotë dhe dy ekzaminime të fokusuara (përcjellje e implementimit të rekomandimeve) në fondet pensionale, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së përgjithshme të fondeve pensionale për vitin financiar 2019, duke vlerësuar pajtueshmërinë me ligjet relevante dhe rregulloret e BQK-së, efektshmërinë e funksionimit të kontrolleve të brendshme, zbatimin e rekomandimeve të ngritura në raportet e ekzaminimit të BQK-së.

Tabela 17. Numri i ekzaminimeve

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Fondet pensionale	1 ekzaminim i plotë
Fondet pensionale	2 ekzaminime të fokusuara – përcjellja e implementimit të rekomandimeve

Burimi: BQK (2021)

Sektori i Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare

Sektori i institucioneve mikrofinanciare (IMF) dhe institucioneve financiare jobankare (IFJB) si rrjedhojë e situatës së krijuar me Covid-19 gjatë vitit 2020 ka ndikuar përveç tjerash edhe në kufizimet e ekzaminimeve në vend. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2020 është realizuar një ekzaminim në një institucion financiar jobankar. Përkundër kufizimeve të lartcekura, institucionet mikrofinanciare dhe jobankare janë monitoruar në vazhdimësi qoftë përmes takimeve të numërta dhe komunikimeve tjera të vazhdueshme, e po ashtu edhe nga perspektiva e mbikëqyrjes nga jashtë. Sa i përket masave të ndërmarra nga BQK, pasi që ato janë aplikuar për të gjitha institucionet kredithënëse, e rrjedhimisht, kanë qenë të aplikueshme edhe për IMF dhe IFJB. Duhet cekur se te ky sektor, rregulloret që janë shfuqizuar janë vetëm ato të rrezikut kreditor dhe të regjistrimit të kredive, por jo edhe ato që lidhen me likuiditetin.

Në funksion të të qenit proaktiv në procesin mbikëqyrës, institucioneve mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare me aktivitet të kredithënies janë kërkuar planet strategjike dhe projeksionet financiare për periudhën 2021 – 2023, me qëllim të vlerësimit të këtyre planeve të biznesit, si dhe pritjet mbi zhvillimet në këtë sektor gjatë kësaj periudhe. Strategjitë do të monitorohen dhe analizohen vazhdimisht me qëllim të identifikimit të devijimeve të mundshme dhe matjes së profilit të rrezikut.

Përveç, aktiviteteve direkte me IMF dhe IFJB, gjatë vitit 2020 është mbajtur edhe takim i detajuar online me kompaninë e angazhuar nga BERZH-i rreth projektit të qeverisjes korporative lidhur me zhvillimet në sektorin jobankar, përfshirë edhe aspektin rregullues të tyre.

Parandalimi i pastrimit të parasë

Sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, për zbatimin sa më efektiv në praktikë të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, është konsideruar e nevojshme analizimi i nevojës për nxjerrjen e akteve udhëzuese nga ana e BQK-së. Pas rishikimit të rregullores së BQK-së për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, gjatë vitit 2020 është finalizuar edhe udhëzimi në lidhje me plotësimin e deklaratimit të prejardhjes së fondeve dhe përcaktimit të së drejtës së pronësisë.

Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit dhe rritjes së kujdesit për sektorin financiar janë zhvilluar takime dhe prezantime të nevojshme me komitetin për pajtueshmëri brenda Shoqatës së Bankave dhe bankat komerciale, në të cilat takime dhe prezantime janë shqyrtuar kërkesat lidhur me kornizën ligjore dhe operacionale të fushës. Për më tepër është intensifikuar komunikimi me sektorë brenda institucionit dhe rritja e monitorimeve në aktivitetet gjatë ekzaminimeve të bankave dhe institucioneve financiare dhe komunikimin me institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

Tabela 18. Numri i ekzaminimeve

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka, Sigurues, IMF dhe IFJB	1 ekzaminim i plotë 5 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2021)

Divizioni ka intensifikuar bashkëpunimin me njësi tjera organizative brenda BQK-së, ku vlen të theksohet bashkëpunimi me departamentin e licencimit, në procesin e trajtimit të kërkesave të aprovimit dhe të vlerësimit të përshtatshmërisë për persona fizik dhe juridik, në lidhje me përshtatshmërinë sa i përket fushës së pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

Ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare

Gjatë vitit 2020 janë pranuar, sistemuar dhe shqyrtuar ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në pajtueshmëri me rregulloren përkatëse, si dhe janë bërë raportimet e rregullta lidhur me aktivitetet për trajtimin e ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në baza tremujore në Komisionin Evropian.

Nga 1 janar 2020 është funksionalizuar sistemi online i ankesave, **i cili është përshtatur me rrethanat e krijuara nga pandemia**, kur fluksi i ankesave dhe nevojat e qytetarëve janë rritur, ndërkohë që adresimi i kërkesave në formë fizike nuk ka qenë i mundur.

Gjatë vitit 2020 janë shqyrtuar 1,846 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë):

- Gjithsej ankesat për banka komerciale të adresuara në BQK për vitin 2020 kanë qenë 1,048, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me interesin e rregullt të aplikuar në periudhën e shtyrjes së afatit të pagesës së kredisë/periudhën e moratoriumit.
- Gjithsej ankesat për institucione mikrofinanciare (IMF) dhe institucione financiare jobankare (IFJB) të adresuara në BQK për vitin 2020 kanë qenë 376. Edhe tek këto institucione numri më i lartë i ankesave ka pasur të bëjë me periudhën e moratoriumit dhe pagesën e interesit të rregullt të kontaktuar.
- Gjithsej ankesat ndaj kompanive të sigurimeve të adresuara në BQK për vitin 2020 kanë qenë 409. Ankesat më të shpeshta kanë të bëjnë me moskompensim të dëmit material dhe jomaterial nga sigurimi i autopërgjegjësish TPL, mosrespektimi i afateve kohore për pagesë të marrëveshjet jashtëgjyqësore, si dhe moskompensimin e shpenzimeve mjekësore nga sigurimi shëndetësor.

Tabela 19. Numri i ankesave gjatë tri viteve të fundit

Industria financiare	Numri i ankesave sipas viteve		
	2018	2019	2020
Bankat komerciale	471	550	1,048
IMF / IFJB	56	156	376
Kompanitë e sigurimeve	395	495	409
Fondet pensionale	0	0	5
Kërkesa të tjera	4	10	8
Totali i ankesave	926	1,211	1,846

Burimi: BQK (2021)

Në tabelën e mësipërme është i paraqitur numri i ankesave të shqyrtuara gjatë tri viteve të fundit. Numri i ankesave të trajtuara nga viti në vit ka shënuar rritje. Në vitin 2020 janë trajtuar 635 ankesa më shumë krahasuar me vitin 2019, e shperhur në përqindje kjo rritje është 52 përqind. Rritje më të lartë të numrit të ankesave kanë shënuar bankat dhe IMF e IFJB. Arsyeja e kësaj rritje është ndikimi i pandemisë në industrinë financiare, përkatësisht ofrimi i mundësisë së moratoriumit. Nga gjithsej 1,048 ankesa, 745 apo 71.1 përqind e gjithsej ankesave ndaj bankave komerciale kanë rezultuar të refuzuara, ndërsa sa i përket kompanive të sigurimeve 262 apo 64.4 përqind e gjithsej ankesave kanë rezultuar të zgjidhura në favor të palëve (shih tabelën 20).

Tabela 20. Numri i ankesave sipas statusit të ankesës

Industria financiare	Gjithsej ankesave	Të mbështutura	Të refuzuara
Bankat komerciale	1,048	303	745
IMF / IFJB	376	134	242
Kompanitë e sigurimeve	409	261	147
Fondet pensionale	5	1	4
Kërkesa të tjera	8	1	7
Totali i ankesave	1,846	701	1145

Burimi: BQK (2021)


6. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

6.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

BQK-ja në kuadër të operacioneve të menaxhimit me para të gatshme siguron furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro. Për realizimin e këtij funksioni mban dhe administron rezervat valutore, rregullon dhe përcakton standardet për Institucionet Financiare në lëmin e operacioneve me para të gatshme që kanë të bëjnë me kontrollin dhe ri qarkullimin e kartëmonedhave dhe monedhave, obligimin për tërheqjen nga qarkullimi të parave të dyshuara si të falsifikuara dhe atyre të papërshtatshme për ri qarkullim, si dhe kriteret për këmbimin e parave të dëmtuara.


Gjatë vitit 2020, përkundër situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, të gjitha operacionet me para të gatshme u monitoruan dhe u menaxhuan në baza ditore me qëllim të përshtatjes së kërkesave të shtuara për furnizim si rezultat i situatës pandemike. Si rrjedhojë BQK-ja përmbushi në mënyrë të suksesshme furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro. Situata e shkaktuar nga pandemia Covid-19 kishte ndikim të madh në nivelin e depozitave dhe tërheqjeve të parave të gatshme. Përderisa pati rënie të depozitave të parave të gatshme, tërheqjet e parave të gatshme gjatë këtij viti shënuan rritje të konsiderueshme. Rezerva valutore e mbajtur në BQK gjatë vitit 2020 ishte e mjaftueshme për përballimin e situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 edhe pse ajo shënoi një rënie të konsiderueshme gjatë muajit mars 2020, si rrjedhojë e kërkesave të shtuara të qytetarëve ndaj sektorit bankar dhe këtij të fundit ndaj BQK-së. Periudha prill dhe maj 2020 u pasua me një gjendje më stabile të rezervës valutore, kurse me lehtësimin e masave kufizuese operacionet me para të gatshme filluan t'i kthehen normalitetit dhe si rrjedhojë edhe rezerva valutore arriti në lartësinë optimale të saj.

Grafik 52. Furnizimi me para të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2021)

Grafik 53. Pranimi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro




Burimi: BQK (2021)

Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2020, shënoi një rritje prej 49.7 përqind krahasuar me vitin 2019. Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk patën ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti 2019 në vitin 2020. Te kartëmonedhat euro vëllimet e kërkesave për furnizim gjatë vitit 2020 shënuan një rritje të konsiderueshme prej rreth 50.5 përqind krahasuar me vitin 2019 dhe vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet me prerje prej 20, 50 dhe 100 euro. Po ashtu, kërkesat për vëllimet e denominimeve prej 200 euro shënuan një rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2020. Kërkesat për vëllimet e denominimeve në vlerë prej 200, 100 dhe 50 euro patën një rritje grupore prej rreth 61.7 përqind krahasuar me vitin e kaluar kurse kërkesat për vëllimet e denominimeve në vlerë prej 20, 10 dhe 5 euro shënuan një rritje grupore prej 38.5 përqind.

Siç është paraqitur në grafikët e mëposhtëm, gjatë vitit 2020, BQK-ja e furnizoi sektorin bankar me afër 25.26 milionë copë kartëmonedha euro (në vlerë prej afër 1.1 miliardë euro) dhe me afër 5.38 milionë copë monedha euro (në vlerë prej mbi 1.05 milion euro).


Sa i përket kërkesave për furnizim me para të gatshme në BQK, gjatë periudhës së masave kufizuese të shkaktuara nga Covid-19 (mars – maj 2020) ato shënuan një rritje prej 151.7 milionë eurove krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Përderisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kërkesa për furnizim me para të gatshme ishte gjithsej 181.5 milionë euro, në periudhën e njëjtë të vitit 2020 kërkesa për furnizim me para të gatshme arriti në 333.2 milionë euro apo një rritje prej 83.6 përqind. Gjatë periudhës së masave lehtësuese (qershor - dhjetor 2020) kërkesa për furnizim me para të gatshme shënoi një rritje prej 182.5 milionë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Përderisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kërkesa për furnizim me para të gatshme ishte gjithsej 474.2 milionë euro, në periudhën e njëjtë të vitit 2020 kërkesa për furnizim me para të gatshme arriti në 656.7 milionë euro apo rritje prej 38.5 përqind përkatësisht.

Grafik 54. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2021)

Grafik 55. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2021)

Vëllimet e kërkesave për furnizim me monedha gjatë vitit 2020 shënuan një rënie prej rreth 25.6 përqind krahasuar me vitin 2019. Kërkesa për furnizim me monedha euro në vitin 2020 u dominua nga monedhat me vlerë të vogël nga 1, 2 dhe 5 euro cent. Krahasuar me vitin paraprak kërkesat për denominimet prej 10, 5, 2 dhe 1 euro cent kanë shënuar një rënie grupore prej 26.4 përqind, përderisa kërkesat për furnizim me denominimet prej 2, 1 euro, 50 dhe 20 euro cent kanë shënuar një rënie grupore prej 22.8 përqind në raport me vitin paraprak.


Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rënie prej 14.6 përqind në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi nga sektori bankar afër 29.27 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 117,000 copë kartëmonedha në ditë), ndërsa nuk ka pasur depozita në monedha. Të shprehura në vlerë, depozitat e parave të gatshme arritën përafërsisht shumat prej 1.45 miliardë kartëmonedha euro dhe 0 milion monedha euro përkatësisht. Vëllimet e kartëmonedhave të pranuar gjatë vitit 2020 ishin pothuajse të njëjta krahasuar me vitin 2019.

Gjatë periudhës së masave kufizuese të shkaktuara nga Covid-19 (mars – maj 2020) vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita ishte gjithsej 236.5 milionë euro, rënie prej 135.4 milionë eurove krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Arsyeja kryesore e rënies së depozitave të parave të gatshme nga bankat komerciale në BQK gjatë kësaj periudhe ishte rritja e stokeve të tyre, si dhe furnizimi i kërkesës së shtuar për tërheqje të parave të gatshme nga ana e qytetarëve në kohën e pandemisë. Gjatë periudhës së masave lehtësuese (qershor – dhjetor 2020) vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita nga bankat komerciale ishte gjithsej 907.6 milionë euro, rënie prej 158.5 milionë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Arsyeja kryesore e rënies së depozitave të parave të gatshme të bankave komerciale në BQK gjatë kësaj periudhe ishte ardhja më e vogël e diasporës gjatë periudhës së

verës (sidomos gjatë muajit gusht) periudhë kjo kur depozitat e parave të gatshme në sektorin bankar arrijnë nivelin më të lartë të tyre.


Struktura e kartëmonedhave euro të pranura gjatë vitit 2020 nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak kurse siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm depozitat e monedhave ishin në nivelin zero.

Grafik 56. Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2021)

Grafik 57. Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)




Burimi: BQK (2021)

Ngjashëm me vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2020 paratë e gatshme të pranura ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, gjatë vitit 2020 paratë e gatshme neto²⁰ ishin rreth 354.56 milionë euro e që ishte dukshëm më i ulët se sa në vitin e kaluar kur paratë e gatshme neto ishin rreth 966.24 milionë euro. Kjo rënie ishte kryesisht si rezultat i rënies së depozitave të parave të gatshme nga sektori bankar në njërën anë dhe rritjes së furnizimit me para të gatshme në anën tjetër.


Meqenëse BQK-ja mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, tepricat dërgohen në Eurozonë, ku pastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare, si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat²¹ jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2020 arritën shumë prej 350 milionë euro duke qenë më i ulët për 63.2 përqind se sa një vit më parë kur ishin 950 milionë euro. Kjo rënie neto e dërgesave në vitin 2020 erdhi si rezultat i rënies së depozitimeve të parave të gatshme nga sektori bankar në njërën anë dhe rritjes së furnizimit me para të gatshme në anën tjetër. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy grafikët në vijim.

Grafik 58. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2021)

Grafik 59. Importi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2021)


²⁰ Depozitat minus tërheqjet e parave të gatshme.

²¹ Importet minus eksportet e parave të gatshme.

Gjatë vitit 2020 të gjitha paratë e gatshme të pranuar nga sektori bankar u procesuan duke u kontrolluar për autenticitet dhe u klasifikuan sipas shkallës së përshtatshmërisë (afër 29.27 milionë copë kartëmonedha euro).


Rreth 9.0 milionë copë kartëmonedha euro (30.8 përqind e numrit të përgjithshëm të kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2020 u klasifikuan si të papërshtatshme për ri qarkullim (tejet të vjetërsuara/dëmtuara) dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Ngjashëm me vitet e kaluara, kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si të papërshtatshme për ri qarkullim, ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro. Ato përbënin rreth 92.4 përqind të kartëmonedhave të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi për shkak të përdorimit më të shpeshtë nga qytetarët.

Grafik 60. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2021)


Grafik 61. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar (në përqindje)



Burimi: BQK (2021)


Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga Eurozona. Gjatë vitit 2020, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 5.21 milionë copë kartëmonedha të reja euro (20.6 përqind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara). Rreth 86.4 përqind e sasisë së kartëmonedhave të reja të furnizuara gjatë vitit 2020 ishin kartëmonedha të denominimeve me vlerë të ulët (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat u furnizuan bankat komerciale me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme. Për më tepër, të gjitha kartëmonedhat e përshtatshme për ri qarkullim euro me të cilat u furnizuan ishin të një cilësie të lartë (të përshtatshme për ri qarkullim).

Grafik 62. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: BQK (2021)

Grafik 63. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara (në përqindje)




Burimi: BQK (2021)

Sikurse edhe në vitet paraqake edhe gjatë vitit 2020 BQK-ja vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për raportimin e rasteve të parave të gatshme të dyshuara si të falsifikuara. BQK-ja së bashku me Laboratorin e Forenzikës publikuan në faqen zyrtare e BQK-së statistikat mbi paratë

e falsifikuara në nivel të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2020 janë identifikuar një numër prej 943 kartëmonedhash dhe 2,671 monedhash të falsifikuara. Pjesa më e madhe e këtyre kartëmonedhave dhe monedhave janë konfiskuar nga institucionet financiare gjatë aktivitetit të tyre të rregullt.


Për dallim nga vitet paraprake kur kartëmonedhat më të falsifikuara kanë qenë ato të prerjes prej 50 dhe 100 euro, në vitin 2020 kartëmonedhat më të falsifikuara kanë qenë ato të prerjes prej 5 euro të cilat përbënin rreth 39 përqind e të gjitha kartëmonedhave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi. Ndërsa, sa i përket monedhave në vitin 2020 ashtu sikurse edhe në vitin e kaluar monedha më e falsifikuar ishte ajo në prerje prej 2 euro e cila përbënte rreth 98 përqind e të gjithë numrit të monedhave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi.

Grafik 64. Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2021)

Grafik 65. Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve (nr. i cop.)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2021)

6.1.1 Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe institucione tjera siç janë bankat dhe institucionet tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-së. BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave dhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Edhe gjatë vitit 2020 sikurse në vitet paraprake, të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT kurse të gjitha pagesat vendore u realizuan përmes sistemit ATS, duke shkurtuar kohën dhe duke rritur efektivitetin e procesimit.


Tabela 21. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2016	2017	2018	2019	2020
Transaksionet me para të gatshme	+467,362	+563,570	+643,831	+965,364	+354,562
Depozita në para të gatshme	842,240	989,618	1,187,889	1,697,993	1,449,546
Tërheqje të parave të gatshme	374,878	426,048	544,057	732,629	1,094,984
Transferet vendor	+1,041,198	+1,131,645	+1,050,203	+425,715	+70,305
Transferet vendore ardhëse	1,712,605	1,861,640	1,882,670	693,428	110,763
Transferet vendore dalëse	671,407	729,995	832,467	267,714	40,458
Transferet ndërkombëtar	-580,656	-432,050	-642,864	-954,036	-424,086
Transferet ndërkombëtar ardhëse	970,941	1,081,879	1,054,765	1,971,668	1,794,963
Transferet ndërkombëtare dalëse	1,551,597	1,513,929	1,697,629	2,925,705	2,219,049

Burimi: BQK (2021)


Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së në vitin 2020 u kryen në emër të/dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të/dhe për llogari të AKP-së.²²

Grafik 66. Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse, numri



Burimi: BQK (2021)


Grafik 67. Vlera e transaksioneve vendore dalëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2021)


BQK-ja gjatë vitit 2020 ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 9 mijë urdhërpagesa dalëse vendore (një zvogëlim prej 89.5 përqindje krahasuar me vitin paraprak) dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 9.5²³ mijë urdhërpagesa hyrëse (një zvogëlim prej 74.8 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse vendore arrinin shumën prej mbi 40.45 milionë euro (një zvogëlim prej 84.89 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse vendore arrinin shumën mbi 110.76 milionë euro (një zvogëlim prej 84.0 përqind krahasuar me vitin paraprak). Numri dhe shumën më e madhe e transaksioneve vendore u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për AKP-në. Rënia e vëllimit të transaksioneve gjatë vitit 2020 shpjegohet me faktin se të gjitha llogaritë e Thesarit²⁴ janë lidhur direkt në sistemin e pagesave.

Grafik 68. Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse, numri



Burimi: BQK (2021)

Grafik 69. Vlera e transaksioneve vendore hyrëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2021)


Sa i përket pagesave vendore dalëse, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato, kurse kompanitë e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale. Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kishte të bënte me transferet e fondeve të bankave komerciale dhe Trustit Pensional të Kosovës. Të dhënat vjetore mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër grafikët në vijim.

²² AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

²³ Shumica e pagesave ardhëse me implementimin e sistemit ATS pranohen nga BQK si të grupuara.


²⁴ Thesari – Ministria e Financave.

Grafik 70. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse, numri



Burimi: BQK (2021)


Grafik 71. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse, shuma



Burimi: BQK (2021)


BQK-ja gjatë vitit 2020 ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 2,530 urdhërpagesa dalëse ndërkombëtare (një rënie e moderuar prej 23.4 përqind krahasuar me vitin paraprak) dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 2,095²⁵ urdhërpagesa hyrëse ndërkombëtare (një rritje prej 159.3 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse ndërkombëtare kapnin shumën prej mbi 2.22 miliardë euro (një rënie prej 24.8 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse ndërkombëtare kapnin shumën mbi 1.79 miliard euro (një rënie prej 9.0 përqind krahasuar me vitin paraprak).

Grafik 72. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse, numri



Burimi: BQK (2021)

Grafik 73. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse, shuma



Burimi: BQK (2021)

Më 31 dhjetor 2020, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës arritën shumën prej 316.90 milionë euro ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 191.46 milionë euro. Së bashku, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe ato të AKP-së përbënin rreth 41.9 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2020.

Tabela 22. Niveli i depozitave të klientëve kryesorë (në mijëra euro)

Gjendja e llogarive	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej gjendja	1,074,458	1,239,730	1,217,914	1,187,685	1,214,559
Institucionet Qeveritare	257,393	339,906	374,663	444,301	316,897
Agjencia Kosovare e Privatizimit	460,961	471,299	388,116	275,160	191,457
Bankat Komeriale dhe Siguruesit	301,051	336,732	347,931	419,659	571,114
Të tjera	55,053	91,793	107,205	48,566	135,091


Burimi: BQK (2021)

Bankat komerciale dhe kompanitë e sigurimeve kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në nivelin e depozitave në BQK. Këto depozita kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat dhe obligimet ligjore dhe

²⁵ Shumica e pagesave ardhese kanë të bëjnë me transferet e fondeve të bankave komerciale.

rregullatore të Bankave komerciale dhe kompanive të sigurimeve. Ato përbënin 47.0 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2020. Më 31 dhjetor 2020, depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit ishin në shumën prej 571.11 milionë euro.

Grafik 74. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së, në miliardë euro



Burimi: BQK (2021)

6.2. Sistemi i Pagesave

Edhe për kundër situatës së krijuar si rezultat i krizës globale të pandemisë dhe

kërkesës për t'u përshtatur me nevojat specifike të paraqitura, sistemi i pagesave ka rezultuar të jetë i qëndrueshëm dhe i gatshëm të përballët me sfida të kësaj natyre, në funksion të ofrimit të shërbimeve të pagesave për qeverinë, bizneset dhe ekonominë familjare, duke qenë në dispozicion për adresimin e menjëhershëm të kërkesave të pjesëmarrësve, përgjatë gjithë kohës.

Fillimisht, gjatë tremujorit të parë pas aktivizimit të planit të veprimit për raste emergjente, është vërejtur rënie e aktivitetit të pagesave dhe janë paraqitur nevoja specifike nga pjesëmarrësit, kryesisht për t'u përshtatur me oraret e kufizuara të lëvizjes dhe parapërgatitje për situata të mundshme. Megjithatë edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, sektori i pagesave në BQK, ka operuar pa ndërprerje dhe me kapacitete të plota, pavarësisht se me angazhim kryesisht nga distanca. Gjithashtu, janë krijuar grupe të përbashkëta me bankat, thesarin dhe institucione tjera për adresimin e shpejtë të çdo kërkesë apo pengese të mundshme, si dhe raportime më të shpejta të transaksioneve dhe gjendjes së likuiditetit të bankave. Kjo ka siguruar operim të sigurt të sistemit të pagesave, i cili ka mundur kliringun dhe shlyerjen me kohë dhe pa pengesa, e të gjitha transaksioneve të pagesave dhe letrave me vlerë.

Si rezultat i rrethanave të krijuara dhe funksioneve që ofron sistemi i pagesave ndërbankare dhe regjistri i llogarive bankare, BQK-ja ka ofruar mbështetje për nevojat specifike të institucioneve në funksion të mbështetjes për zbatimin e masave të ndërmarra për menaxhimin e situatës dhe rimëkëmbjen e ekonomisë. Në këtë drejtim, BQK-ja ka mundur validimin e llogarive bankare për përfituesit nga pakot emergjente, si dhe ka ofruar infrastrukturën e saj për shpërndarje sa më të shpejtë dhe të lehtë të pagesave. Mbështetje nga aspekti teknik është ofruar edhe për Fondin e Kursimeve Pensionale dhe Fondin Slloveno-Kosovar, ku gjatë tremujorit të fundit, janë zhvilluar funksione shtesë në sistemin e regjistrimit të llogarive bankare për validim të llogarive të aplikuesve për 10 përqindëshin e fondeve nga kursimet pensionale, sipas Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Kjo ka mundur aplikimin e lehtë dhe të shpejtë nga distanca, si dhe shpërndarjen e shpejtë të mjeteve në llogaritë bankare, duke respektuar masat për kufizim të përhapjes së Covid-19.

Pavarësisht detyrave të rregullta dhe kërkesave specifike të situatës, sistemi i pagesave ka vazhduar edhe me aktivitetet në proces për zbatimin e planit strategjik të Bankës Qendrore. Në kuadër të Programit për Pagesat dhe Remitencat të cilin Banka Qendrore është duke e zhvilluar me mbështetjen e Bankës Botërore, kanë vazhduar takimet në formë virtuale me ekspertët e Bankës Botërore lidhur me hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Pagesave me Vlerë të Vogël, rishikimin e Politikës për Mbikëqyrjen e Sistemeve të Pagesave dhe aktivitete tjera, të cilat janë duke u zhvilluar në kuadër të këtij programi.

Gjatë vitit 2020 janë autorizuar për herë të parë IFJB-të për emetimin e parave elektronike, si një mundësi e re për zgjerimin e instrumenteve të pagesave elektronike dhe rritjen e konkurrencës. Gjithashtu, në funksion të përgatitjeve për situata të mundshme të vështirësive në menaxhimin e

likuiditetit, në përgjigje edhe ndaj situatës së krijuar, është nxjerrë rregullorja për hua brenda ditore dhe një ditore që BQK mund të ofroj për bankat, në rast të vështirësive të mundshme afatshkurtra për likuiditet. Njëkohësisht, janë bërë zhvillimet e nevojshme operacionale për ekzekutimin e këtyre instrumenteve në rast nevoje.

Gjatë vitit 2020 janë vazhduar edhe aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve në fushën e sistemeve të pagesave, me çrast personeli i BQK-së ka ndjekur disa prej trajnimeve online të ofruara nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare dhe bankat qendrore të vendeve të BE-së.


6.3.1 Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare

Sistemi i pagesave ndërbankare (SPN) mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë. Grafikët në vijim, paraqesin numrin dhe vlerën e transaksioneve të kryera përmes SPN-së për periudhat përkatëse.

Treguesit statistikor të aktivitetit të SPN-së kanë reflektuar me një rritje në vëllim dhe një rënie të lehtë në vlerë të transaksioneve në krahasim me vitin paraprak, të paraqitur si në vijim.


Nga grafikët 75 dhe 76 vërehet se gjatë vitit 2020 janë procesuar afër 13 milionë transaksione me vlerë totale afër 14 miliardë euro. Krahasuar me transaksionet e SPN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve është rritur për 4.7 përqind, kurse vlera e transaksioneve ka pësuar një rënie të lehtë prej 1.0 përqind.

Grafik 75. Numri i transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2021)

Grafik 76. Vlera e transaksioneve në SPN (në mijëra)



Burimi: BQK (2021)

Në kuadër të SPN-së realizohen pagesat përmes dy komponentëve: RTGS (Real-Time Gross Settlement) dhe ACH (Automated Clearing House). Në komponentën RTGS realizohen në kohë reale të gjitha pagesat me vlerë mbi 10 mijë euro, si dhe të gjitha pagesat të urdhëruara me prioritet nga ana e klientëve, ndërsa në komponentin ACH realizohen të gjitha pagesat me vlerë nën 10 mijë euro dhe përfshijnë këto lloje të pagesave: pagesat e rregullta (individuale dhe masive), pagat dhe pensionet, pagesat Kos-Giro dhe Debitimi Direkt. Krahasimi i vëllimit dhe vlerës së këtyre kategorive të pagesave për vitet e caktuara, është paraqitur në grafikët në vijim.


Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbëjnë rreth 45.0 përqind të vëllimit dhe 16.2 përqind të vlerës së transaksioneve të SPN-së.

Transaksionet RTGS, procedohen dhe shlyhen gjatë orarit të punës në kohë reale dhe në baza bruto. Gjatë vitit 2020 numri i tyre përbënte rreth 3.4 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve në SPN, ndërsa vlera e tyre rreth 38.5 përqind të vlerës së transaksioneve përmes SPN-së.

Në kategorinë e pagesave për paga/pensione vërehet një rritje domethënëse, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve, nëse marrim për krahasim vitin paraprak. Kemi një rritje prej 25.0 përqind në numër dhe 38.0 përqind në vlerë të transaksioneve dhe kjo rritje ndërlihet me


disa pagesa shtesë (asistenca sociale, paga shtesë për kategori të ndryshme, mbështetje financiare) që janë realizuar përgjatë vitit për biznese dhe të punësuar më të prekur nga pandemia.

Grafik 77. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2021)


Grafik 78. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2021)


Pasqyrimi i pagesave të procesuara përmes sistemit ACH gjatë vitit 2020, sipas sesioneve, tregon një përqendrim më të theksuar në sesionin e parë dhe të dytë të kliringut, krahasuar me sesionin e fundit. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë sesionit të fundit të kliringut minimizon rreziqet shtesë në kuadër të funksionimit të sistemit të pagesave, prandaj aplikohen tarifa më të ulta për transaksionet e procesuara në dy sesionet e para.

Grafik 79. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2021)

Grafik 80. Vlera vjetore e transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre (në mijëra)



Burimi: BQK (2021)


Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në SPN gjatë vitit 2020 ka qenë afër 14 miliardë euro, ku tri institucionet e para me vlerë më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 60.3 përqind të vlerës së përgjithshme, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 39.7 përqind. Sa i përket numrit të transfereve të iniciuara, nga numri i përgjithshëm i tyre prej 12.9 milionë euro, tri institucionet e para me numër më të madh të transfereve të iniciuara zënë 70.8 përqind të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 29.2 përqind.

Matur me indeksin HHI, përqendrimi i pjesëmarrësve në SPN gjatë vitit 2020, tregon një përqendrim të lartë, pra ishte 2,030 pikë sa i përket numrit të transaksioneve ndërsa një përqendrim të moderuar sa i përket vlerës së tyre, 1,680 pikë. Krahasuar me vitin 2019, vërehet një trend i lehtë zvogëlimi i përqendrimit të pjesëmarrësve në sistem.²⁶

Niveli më i lartë i përqendrimit, sa i përket numrit të transaksioneve të dërguara në SPN, ka të bëjë me dërgimin e transaksioneve të institucioneve financiare jobankare përmes bankave komerciale, të pagesave me vlerë të vogël, prandaj ekziston dallimi në nivelin e përqendrimit të vlerës së transaksioneve me atë të vëllimit të transaksioneve.


²⁶ HHI deri në 1.000 tregon se nuk ka përqendrim të tregut; 1.000-1.800 tregon përqendrim të moderuar; mbi 1.800 përqendrim të lartë.

Grafik 81. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SPN



Burimi: BQK (2021)

Grafik 82. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SPN



Burimi: BQK (2021)

Në kuadër të funksioneve operacionale, rol të rëndësishëm zë edhe regjistri i llogarive bankare. Ky regjistrer përfaqëson një infrastrukturë të bazës së të dhënave, e cila mundëson raportimin e të dhënave për llogaritë bankare nga ofruesit e të dhënave të llogarive (bankat komerciale), si dhe shfrytëzimin e këtyre të dhënave në funksion të zbatimit të vendimeve përmbarimore nga organet e përmbarimit dhe institucionet e tjera kompetente sipas dispozitave të Ligjit për procedurën përmbarimore. Gjatë vitit 2020 janë bërë disa zhvillime të këtij regjistri për t'iu përshtatur ndryshimeve të kryera nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve lidhur me numrat unik të regjistrimit të bizneseve dhe nevojave tjera të paraqitura nga pjesëmarrësit.

Tabela 23. Përqendrimi i pjesëmarrësve në SPN për transaksionet e iniciuara/dërguara

Sistemi SPN	Vëllimi i transaksioneve	Vlera e transaksioneve
HII - 2020	2030	1680
HII - 2019	2240	1620

Burimi: BQK (2021)

Në regjistrin e llogarive bankare gjatë vitit raportues kanë pasur qasje 43 përmbarues privatë, 110 zyrtarë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe 22 zyrtarë nga Administrata Tatimore e Kosovës, përmes të cilit kanë shkëmbyer me bankat komerciale 14,793 raste të procedurës përmbarimore, prej të cilave 11,406 janë mbyllur. Nga tabela e më poshtme vërehet një rënie e konsiderueshme e rasteve në krahasim me vitin paraprak, e cila mund të jetë ndikuar nga rënia e përgjithshme e aktivitetit ekonomik dhe pezullimi i masave ndëshkuese me vendimet e Qeverisë për shkak të pandemisë, për kategoritë të ndryshme ekonomike.

Tabela 24. Rastet e procesuara në RLLB

Statusi i rasteve	2019	2020	Në ngritje/Në rënje (%)
Të hapura	24,540	14,793	-39.72
Të mbyllura	13,903	11,406	-17.96

Burimi: BQK (2021)

6.2.2 Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave

Në fushën e mbikëqyrjes dhe analizave të sistemeve të pagesave janë zhvilluar procese që kanë ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe të kuadrit rregullativ. Gjatë vitit 2020, sistemi i pagesave Real Time Gross Settlement (RTGS) është përcaktuar si sistem i rëndësishëm sistemike dhe njëkohësisht është themeluar grupi punues për vlerësimin e këtij sistemi në pajtim me metodologjinë për vlerësimin e sistemeve të pagesave me rëndësi sistemike, të bazuar në parimet e nxjerra nga IOSCO/BIS për infrastrukturën e tregjeve financiare.

Gjatë vitit 2020, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve rregullative të cilat adresojnë shërbimet e pagesave dhe emetimit të parave elektronike, janë pranuar kërkesat e para nga IFJB-të ekzistuese të autorizuarra për ofrimin e shërbimeve të pagesave, për t'u autorizuar edhe për aktivitetin e emetimit të parasë elektronike. Gjithashtu, është regjistruar një IFJB e re për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe emetimin e parave elektronike.

Ofrimi i emetimit të parave elektronike nga këto institucione vlerësohet se do të ndikojë drejtpërdrejt në nxitjen e konkurrencës dhe inovacionit në fushën e pagesave me vlerë të vogël, duke promovuar kështu pagesat elektronike dhe rritjen e efikasitetit të tyre. Në këtë drejtim, BQK ka përgatitur edhe “Udhëzimin për raportimin e instrumenteve të pagesave me para elektronike”, si dhe format e raportimit përmes të cilave kërkohet raportimi i aktivitetit të parave elektronike në baza të rregullta për përcjelljen e vazhdueshme të zhvillimit të instrumenteve të parave elektronike dhe përdorimit të tyre për kryerjen e pagesave.

Në kuadër të RPP-së (RPP-Remittances and Payments Program), në funksion të fuqizimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, ekipi i Bankës Botërore ka mbështetur BQK-në në draftimin e amendamentimit të Politikës së Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave, punë kjo e cila është ende në proces.

Gjatë vitit 2020 është rishikuar analiza vjetore mbi përdorimin e kartelave në Kosovë, e cila përveç informacioneve që kanë të bëjnë me shpërndarjen socio-demografike të kartelave të cilat përdoren nga qytetarët e Kosovës dhe faktorëve relevantë të cilët kanë ndikuar në shpërndarjen e tillë të kartelave, përfshin edhe informacionet lidhur me llojet e kartelave, përdorimin e kartelave “contact” dhe “contactless”, përdorimin e kartelave online, etj. Analiza vjetore mbi përdorimin e kartelave në Kosovë publikohet në baza të rregullta vjetore në faqen zyrtare të BQK-së.

Gjithashtu, në kuadër të përgatitjes së analizave dhe raporteve për statistikat e pagesave, janë përgatitur raportet e rregullta vjetore dhe mujore lidhur me numrin dhe vlerën e pagesave të sistemit të pagesave ndërbankare, mbi depozitat e bankave komerciale dhe rezervat, mbi instrumentet me para të gatshme dhe jo me para të gatshme, si dhe raporti krahasues mbi instrumentet elektronike, të cilat publikohen në formë elektronike në faqen zyrtare të BQK-së.

6.2.3 Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave

Raportimet e bankave për instrumente të pagesave tregojnë se deri në fund të dhjetorit të vitit 2020 numri i kartelave të debitit arriti në 1.2 milionë ndërsa numri i kartelave të kreditit arriti në 175 mijë. Krahasuar me një vit më parë, konstatohet se numri i kartelave të debitit është rritur për 8.4 përqind, ndërsa numri i kartelave të kreditit është ulur për 5.2 përqind.

Sa i përket infrastrukturës së terminaleve ATM, shihet se ka pasur rritje në tri vitet e fundit, ndërsa një rënie të lehtë të numrit të terminaleve POS gjatë vitit 2020.


Krahas rritjes së numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave, nga të dhënat statistikore shihet se viti 2020 është karakterizuar edhe me rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Numri i pagesave të kryera përmes shërbimit e-banking arriti në 5.6 milionë transaksione që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje për 8.7 përqind, ndërsa vlera e tyre arriti në 10.7 miliardë euro, me rritje vjetore prej 3.9 përqind.

Viti 2020 po ashtu u karakterizua me një tendencë në rritje të përdorimit të pagesave me kartelë. Numri i pagesave në POS terminale është rritur për 5.2 përqind, ndërsa vlera e tyre ka qenë më e vogël, ku kemi një rënie prej 6.0 përqind krahasuar me vitin paraprak. Tërheqjet në ATM tregojnë për një rënie sa i përket numrit të tyre duke e krahasuar me vitin paraprak dhe një rritje të vlerës


së tyre. Numri i tërheqjeve në ATM është zvogëluar për 4.9 përqind, ndërsa vlera e tërheqjeve është rritur për 4.0 përqind.

Grafik 83. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2021)


Grafik 84. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit



Burimi: BQK (2021)


Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2020, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve arriti rreth 2.3 milionë, që paraqet një rritje prej 6.5 përqind krahasuar me fundin e vitit 2019. Rreth 98.6 përqind e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.4 përqind janë të jorezidentëve.

Grafik 85. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2021)


Grafik 86. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2021)


Nga totali i llogarive në fund të vitit 2020, mbi 411 mijë llogari kishin qasje “online” nga interneti për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë. Kjo paraqet një rritje rreth 21.0 përqind të llogarive me qasje nga distanca, që mund të jetë ndikuar edhe nga nevojat e situatës së pandemisë për qasje nga distanca, si rezultat i kufizimit të lëvizjes.

Grafik 87. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2021)

Grafik 88. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2021)

Bazuar në të dhënat statistikore zhvillimi i infrastrukturës ka rezultuar me një ritëm më të shpejtë dhe inkurajues mbetet trendi i shpejtë i rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Tabela 25. Numri i llogarive

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Llogaritë e klientëve (1+2)	2,054,799	2,152,128	2,292,172	250,733	337,693	411,346
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.43%	98.49%	98.57%	97.96%	97.96%	98.22%
a-Individuale (%)	92.98%	92.77%	92.71%	82.95%	84.57%	86.63%
b-afariste (%)	7.02%	7.23%	7.29%	17.05%	15.43%	13.37%
2-Llogari të jorezidentëve (c+d) (%)	1.57%	1.51%	1.43%	2.04%	2.04%	1.78%
c-Individuale (%)	98.70%	98.68%	98.79%	91.40%	93.16%	93.66%
d-afariste (%)	1.30%	1.32%	1.21%	8.60%	6.84%	6.34%

Burimi: BQK, Raportimet e bankave sipas "Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave" (2021)

Institucionet financiare jobankare të licensuara për lëshimin e parasë elektronike, në fund të vitit 2020 kanë raportuar për 3,483 llogari të parasë elektronike. Kjo paraqet një rritje të shpejtë marr parasysh fillimin e ofrimit të këtyre shërbimeve vetëm gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020, megjithatë është ende herët për t'u vlerësuar niveli i përdorimit të këtyre llogarive. Kjo varet direkt edhe nga mundësitë dhe llojet e instrumenteve që do të ofrohen në treg dhe përshtatja e tyre për nevojat e përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

Tabela 26. Numri i llogarive të parasë elektronike

Përshkrimi i llogarisë	2020
Llogaritë e-money	3,483

Burimi: BQK (2021)

Sa i përket krahasimit të Kosovës me vendet në rajon, shihet se trendi i shpejtë i zhvillimit gjatë viteve të fundit ka ndikuar që sot Kosova të ketë përmirësuar pozitën e saj krahasuar me vendet fqinje, megjithëse mbetet ende relativisht ulët në krahasim me vendet e BE-së dhe me mundësi avancimi në kategori të caktuara për të arritur nivelin e vendeve të rajonit.

Tabela 27. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave²⁷

Përshkrimi	Banorë	ATM për milion banorë	POS për milion banorë	Kredit Kartelat për milion banorë	Debit Kartelat për milion banorë	E-Banking për milion banorë
Kosova	1.78	279	7,735	103,774	622,671	170,562
Shqipëria	3.05	232	3,670	37,303	336,249	144,784
Republika Çeke	10.68	488	-	146,483	1,066,935	-
Turqia	81.25	653	19,686	859,395	2,045,675	-
Slovenia	2.1	736	17,237	60,831	1,322,059	-
Bullgaria	7.05	802	-	176,409	881,959	-
Hungaria	9.82	519	16,071	128,453	826,373	-
Bosnja dhe Hercegovina	3.84	427	7,721	64,003	450,010	203,575
Mali i Zi	0.61	-	-	-	-	109,072
Kroacia	4.27	1,275	26,036	41,907	1,601,159	-
Maqedonia	2.11	493	15,479	176,764	698,779	216,898

Burimi: BQK (2021) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse

²⁷ Të dhënat në tabelë janë nga viti 2019 pasi që shumica e vendeve në rajon të dhënat për vitin 2020 nuk i kanë publikuar ende.

6.2.4. Aktivitetet huluntuese në fushën e pagesave

Në funksion të modernizimit të infrastrukturës së përgjithshme të pagesave me vlerë të vogël dhe rritjes së efikasitetit të instrumenteve të pagesave, në kuadër të programit për remitancat dhe pagesat, të zhvilluar me mbështetjen e Bankës Botërore (Remittances and Payments Program - RPP), gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, është realizuar projekti për studimin e kostos së pagesave me vlerë të vogël, pjesa e kostos për përdoruesit e shërbimeve të pagesave. Projekti është mbështetur edhe nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, i cili ka përfshirë anketimin e organizatave qeveritare, bizneseve dhe ekonomive familjare. Në përgjithësi, procesi i anketimit ka përfshirë 395 biznese, 1,000 ekonomi familjare dhe 7 agjencione qeveritare.

Rezultatet e këtij studimi, së bashku me rezultatet e studimit të kostos për ofruesit e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël, i realizuar përgjatë vitit 2019, kanë për qëllim të identifikojnë koston e instrumenteve të ndryshme të pagesave (parasë së gatshme, debit dhe kredit kartelave, transfereve të kredit dhe debitimit direkt) për ofruesit dhe përdoruesit e tyre, e cila nxjerrë si kosto e përgjithshme në raport me ekonominë e vendit. Gjithashtu, studimi ka për qëllim që të identifikojë faktorët që kanë ndikim më të madh në nivelin e këtyre kostove.

Të dhënat e nxjerra nga ky studim mundësojnë orientimin e veprimeve të përbashkëta të BQK-së, bankave dhe institucioneve tjera relevante për fushën e pagesave, me qëllim të reduktimit të kostove për pagesat me vlerë të vogël dhe rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së instrumenteve të pagesave elektronike në funksion të zvogëlimit të përdorimit dhe kostove që rrjedhin nga përdorimi i parave të gatshme për ekonominë e vendit.

Gjatë vitit 2020 ka vazhduar punën Grupi Punues i themeluar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së për përcjelljen e zhvillimeve ndërkombëtare për rregullimin e parave virtuale, me fokus trajtimin e tyre nga rregullatorët në Bashkimin Evropian dhe vendet e rajonit. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar dy raporte periodike për Bordin Ekzekutiv, në funksion të përditësimit të informacionit lidhur me zhvillimet ndërkombëtare për sa i përket mënyrës së adresimit të parave virtuale nga rregullatorët.

Në kuadër të programit RPP të referuar më lartë, në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore është iniciuar edhe studimi lidhur me shqyrtimin e mundësive për adaptimin e një skeme lokale ndërbankare për procesimin, kliringun dhe shlyerjen e pagesave të shpejta me vlerë të vogël, të njohura si "Instant Payments". Në kuadër të këtij aktiviteti janë mbajtur disa takime virtuale me ekipin e Bankës Botërore dhe me përfaqësuesit e bankave komerciale, si dhe janë nxjerrë të dhëna lidhur me nivelin e zhvillimit të infrastrukturës së bankave dhe volumin e transaksioneve ekzistuese, si bazë e nevojshme për këtë studim. Studimi ka për qëllim nxjerrjen e rekomandimeve lidhur me mundësitë më të përshtatshme për adaptimin e një skeme/sistemi të pagesave të shpejta në Kosovë, i cili pritet të finalizohet gjatë vitit 2021.

6.3. Menaxhimi i Mjeteve

Banka Qendrore e Kosovës realizon investimin e rezervave kombëtare, si dhe operimin e sistemit qendror depozitar për tregtimin e Letrave me Vlerë të emetuara nga Republika e Kosovës. Detyrat e menaxhimit të rezervave kombëtare janë specifikuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht Nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-209.

6.3.1. Menaxhimi i Investimeve

Banka Qendrore menaxhon rezervat e saj për të arritur objektivat e Politikës së Investimeve të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv, ku prioritet kanë siguria dhe likuiditeti i mjeteve, para kthimit nga investimet.

Instrumentet

Portofoli i rezervave përbëhet nga instrumentet në portofolin likuid dhe ato në portofolin investues. Pjesa likuide e rezervave mirëmbahet për të siguruar mjete të mjaftueshme për kryerjen e pagesave dhe transfereve sipas nevojave të BQK-së dhe depozitarëve të saj, në përputhje me objektivat e Politikës së Investimeve.

Pjesa investuese përbëhet nga instrumentet financiare të sigurta me vlerësim kreditor me gradë adekuate investuese.

Përbërja e portofolit të rezervave të BQK-së është pasqyruar në grafikun 89 sipas gjendjes më 31 dhjetor 2020, ku shohim një përqendrim të konsiderueshëm në pozicionet në llogari rrjedhëse me 33.2 përqind. Ky përqendrim siguron që BQK-ja të jetë vazhdimisht likuide në përmbushjen e kërkesave për transfere të depozitarëve të saj si dhe në respektimin

e objektivës parësore të Politikës së Investimeve. Letrat me vlerë ndërkombëtare që përbëjnë 39.6 përqind të portfolios po ashtu kontribuojnë në objektivin e likuiditetit meqë këto letra janë lehtësisht të tregtueshme apo të konvertueshme në para të gatshme. Letrat me vlerë kombëtare përbëjnë 21.0 përqind të portfolios dhe janë tregtuar në tregun sekondar të letrave me vlerë përmes bankave komerciale vendore. Depozitat bankare prej 6.2 përqind si instrument afatshkurtër i tregut të parasë përbën asetin me pjesëmarrjen më të ulët në portfolion e rezervave.


Portofolin investues të rezervës së BQK-së e përbëjnë këto instrumente financiare:

- depozitat bankare me afat të caktuar apo pacaktuar, përkatësisht depozita në euro dhe dollarë amerikan të plasuara me banka të shteteve të BE-së me vlerësim kreditor me gradë investuese apo me Rezervën Federale të SHBA-së;
- letrat me vlerë ndërkombëtare, respektivisht obligacione qeveritare, komunale, supranacionale, agjensive shtetërore apo institucioneve kreditore në euro me afat maturimi deri në shtatë vjet; marrëveshjet e riblerjes të instrumenteve të lartpërmendura.
- obligacionet shtetërore të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës të tregtuara në tregun sekondar të letrave me vlerë me afat maturimi deri në shtatë vjet, dhe marrëveshjet e riblerjes të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në vitin 2020, BQK për herë të parë ka plasuar marrëveshje të riblerjes me bankat komerciale vendore si instrument i ri në portfolion e investimeve të BQK-së. Ky instrument ndihmon likuiditetin e sektorit bankar, por edhe likuiditetin e gjithmbarshëm të letrave me vlerë kombëtare.

BQK në vitin 2020, është bërë pjesë e marrëveshjes për riblerje të Eurosistemit përmes Deutsche Bundesbankës për bankat qendrore (EUREP)²⁸. Kjo marrëveshje për riblerje bën të mundur që Banka Qendrore e Republikës së Kosovës të marrë hua nga pakjoja e likuiditetit të Euro-sistemit, kundrejt kolateralit adekuat në euro të përbërë nga letra me vlerë të tregtueshme të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të Eurozonës dhe institucionet supranacionale. Përmes kësaj

Grafik 89. Portfolio e rezervave të BQK-së, sipas gjendjes 31 dhjetor 2020



²⁸ [Eurosystem repo facility for central banks - FAQ \(europa.eu\)](https://www.europa.eu/press-room/media/infographic/eurosystem-repo-facility-for-central-banks-faq)

marrëveshje të riblerjes adresohen nevojat e mundshme të likuiditetit në euro të BQK-së në rast të kërkesave që vijnë si pasojë e situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Nën marrëveshjen e riblerjes Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të jetë në gjendje të marrë hua deri në 100 milion euro nga Banka Qendrore Evropiane. Marrëveshja e riblerjes do të qëndrojë në fuqi deri në fund të marsit 2022, përveç nëse vendoset për zgjatje të afatit.

Valutat

Valuta euro përbën valutën kryesore në portofolin investues të BQK-së me 99 përqind të aseteve të denominuara dhe paguara në euro. Rreth 1 për qind e portofolit të rezervave mbahet në dollar amerikan të investuara në plasmane një-ditore me normën e interesit të kuotuar nga marrëveshjet e riblerjes me Rezervën Federale të SHBA-ve. Shpërndarja e aseteve në dy valutat përkatëse bëhet në bazë të përmbajtjes së rezervave të BQK-së nga depozitarët e saj, të cilat kryesisht vijnë dhe mbahen në valutën euro.

Shpërndarja

Në përputhje me objektivat e Politikës së Investimeve të BQK-së, plasmani i investimeve të rezervave është përqendruar në instrumentet financiare të sigurta dhe likuide, respektivisht në instrumente borxhi apo obligacione me maturitet maksimal deri në shtatë vjet dhe rangim kreditor adekuat.


Siç është pasqyruar në grafikun 90 letrat me vlerë përbëjnë instrumentet kryesore me pjesëmarrjen më të lartë në portofolin e BQK-së.

Ndryshimin kryesor në alokimin e portfolios e shohim te kategoria e depozitave bankare ku në janar të vitit 2020 depozitat bankare përbëjnë 25 përqind të portfolios investuese, përderisa në dhjetor të këtij viti kemi një rënie prej 6.2 përqind të portfolios investuese.

Shpërndarja e portfolios së BQK-së në letra me vlerë është diktuar po ashtu nga çmimet e obligacioneve në treg dhe ofertën e tregut për obligacionet qeveritare, supranacionale, të agjensive dhe institucioneve kreditore të emetuara


dhe paguara në euro, normat e kthimit të të cilave kanë rënë ndjeshëm edhe përgjatë vitit 2020. Oferta jashtëzakonisht e limituar për këtë kategori instrumentesh dhe normat negative në euro kanë pamundësuar blerjet e reja të këtyre obligacioneve nga BQK. Sidoqoftë, BQK ka mbajtur nivel të kënaqshëm të alokimit në letra me vlerë edhe përgjatë vitit 2020, duke u siguruar që limitet të jenë në përputhje me kufizimet e përcaktuara në Politikën e Investimeve.

Grafik 90. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së (në përqindje)



Burimi: BQK (2021)

Grafik 91. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2021)

Norma negative depozitare e aplikuar ndaj mjeteve në euro ka bërë që në vitin 2020 të vazhdohet të mbahet një nivel relativisht më i ulët i rezervave totale të depozitarëve me BQK-në. Norma depozitare në euro bazohet në normën e vendosur nga Banka Qendrore Evropiane për depozita (deposit facility rate) që përgjatë vitit 2020 ka qëndruar në -0.5 përqind.

Siç shihet në grafikun 91 rezervat në dispozicion në portfolion e BQK-së kanë shënuar një rënie të vogël të ndikuar nga depozitarët e BQK-së që gjithashtu gjatë vitit 2020 kanë mbajtur nivel më të ulët të mjeteve për t'i evituar kostot e aplikuar ndaj llogarive në euro, respektivisht për të evituar normën depozitare në euro.

Ndryshimin kryesor në strukturën e shpërndarjes së portfolios e shohim tek grafiku 92 për depozitat bankare. Kjo kategori asetesh ka shënuar rënie, në mënyrë që të rritet koncentrimi në llogari rrjedhëse. Ekspozimi apo shpërndarja e mjeteve në letra me vlerë është relativisht e përafërt krahasuar me vitet paraprake, me përjashtim të vitit 2018 ku koncentrimi në letra me vlerë ishte më i lartë. Kjo shpërndarje i mundëson BQK-së që të mbajë likuiditet të mjaftueshëm në portfolion e saj të rezervave, njëkohësisht duke siguruar që përmes

alokimit të fondeve në këto instrumente të kontribuoj në likuiditetin e gjithmbarshëm të portfolios dhe të gjenerojë normë të kënaqshme kthimi nga kjo kategori e asetëve.

6.3.2. Performanca e portfoliit

Instrumentet në portfolin e BQK-së kanë performuar mirë me 2.85 milionë euro të hyrat nga të gjitha kategoritë e investimeve, përfshirë diferencën në mes të hyrave dhe shpenzimeve nga normat depozitare të aplikuar ndaj llogarive. Letrat me vlerë përbëjnë instrumentin me performancën më të mirë në portfolion e BQK-së, ndërsa në veçanti letrat me vlerë të Republikës së Kosovës përbëjnë instrumentin me kthim më të favorshëm në portfolio.

6.3.3. Menaxhimi i Rrezikut


Investimi i mjeteve bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet, agjencitë më kredibile të Eurozonës dhe institucionet supranacionale me vlerësim kreditor investiv sipas vlerësimeve nga Agjencitë Kreditorë ndërkombëtare: Standard & Poor's dhe Moody's, si dhe në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës.

Rreziqet financiare gjatë investimit të mjeteve nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku i likuiditetit, rreziku valutor dhe rreziku operacional.

Rreziku kreditor - Portofolio e investimeve është shpërndarë në mënyrë që të mbahet rreziku kreditor në nivel të ulët. Të gjitha investimet janë realizuar në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër dhe afatgjatë kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) për afat të shkurtër dhe Baa2/BBB (Moody's/S&P) për afat të gjatë, si dhe në rastet e jashtëzakonshme në treg, me P-3/A-3 për afat të shkurtër dhe Baa3/BBB- (Moody's/S&P) për afat të gjatë.

Rreziku i normës së interesit - menaxhimi i rrezikut të normave të interesit nga BQK-ja kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë

Grafik 92. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit



Burimi: BQK (2021)

e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standardë dhe jostandardë të normave të interesit.

Rreziku i likuiditetit - është rreziku në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve nga detyrimet e saj financiare. Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, që vazhdimisht të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Rreziku valutator paraqitet si pasojë e lëvizjeve të kursit këmbimor që implikojnë vlerën e valutave në tregun financiar ku mund të paraqitet kthimi apo humbja si rezultat i ndryshimeve të kursit këmbimor.

Rreziku operacional - është rreziku i përmbushjes që ka të bëjë me plasmanin e depozitave, tregtimin e letrave me vlerë dhe pagesën me kohë të tyre.

6.3.4. Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës

Në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike BQK vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave në procesin e emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë.


Sipas kalendarit të emetimeve të letrave me vlerë të publikuar nga Ministria e Financave, në vitin 2020 përmes platformës elektronike janë realizuar gjithsej 15 ankande: 2 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi dy vjet, 5 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi tre vjet, 5 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi pesë vjet, 1 ankand për obligacione qeveritare me afat maturimi shtatë vjet dhe 1 ankand për obligacione qeveritare me afat maturimi dhjetë vjet. Gjatë vitit 2020 për herë të parë është realizuar ankandi për emetimin e obligacionit qeveritar me afat maturimi 10 vjet përmes plasimit direkt të letrave me vlerë të Qeverisë, bazuar në marrëveshjen në mes të Ministrisë së Financave dhe Transfereve dhe Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Në grafikun 93 paraqitet struktura e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020, e shprehur në përqindje sipas afatit të maturimit.

Grafiku 94 paraqet pjesëmarrjen sipas kategorisë së investitorit në ankandet e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në tregun primar.²⁹

Grafiku 95 paraqet normën mesatare vjetore të kthimit krahasuar me vitin paraprak, që për obligacionet qeveritare me afat maturimi 2 vjet në vitin 2020 ka shënuar rënie prej 27 pika bazë. Norma mesatare vjetore e kthimit për obligacionet qeveritare me afat maturimi 3 vjet ka shënuar rënie prej 8 pika bazë, për obligacionet qeveritare 5 vjet është shënuar rënie prej 2 pika bazë, për obligacionet qeveritare 7 vjet është shënuar rritje prej 71 pika bazë dhe për obligacionet qeveritare 10 vjet është shënuar rënie prej 53 pika bazë.

Grafik 93. Struktura e letrave me vlerë të qeverisë sipas afatit të maturimit



²⁹ Pjesëmarrës në tregun e letrave me vlerë të Qeverisë janë bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit dhe pjesëmarrësit tjerë përmes bankave komerciale (Akteve Primar).

Në grafikun 96 janë paraqitur të gjitha ankandet ku shihet se kërkesa më e lartë nga tregu ishte për obligacione qeveritare me afat maturimi 5 vjet dhe 3 vjet, pastaj edhe 10 vjet.


Aktivitetet e shitblerjeve në tregun sekondar, marrë në konsideratë numrin e transaksioneve dhe vëllimin e tregtimeve me letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës krahasuar me vitin paraprak, kanë vazhduar me intensitet të ngjashëm. Numri vjetor i transaksioneve për vitin 2020 ka qenë 79, ndërsa në vitin 2019, janë realizuar 102 transaksione. Vëllimi vjetor i tregtimeve në tregun sekondar të letrave me vlerë emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020 ka qenë 109.5 milion euro, ndërsa në vitin 2019 ishte 104.5 milion, me një rritje prej 4.8 përqind. Pjesëmarrës në shitblerje të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës kanë qenë bankat komerciale, institucionet publike si dhe personat fizikë.

Gjatë vitit 2020, është aprovuar Rregullorja për huadhënie brenda-ditore dhe njëditore me letra me vlerë të Qeverisë, e cila i mundëson sektorit bankar menaxhimin sa më efikas të likuiditetit ditor.


Bazuar në Rregulloren për Riblerje të Letrave me Vlerë të Qeverisë me BQK, është bërë publikimi i normës së interesit për riblerje të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila normë është e përbërë nga norma bazë duke i shtuar edhe marzhën e përcaktuar nga BQK. Kjo normë shërben për qëllime të huadhënies afatshkurtër të mbështetur me kolateral të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes transaksioneve të riblerjeve të letrave me vlerë me banka komerciale.

Pas publikimit të normës së interesit, kanë filluar të publikohen edhe të dhënat për vlerësimet e tregut për të gjitha letrat me vlerë të pamaturuara, në formë të normës së vlerësuar të kthimit për secilën kategori të maturimit nga 1 deri në 10 vjet. Si rezultat, vëllimi i transaksioneve të riblerjeve përmes BQK-së, ishte prej 7.8 milionë euro. Po ashtu gjatë këtij viti, kanë vazhduar të realizohen me intensitet të shtuar transaksionet e riblerjeve ndërbankare të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me


Grafik 94. Struktura e investitorëve në ankande



Grafik 95. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2019 dhe 2020, në përqindje



Grafik 96. Ankandet e letrave me vlerë të qeverisë në vitin 2020



një vëllim prej 60.3 milionë euro, duke paraqitur rritje të theksuar krahasuar me vitin e kaluar që ishte 6.1 milionë euro.

6.4. Teknologjia Informative

Gjatë vitit 2020, Departamenti i Teknologjisë Informative ka vazhduar me avancimin e sistemeve të teknologjisë informative dhe proceseve të punës.

Si shkak i pandemisë të shkaktuar nga përhapja e virusit COVID-19, në momentin e shpalljes së situatës emergjente nga qeveria e Republikës së Kosovës, është aktivizuar plani i vazhdimësisë së funksionimit për situata të jashtëzakonshme, që ka mundësuar vazhdimin e funksionimit të shërbimeve që Banka Qendrore e Kosovës ofron për institucionet financiare, qeveritare dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Pasi që si rrjedhojë e punës nga distanca janë rritur edhe sulmet kibernetike në botë, në mënyrë të vazhdueshme janë testuar dhe monitoruar sistemet e saj për ndonjë sulm eventual, apo tentim të keqpërdorimit të tyre.

Me qëllim të përmirësimit të proceseve të punës, ka vazhduar puna në zhvillimin e aplikacioneve të ndryshme, për t'i mbuluar nevojat në rritje për aplikacione të reja dhe avancimin e atyre ekzistuese. Po ashtu, janë avancuar edhe shërbimet që ofrohen, duke u bazuar në kornizën për menaxhimin e shërbimeve – ITIL.

6.5. Regjistri i Kredive të Kosovës

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja mund të operojë, rregullojë, licencojë, regjistrojë dhe mbikëqyrë sistemet e informacionit të kredive me qëllim të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të kredive mes institucioneve kredidhënëse, si dhe të nxjerrë rregullore për zbatimin përkatës.

Bazuar në këtë objektiv që nga viti 2006, BQK-ja ka nën menaxhim të saj sistemin e Regjistrimit të Kredive (RKK), i cili funksionon si një aplikacion i bazuar në internet dhe ka për qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave kreditore të personave fizikë dhe juridikë, me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të klientëve kreditorë si dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të BQK-së.

Nga një perspektivë e përgjithshme ekonomike, Regjistri i Kredive lehtëson kredidhënien sa i përket vëllimit dhe kostove, si dhe kontribuon në stabilitetin financiar në përgjithësi duke ndihmuar kredidhënësit për një vendimarrje të drejtë, brenda një kohe më të shkurtër në mënyrë më të saktë dhe më objektive.

Në bazë të rregullores së Regjistrimit të Kredive, anëtarë në sistemin e RKK-së janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga BQK për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat dhe institucionet mikro-financiare të licencuara, si dhe ato institucione financiare jobankare dhe siguruesit të licencuar për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore.

Bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së aktualisht janë të regjistruar 1,928 përdorues aktiv të institucioneve kredidhënëse, ku dominon numri i përdoruesve nga institucionet bankare me 1,430 përdorues aktiv, institucionet mikro-financiare dhe ato jobankare me 465 përdorues dhe siguruesit me 33 përdorues aktiv të sistemit të RKK-së. Gjatë vitit 2020, Regjistri i Kredive ka regjistruar 238 përdorues të ri.

Sistemi i Regjistrimit të Kredive është i dizajnuar që të sigurojë një infrastrukturë të avancuar për funksionimin e tregut të kredive duke paraqitur një mjet të rëndësishëm për institucionet kredidhënëse në vlerësimin e riskut kreditor.

Sistemi i RKK-së është një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga stafi i institucioneve kredidhënëse.

Institucionet kredidhënëse në sistemin e RKK-së hulumtojnë mbi historitë kreditore të aplikantëve kreditor ku sipas statistikave që dalin nga sistemi i RKK-së, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2020 kap shifrën prej 734,130 hulumtime.

Një pasqyrë mbi këtë aktivitet, në baza vjetore, për vitet 2016 - 2020 është paraqitur në vijim në grafikun 97.


Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në RKK, të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga BQK-ja.

Bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së, gjatë vitit 2020 janë raportuar 194,160 kredi ku përfshihen huat, kreditkartelat, mbitërheqjet, kreditë hipotekare rezidenciale, linjat kreditore, garancionet, lizingu, faktoringu dhe asetet tjera kreditore. Për dallim nga vitet e kaluara, kemi rënie të numrit të kredive të raportuara në sistemin e RKK-së të ndikuar kryesisht nga mbyllja e dy institucioneve kredidhënëse Iute dhe Monego, si dhe nga rënia e nivelit të kredidhënies për shkak të pandemisë.

Raporti i numrit të kredive të aprovuara sipas llojit të institucionit kredidhënës për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është paraqitur në vijim përmes grafikut 98.


Grafiku 99 paraqet numrin e kërkesave për raportin individual kreditor të kredimarrësve (fizikë / juridikë) bazuar nga të dhënat e sistemit të Regjistrimit të Kredive për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, dhe 2020.

Grafik 97. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së




Burimi: BQK (2021)

Grafik 98. Numri i kredive të raportuara në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2021)

Grafik 99. Numri i kërkesave për raporte kreditore



Burimi BQK (2021)

6.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Në funksion të realizimit të objektivit primar të saj, ruajtjes së stabilitetit financiar përmes monitorimit të rregullt të rrezikut sistemik, ndër të tjera, BQK bën identifikimin, monitorimin dhe analizimin e rrezikut sistemik në baza të rregullta tremujore. Në këtë kontekst, identifikimi i rreziqeve potenciale bëhet përmes monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimeve ciklike dhe strukturore makroekonomike. Vlerësimi i rreziqeve dhe ndikimi i tyre potencial në stabilitetin financiar dhe për pasojë stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, bëhet përmes analizave të rregullta kualitative dhe kuantitative përfshirë analizimin e ecurisë së treguesve ekonomikë dhe financiarë me frekuencë të lartë, parashikimet mbi treguesit kryesorë makroekonomikë dhe aplikimin e modeleve, që adresojnë dimensionin ciklik, strukturor dhe ndërsektoral të rrezikut sistemik.

BQK ka vazhduar të jetë e fokusuar në rritjen e vëllimit dhe cilësisë së analizave që shqyrtojnë zhvillimet kryesore makroekonomike në vend dhe atyre me fokus në vlerësimin e stabilitetit financiar, veçanërisht me dinamikën e reja të krijuara me situatën pandemike në vitin 2020. Përmes identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve që kanosin sistemin financiar dhe infrastrukturën e tij, me një perspektivë të analizave të bazuar në rrezik, BQK ka vazhduar të informojë publikun mbi gjendjen e sistemit financiar, të rrisë transparencën dhe nxisë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar të vendit dhe infrastrukturës së tij.

Përveç analizave të ndryshme periodike dhe monitorimit të rregullt të treguesve kryesorë të zhvillimeve në sektorët përkatës të ekonomisë, BQK ka vazhduar të azhurnojë modelet e zhvilluara për vlerësimin e rreziqeve, si modelin e Hartës së Stabilitetit Financiar (që analizon zhvillimet në tetë dimensione të rrezikut ndaj stabilitetit financiar), modelin e stres-testit (një nga veglat kyçe për identifikimin e brishtësive aktuale në sektorin bankar dhe rreziqeve potenciale sistemike në vitin vijues), modelin e Identifikimit të Bankave me Rëndësi Sistemike (instrument tipik i politikës makroprudenciale i cili vlerëson rrezikun e shpërndarjes së efekteve negative të një institucioni sistemik në tërë sistemin), si dhe modelin e Kapitalit Shtesë Kundërciklik (model i politikës makroprudenciale).³⁰

Një ndër publikimet më të rëndësishme periodike, që vazhdon të publikohet dy herë në vit është Raporti i Stabilitetit Financiar. Ky raport pasqyron qëndrueshmërinë e sistemit financiar, duke analizuar zhvillimet e përgjithshme ekonomike, së bashku me zhvillimet në aktivitetin, performancën dhe qëndrueshmërinë e të gjithë komponentëve të sistemit financiar të vendit.

Për t'i siguruar publikut qasje sa më të shpejtë në informacionet rreth zhvillimeve në ekonominë e vendit, BQK-ja ka vazhduar të publikojë në baza të rregullta edhe Vlerësimet Tremujore, raporte që ofrojnë një pasqyrë mbi zhvillimet kryesore makroekonomike dhe zhvillimet në të gjithë komponentët e sistemit financiar të ekonomisë në baza tremujore. Për më tepër, BQK-ja ka vazhduar të publikojë edhe Raportin e Informatave Mujore të Sistemit Financiar, raport që paraqet një përmbledhje të indikatorëve kyç për të gjithë komponentët e sistemit financiar të Kosovës dhe publikohet çdo muaj.

Me interes të veçantë sidomos në vitin 2020, si pasojë e rrethanave të reja të shkaktuara nga kriza pandemike, BQK-ja ka vazhduar të realizojë Anketën e Kreditimit Bankar (AKB) me bankat komerciale, duke mbledhur kështu informacion të rëndësishëm për faktorët me ndikim në aktivitetin kredidhënës të bankave në Kosovë dhe për pritjet e tyre për aktivitetin kredidhënës në periudhën e ardhshme. Informacionet nga kjo anketë e cila tashmë realizohet në baza tremujore, përveç që kanë ndihmuar për të kuptuar më mirë zhvillimet në sektorin bankar, kanë shërbyer edhe si input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe të agregatëve tjerë

³⁰ Informata më të detajuara rreth metodologjisë dhe analizës së modeleve paraqiten në Raportin e Stabilitetit Financiar nr.17.

makroekonomikë. Një zhvillim shtesë në Anketën e Kreditimit Bankar është zgjerimi i anketës me vlerësimin e pritshmërive të inflacionit nga bankat. Si rezultat, AKB gjatë vitit 2020 është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adreson pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspekt të analizimit, modelimit dhe parashikimit të dinamikave të inflacionit. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifikë që potencialisht mund të ndikojnë në pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit. Nga fundi i vitit 2020, seria kohore e pritjeve të bankave për dinamikat në inflacion publikohen edhe në faqen zyrtare të BQK-së.

6.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2020

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK mbledh të dhënat statistikore për të kryer detyrat e saj të parapara me ligj. Ajo mbledh të dhëna të nevojshme për të nxitur dhe mbajtur një sistem financiar stabil; sistem të pagesave efikas e të sigurtë; për të kontribuar në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore; mbështetur në politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë; si dhe për të informuar Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe publikun e gjerë për treguesit real të ekonomisë dhe realizimin e politikave nga vet BQK-ja. Të dhënat statistikore përpilohen edhe për qëllime të raportimit në organizata ndërkombëtare.

BQK mbledhë të dhëna nga bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit, institucionet tjera financiare, ndërmarrje në pronësi të huaj, dogana e Kosovës, institucione qeveritare, biznese të tjera dhe nga individët e tjerë privatë. Këto informata janë të nevojshme për të analizuar zhvillimet në tregjet financiare dhe në sistemin e pagesave, ose për të përgatitur statistikat e bilancit të pagesave, remitencat, statistikat mbi pozicionin ndërkombëtar të investimeve të Kosovës, investimet direkte, borxhin e jashtëm, etj. Të dhënat e grumbulluara nga raportuesit i nënshtrohen një regjimi të konfidencialitetit dhe përdoren vetëm për çështje statistikore. Ato publikohen vetëm në formë të grumbulluar.

Gjatë 2020, pandemia Covid-19 ka krijuar vështirësi në prodhimin e shumë statistikave kryesore, pasi operacionet që kanë të bëjnë me anketimin janë vështirësuar e në disa raste janë ndërprerë, siç është rasti i anketës me emigrantët Kosovarë që vijnë në Kosovë gjatë stinës së verës.

Me gjithë vështirësitë, BQK ka vazhduar publikimin e rregullt të statistikave për sektorin monetar dhe sektorin e jashtëm, që janë përgjegjësi kryesore e BQK-së. Këtë vit, BQK-ja ka publikuar disa informata të reja në lidhje me sektorin e statistikave të llogarive financiare. Metodologjia kryesore e përdorur është ajo e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Qendrore Evropiane, Bankës Botërore, dhe Eurostatit. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe besueshmërisë në statistikat që prodhon BQK-ja, gjatë vitit 2020 është azhurnuar e ripublikuar në faqen zyrtare të BQK-së, Metodika mbi Statistikat Monetare dhe Financiare. Metodika mbi Sektorin e Jashtëm është rifreskuar vitin e kaluar. Informacione të plota për prodhimin e statistikave të Kosovës dhe praktikata e shpërndarjes janë të prezantuara edhe në faqen e FMN-së “Dissemination Standards Bulletin Board”.

BQK-ja publikon statistikat e saj në faqen e saj të internetit (www.bqk-kos.org) dhe, në disa raste, edhe në formën e botimeve të shtypura (Raporti Vjetor i BQK-së). Nga fundi i vitit 2020, janë publikuar një mori e tabelave të reja në kuadër të Serive Kohore (<https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore>) në faqen e BQK-së. Në përgjithësi, BQK-ja ka përbushur plotësimin e kërkesave të brendshme dhe të jashtme me statistikat të nevojshme për monitorim të stabilitetit financiar, si dhe plotësimin e kërkesave statistikore për nevoja të mbikëqyrjes së institucioneve financiare, e analizave ekonomike. BQK ka përbushur edhe kërkesa të shumta me të dhëna për palët e jashtme, përfshirë institucionet qeveritare, mediat, organizata ndërkombëtare, publiku i gjerë, etj.

Gjatë vitit 2020, BQK-ja ka vazhduar përafrimin e mëtejshëm të statistikave nën përgjegjësinë e saj me standardet e BE-së të përcaktuara me Sistemin Evropian për Llogari Kombëtare dhe Regjionale (ESA 2010). Kështu, në baza të rregullta mujore ka raportuar statistikat mbi normat e interesit në Bankën Qendrore Evropiane (BQE). Kurse në Eurostat ka dërguar në baza tremujore statistikat e Bilancit të Pagesave e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, deri sa në baza vjetore ka raportuar statistikat për Investimet Direkte dhe Statistikat për Tregtinë Ndërkombëtare në Shërbime.

Progres i rëndësishëm është bërë këtë vit në ndërtimin e kornizës për përpilimin e Statistikave të Llogarive Financiare (SLLF); si dhe të Bilancit të gjendjes sipas çasjes sektoriale. Në fund të vitit 2019, janë publikuar të dhënat stoku, në baza vjetore, për SLLF përfshirë të dhënat për vitet e kaluara që nga viti 2006 e këndeje. Këtë vit është përmirësuar periodiciteti nga vjetor në tremujor; janë publikuar të dhënat edhe për transaksionet (vitin e kaluar ishin vetëm të dhënat stok); si dhe është vazhduar me publikimin e rregullt tremujor. Të gjitha tabelat e lartpërmendura janë publikuar mbi bazën "nga kush-te-kush", që nënkupton se janë plotësuar edhe kërkesat e Eurostatit dhe FMN-së për publikim të Bilancit të Gjendjes sipas Qasjes Sektoriale.

Gjatë vitit 2020 janë nënshkruar dy kontrata me GOPA/Eurostatin për avansim të statistikave lidhur me përpilimin e Indikatorëve të Procedurës së Imbalancës (anglisht: Macroeconomic Imbalance Procedure - MIP) dhe përmirësimin e mëtejshëm të kualitetit për Statistikat për Tregtinë Ndërkombëtare në Shërbime.

Gjatë vitit 2020 është përmirësuar periodiciteti për përpilimin e statistikave për Fondet Pensionale dhe për pasqyrat e sektorit financiar, nga tremujore në mujore. Janë përgatitur për publikim tabelat për investimet direkte sipas NACE Rev. 2. Gjithashtu BQK-ja ka përmirësuar afatin kohor për publikimin e statistikave për remitencat, nga 90 ditë në 25 ditë pas përfundimit të muajit referues.

Kurse në aspektin e mbledhjes së informacioneve është bërë implementimi i versionit të ri të Udhëzimeve për Raportim të Sistemit të Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN). Në vazhden e përpjekjeve për informata të shpejta gjatë kohës së pandemisë, BQK ka filluar përdorimin e burimeve të reja të informatave. Kështu të dhënat nga databaza e sistemit SWIFT janë futur në përdorim për të bërë vlerësime 'BLIC' për nevoja të analizimit të trendëve si rrjedhojë e zhvillimeve gjatë pandemisë.

Në fushën e procesimit të të dhënave, është bërë një rritje e automatizimit të proceseve të punës për përpilimin dhe validimin e statistikave. Përmirësimi i proceseve të validimit të statistikave, me fokus në tabelat që publikohen në faqen e BQK-së dhe ato që dërgohen në organizata ndërkombëtare (p.sh. Eurostat).

Me gjithë progresin, pandemia Covid-19 ka ndikuar që disa projekte të parapara për këtë vit janë shtyrë për vitin e ardhshëm. Këtu përfshihet implementimi i platformës së re online për të mbedhur raportet statistikore për investime direkte nga ndërmarrjet raportuese, rritja e numrit të anketave për përpilimin e disa komponentëve të caktuar të bilancit të pagesave; përmirësimi i periodicitetit të statistikave të bilancit të pagesave që dërgohen në Eurostat nga tremujore në mujore; si dhe përpilimin e statistikave të llogarive financiare për ekonomitë familjare, sektorin qeveritarë dhe korporatat jofinanciare; avancim i menysë 'Statistikat' në faqen zyrtare të BQK-së.

6.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja

BQK gjatë ushtrimit të kompetencave të veta mbikëqyrëse, duke vepruar në pajtueshmëri me nenin 67. pika 4 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, para se të shqiptojë ndëshkime administrative, i ofron një deklaratë të detajuar personit të cilit do t'i shqiptohet ndëshkimi duke përshkruar faktet dhe ligjin që mbështesin ekzistencën e shkeljes dhe

do t'i japë këtij personi mundësi të plotë të ofrojë fakte dhe argumente se pse ndëshkimi nuk do duhej t'i shqiptohej. Në dokumentin/deklaratën e dërguar nga BQK-ja (Njoftim për qëllimin e shqiptimit të masave ndëshkimore administrative), jepet edhe këshilla juridike, ku institucioni informohet me të drejtën që brenda 15 ditësh kalendarike nga dita e pranimin të kësaj deklarate, të bëjë kërkesë për rishqyrtim te Divizioni i Rishqyrtimit.

Institucionet e mbikëqyrura nga BQK-ja pas pranimin të një deklarate të tillë pasi që kanë mundësinë e rishqyrtimit të masës ndëshkimore, në rast se vendosin të ankohen, e adresojnë kërkesën te ky Divizion.

Për gjatë vitit 2020 janë pranuar për rishqyrtim 4 kërkesa nga institucionet financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar me kujdesin profesional dhe në pajtueshmëri me kuadrin ligjor, janë adresuar në formën e rekomandimeve dhe janë përcjellë në Bordin Ekzekutiv të BQK-së për vendimmarrje.

Ky Divizion ka përcjellur në vazhdimësi zhvillimet e rregullativës me qëllim të identifikimit të nevojave për ndryshim të ndonjë dispozite që do të ndërlihej me çështjet e rishqyrtimit të kërkesave që vijnë nga institucionet e lartcekura.

7. Zhvillimet e Brendshme

7.1. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion i rëndësishëm, i cili siguron Bordin e BQK-së dhe Menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Auditimi i brendshëm bashkë me auditimin e jashtëm përmbyllin zingjirin e llogaridhënies brenda çdo institucioni.

Korniza ligjore e BQK-së i ofron mandat të plotë AB-së që në mënyrë të pavarur të zhvilloj angazhime të auditimit me qëllim që t'i ofrojë Bordit/Menaxhmentit rekomandime në funksion të rritjes së efikasitetit të kontrolleve të brendshme dhe shtimit të vlerës në institucion.

Edhe pse gjatë pjesës më të madhe të vitit 2020, Auditimi i Brendshëm ka operuar me personel të reduktuar, kanë vazhduar angazhimet/auditimet konform Planit Vjetor 2020, të miratuar nga Bordi i BQK-së. Ky plan, paraprakisht ishte përgatitur duke bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Rreziqeve, sipas Qasjes së Bazuar në Rrezik (model ky i adaptuar nga praktika e Bankës Qendrore Evropiane - BQE).

Auditimet e kryera gjatë vitit 2020 ishin të natyrës: financiare, të pajtueshmërisë, operacionale dhe të teknologjisë informative. Fushëveprimi i AB-së ka vazhduar të jetë i orientuar në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të sistemeve/procese të cilat e ndihmojnë Menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara. Auditimi i Brendshëm përmes dhënies së rekomandimeve vazhdon të jetë vlerë e shtuar për Menaxhmentin dhe Bordin e BQK-së.

AB-ja, konform kërkesave ligjore ka përgatitur edhe Planin Vjetor 2021, të cilit Plan i ka paraprirë përgatitja e Universit të Auditimit për periudhën trevjeçare 2021-2023. Ky dokument sipas procedurave ligjore, fillimisht diskutohet nga Komiteti i Auditimit, e pastaj diskutohet dhe aprovohet nga Bordi i BQK-së. Pas datës 15 qershor 2020, si rrjedhojë e skadimit të mandatit të dy (2) anëtarëve joekzekutivë të Bordit të BQK-së (të cilët ishin edhe anëtarë të Komitetit të Auditimit), këto dy organe kanë mbetur jofunksionale.

Megjithatë, Shefi i Auditimit të Brendshëm, në fund të muajit dhjetor 2020, ka proceduar Planin Vjetor 2021 tek Kryetari i Bordit të BQK-së, Guvernatori dhe anëtari i jashtëm i Komitetit të Auditimit. Ky plan pritet të aprovohet, sapo të funksionalizohet Bordi i BQK-së dhe Komiteti i Auditimit.

Në përputhje me Ligjin e BQK-së dhe Statutin e Auditimit të Brendshëm, Shefi i AB-së, deri më 15 qershor 2020, ka raportuar tek Komiteti i Auditimit dhe Bordi i BQK-së lidhur me të gjeturat (rezultatet e auditimit), rekomandimet, si dhe veprimet e ndërmarra për adresimin e rekomandimeve të dhëna.

Përderisa, gjatë periudhës korrik-dhjetor 2020, Shefi i Auditimit të Brendshëm ka vazhduar raportimin e rregullt tek Kryetari i Bordit të BQK-së, Guvernatori dhe anëtari i jashtëm i Komitetit të Auditimit. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur disa takime me karakter informues në mes të Kryetarit të Bordit të BQK-së, Guvernatorit, anëtarit të jashtëm të KA-së dhe Shefit të AB-së. Në këto takime është diskutuar mbi ecurinë e aktiviteteve të Auditimit të Brendshëm, me theks të veçantë procesi i përcjelljes së implementimit të rekomandimeve.

AB-ja ka vazhduar me aktivitete lidhur me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga vlerësimet e jashtme, si: Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane, Fondi Monetar Ndërkombëtar - Vlerësimi i masave mbrojtëse (Safeguards Assessment) dhe USAID.

Në funksion të adresimit të këtyre rekomandimeve, Manuali i Auditimit të Brendshëm është aprovuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe Bordi i BQK-së. Përderisa, formularët

standardë të auditimit janë përditësuar, forma e raportit të auditimit është ndryshuar, planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve parashohin afate për adresim të rekomandimeve, etj. Të gjitha këto aktivitete janë ndërmarrë me qëllim të avancimit dhe rritjes së cilësisë së punës së auditimit, gjithmonë duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm.

Përkundër faktit se viti 2020 ka qenë mjaft sfidues, si rezultat i Pandemisë Covid-19, AB-ja ka vazhduar aktivitetet edhe rreth edukimit të vazhdueshëm profesional të personelit, përmes pjesëmarrjes në disa trajnime dhe seminare virtuale.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm është i përfshirë në programin për forcimin e kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor me qëllim integrimin në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, organizuar nga Deutsche Bundesbank, i cili varësisht nga situata pandemike, pritet të vazhdojë së implementuari edhe gjatë vitit 2021.

Po ashtu, në funksion të përmbushjes së detyrave të sajë, AB-ja edhe gjatë vitit 2020 ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Auditorët e Jashtëm të BQK-së.

7.2. Burimet Njerëzore

Në zbatim të objektivave strategjike të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe politikave të administrimit të burimeve njerëzore, BQK-ja është fokusuar në drejtim të përvetësimit dhe zbatimit në vazhdimësi të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore që aplikohen në institucione të ngjashme.


Administrimi efektiv i burimeve njerëzore i kushton rëndësi të veçantë përshtatjes së infrastrukturës rregullative të institucionit me standardet më të mira, si dhe ofron mundësi për zhvillim dhe promovim për të gjithë punonjësit, duke synuar rritjen e profesionalizmit, performancës dhe motivimit të punonjësve.

Në fund të vitit 2020 numri i të punësuarve në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ishte 226. Mosha mesatare e të punësuarve ka qenë 41 vjet. Përfaqësimi gjinor në nivel specialistësh dhe drejtuesish, është i ekuilibruar. Raporti i femrave ndaj meshkujve është 53.5 me 46.5 përqind, ndërkohë që ky raport në nivel drejtues është 41.4 me 58.6 përqind.

Në strukturën e përgjithshme të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës 5 punonjës ose 2.2 përqind janë me PhD, 84 punonjës ose 37.2 përqind me edukim pasuniversitar, 111 punonjës ose 49.1 përqind me edukim universitar, 23 punonjës ose 10.2 përqind me edukim të mesëm dhe 3 punonjës ose 1.3 përqind me edukim bazik (grafik 100).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vlerëson personelin si një ndër resurset me rëndësi të veçantë dhe vazhdimisht angazhohet për mbështetjen e tyre që t'iu sigurojë njohuri të duhura, aftësi, ekspertizë dhe ngritje profesionale adekuate për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas standardeve më të larta, për arritjen e potencialit të plotë të tyre, duke krijuar kushte për vijim të studimeve pasuniversitare, si dhe përmes pjesëmarrjes në konferenca, trajnime, kurse, seminare, etj.

Grafik 100. Struktura sipas edukimit



Burimi: BQK (2021)

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 65 punonjës ose 28.8 përqind e tyre kanë marrë pjesë në trajnime profesionale të cilat kryesisht janë organizuar online nga Banka Qendrore Evropiane, Fondi Monetar Ndërkombëtar - FMN, Joint Vienna Institute - JVI, Deutsche Bundesbank, Banka e Holandës, Banka e Polonisë, Banka e Francës, Banka e Italisë, Banka e Çekisë, Istanbul School of Central Banking, Shoqata e Bankave të Kosovës dhe “Center of Excellence in Finance – CEF”.

7.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së

Gjatë vitit 2020, Banka Qendrore në pajtim me objektivat dhe detyrat e saj, ka vazhduar për të orientuar aktivitetin ligjor drejt avancimit dhe përditësimit të kornizës rregullative të sektorit financiar në pajtim me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, si dhe standardet ndërkombëtare.

Duke marrë parasysh rrethanat e reja të krijuara për shkak të pandemisë së virusit Covid 19, në veçanti gjatë këtij viti, aktiviteti ligjor i BQK-së ka qenë i orientuar në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve adekuate lehtësuese me qëllim të tejkalimit të sfidave të paraqitura, e krejt kjo me qëllim të sigurimit të një sektori stabil financiar, si një nga objektivat kryesore të BQK-së.

Në këtë drejtim, sa i përket akteve nënligjore, është miratuar Udhëzuesi për ristrukturim të kredive për shkak të Covid-19, pezullimi i përkohshëm i dispozitave të caktuara të rregullativës financiare, si dhe një varg masash tjera, e të gjitha këto në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. Përveç veprimeve të nevojshme rregullative të lartcekura, organet vendimmarrëse të BQK-së edhe gjatë këtij viti kanë vazhduar me miratimin e akteve nënligjore, të cilat para miratimit të tyre kanë qenë subjekt i shqyrtimit nga aspekti ligjor, në mënyrë që të sigurohet pajtueshmëria me kornizën ligjore në fuqi.

Sa i përket legjislacionit primar të BQK-së, në proces të miratimit nga organet kompetente gjenden: draft-ligji për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, draft-ligji për banka, si dhe draft-ligji për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Qëllimi i plotësim/ndryshimeve të këtyre ligjeve është harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare, në mënyrë që të arrihen objektivat e BQK-së për ruajtjen dhe mbarëvajtjen e stabilitetit financiar, si dhe mbrojtjen e interesave të policëmbajtësve dhe depozitorëve.

Gjithashtu, gjatë këtij viti BQK-ja është angazhuar edhe në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ato ndërkombëtare, me qëllim të kryerjes me efikasitet të detyrave lidhur me çështjet brenda fushave të kompetencave reciproke të institucioneve përkatëse. Në këtë drejtim janë arritur të nënshkruhen marrëveshje si:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit për mbulimin e obligimeve të primit të sigurimit kufitar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të gjithë bashkatdhetarët dhe të huajt që janë subjekt i policës kufitare dhe vijnë në Kosovë për vitin 2020;
- Marrëveshje e mirëkuptimit ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për shkëmbim të të dhënave të llogarive bankare të kontribuesve të fondit pensional në formë elektronike me qëllim zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike të ndërmarrë nga qeveria në përgjigje të pandemisë së shkaktuar nga Covid19;
- Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës me qëllim të ngritjes së njohurive ekonomike e financiare

te nxënësit, të rinjtë, publiku i gjerë dhe avancimit të bashkëpunimit në fushën e edukimit financiar;

- Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Autoritetit të mbikëqyrjes financiare të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për bashkëpunim reciprok në kuadër të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve financiare;
- Marrëveshje e kredisë për asistencë makro-financiare e nënshkruar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave me Bashkimin Evropian.

Në përgjithësi, aktiviteti ligjor gjatë këtij viti ka qenë i orientuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës ligjore që ka mundësuar vazhdimin e funksionimit të sigurt dhe efektiv të sektorit financiar në Kosovë. Me qëllim të garantimit të stabilitetit financiar si objektivë primare e BQK-së dhe funksionimit të sigurt dhe efektiv të tij, BQK-ja në vazhdimësi mbetet e përkushtuar në rishikimin dhe avancimin e kornizës legjislative në pajtim me zhvillimet më të reja në sektorin financiar.

7.4. Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut

Menaxhimi i rrezikut në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është i orientuar drejt arritjes së objektivave të Bankës Qendrore të përcaktuara me Ligj.

Proceset për menaxhim të rrezikut janë disenjuar për të qenë në shërbim të arritjes së objektivave strategjike të Bankës Qendrore duke ofruar me kohë informacion të strukturuar dhe gjithëpërfshirës rreth ekspozimit ndaj rrezikut, i cili ndihmon vendimmarrjen.

Në BQK proceset për menaxhim të rrezikut fokusohen në identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut dhe përcillet me përgjigje ndaj rrezikut dhe monitorimin e nivelit të tij sipas kuadrit rregullues në fuqi. Këto procese janë pjesë e kornizës për menaxhim të rrezikut.

Në baza periodike është raportuar te Bordi Ekzekutiv i BQK-së rreth aktiviteteve të zhvilluara të cilat kanë qenë në shërbim të menaxhimit të rrezikut operacional, të avancimit të proceseve të menaxhimit të rrezikut operacional dhe në zgjerim të fushëveprimit përtej këtij lloji të rrezikut.

Është punuar në zhvillim dhe azhurnim të kuadrit rregullues, në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e më tejshëm të kornizës për menaxhim të rrezikut dhe në integrim të menaxhimit të rrezikut në të gjitha funksionet e BQK-së. Për të plotësuar kërkesat e institucionit, si pjesë e kornizës për menaxhim të rrezikut, janë zhvilluar dhe adaptuar tutje instrumente dhe modele të ndryshme për menaxhim të rrezikut.

Janë krijuar udhëzues për të lehtësuar proceset për identifikim dhe vlerësim të rrezikut për pronarët e rrezikut, si dhe janë hartuar shkrime me tema vetëdijësimi për rëndësinë e menaxhimit të rrezikut dhe me qëllim të ngritjes së kulturës së rrezikut. Të gjitha këto duke u bazuar në standardet dhe praktikën më të mira të pranueshme për menaxhim të rrezikut.

Për çdo periudhë raportuese janë plotësuar dhe azhurnuar bazat e të dhënave: ajo e proceseve të punës në nivel të BQK-së, mbështetur me detajet e nevojshme dhe regjistri i rrezikut si një bazë e të dhënave shumë kritike për institucionin me natyrë dinamike. Për të mbështetur regjistrin e rrezikut është zhvilluar libraria e kontrolleve, e cila përmban të gjitha kategoritë e kontrollit sipas funksionit që kanë dhe mënyrës se si janë disenjuar. Këto kontrole të vendosura si përgjigje ndaj rreziqeve të identifikuar për proceset e punës, janë vlerësuar sipas shkallës së efektitetit për të ofruar siguri se objektivat strategjike po arrihen.

Për të lehtësuar procesin për identifikim të rrezikut dhe për të kryer vlerësim të strukturuar të rrezikut janë zhvilluar taksonomi si një grup koherent dhe uniform i definicioneve për të mbuluar

më mirë kategoritë dhe nënkategoritë e rrezikut operacional. Taksonomitë ndihmojnë për përshkrim të saktë të rrezikut dhe për t'iu dhënë prioritet veprimeve për trajtim të rrezikut.

Vlerësimi i nivelit të përgjithshëm të rrezikut bazohet në shumë komponentë, të cilat iu janë nënshtuar më pas procesit të analizës kuantitative dhe kualitative, në mënyrë që sa më saktë të konstatohet niveli i rrezikut dhe të rekomandohet për veprimet për menaxhim të tij.

Është zhvilluar katalogu i indikatorëve kyç të rrezikut, si instrument që mundëson gjykimin rreth tolerancës për rrezikun operacional duke ofruar sinjal për menaxhmentin, në rast të rritjes së rreziqeve të caktuara, që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave strategjike të institucionit.

Me shpalljen e pandemisë dhe me aktivizimin e Planit të Vazhdimësisë së Funksionimit janë krijuar instrumente shtesë të menaxhimit të rrezikut operacional për punën në kushte të jashtëzakonshme. Ndër instrumentet kryesore ishin disenjimi i setit të veçantë të indikatorëve kyç të rrezikut, përmes të cilëve është monitoruar niveli i rrezikut për proceset kritike të punës në BQK të identifikuara në Planin e Vazhdimësisë. Raportimi i setit të indikatorëve është bërë në periudha kohore të shpeshta më qëllim të monitorimit të trendëve për këta indikator përgjatë gjithë asaj periudhe.

Për trajtimin e nivelit të rrezikut janë zhvilluar dhe përcjellë plane veprimi përmes të cilëve monitorohen masat të cilat merren për menaxhim dhe mitigim të rrezikut.

Sa i përket trajtimit të llojeve të tjera të rreziqeve, përveç rrezikut operacional, janë ndërmarrë veprime konkrete që çojnë kah zhvillimi i proceseve dhe metodologjive për trajtimin e rrezikut strategjik dhe financiar. Për këtë qëllim janë nis aktivitete bashkëpunimi me bankat tjera qendrore dhe bazuar në rezultatet e këtij bashkëpunimi, kërkesat dhe objektivave strategjike të BQK-së do të vendosen korniza për menaxhim të të gjitha llojeve të rrezikut të cilave ju ekspozohet BQK-ja.

8. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

8.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në mënyrë intensive ka vazhduar të avancojë bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësisve të saj, përkundër situatës së krijuar nga pandemia, si në vendin tonë, ashtu edhe në gjithë botën.

Gjatë vitit 2020, BQK-ja vazhdoi bashkëpunimin me institucione financiare ndërkombëtare, si: Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankën Botërore (BB), Bankën Qendrore Evropiane (ECB), Autoritetin Bankar Evropian (EBA), Forumin Ekonomik të Crans Montana në Zvicër, Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Komisionin Evropian (EC), Deutsche Bundesbank, Autoritetet e Mbikëqyrjes Federale Gjermane, Autoritetin e Mbikëqyrjes Austriake, Bankën e Turqisë, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Bankës Botërore, Eurostat-in dhe institucione të tjera.

Udhëheqësit e BQK-së të kryesuar nga Guvernatori, zhvilluan takime me misionin e FMN-së, të cilët u njoftuan me situatën aktuale në sistemin financiar të Kosovës, në përgjithësi dhe sistemin bankar në veçanti, i cili vazhdon të jetë stabil dhe me rritje të vazhdueshme.

Gjithashtu, u zhvillua takimi me Checchi and Company Consulting, kontraktor i USAID, me të cilët u diskutua për mundësitë që i ofron arbitrazhi në zgjidhjen e kontesteve ligjore, të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit financiar.

Ndërkaq me ekipin e Bankës Botërore u diskutua për Memorandumin Ekonomik të Vendit (Country Economic Memorandum), si dhe perspektiva dhe sfidat në të ardhmen lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit.

Falë bashkëpunimit të ngushtë mes BQK-së dhe FMN-së, Kosova siguroi mbështetjen financiare në vlerë prej 52 milionë eurosh, e cila u konfirmua gjatë një takimi virtual në mes Guvernatorit dhe Ministrisë të Financave dhe Transfereve, me drejtorin e Departamentit për Evropë të FMN-së.

Në këtë takim virtual FMN-ja siguroi se do të mbështesë Kosovën për t'iu përgjigjur sfidave me të cilat do të ballafaqohet ekonomia e vendit.

Po ashtu, zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe ministrja e Financave, nënshkruan marrëveshje me komisionerin për Ekonomi të Bashkimit Evropian.

Me anë të kësaj marrëveshje Kosova ka përfituar 100 milion euro kredi për asistencë makrofinanciare, që ka si qëllim të ndihmojë Kosovën në Planin për Rimëkëmbje Ekonomike dhe në zbatimin e masave emergjente.

Marrëveshja e nënshkruar vjen pas hapjes së mundësisë së përfitimit nga kjo skemë e Bashkimit Evropian edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Puna e BQK-së dhe bashkëpunimi i mirë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është reflektuar edhe në raportin për klimën e investimeve për vitin 2020 për Kosovën nga Departamenti Amerikan i Shtetit, ku është dhënë vlerësim i lartë për sistemin financiar të vendit.

Gjithashtu edhe Bashkimi Evropian ka njohur angazhimin dhe reformat e ndërmarra nga BQK-ja dhe të publikuara në Raportin për vendin nga Komisioni Evropian për vitin 2019.

Ndërkaq, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar veprimet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës sa i përket shtyrjes së pagesave për kthimin e kredive.

Në deklaratën përmbyllëse të Misionit Vlerësues për Artikullin IV, FMN-ja konstaton se vendimet e BQK-së për t'i shtyrë pagesat e kthimit të kredive dhe më pastaj vendimi për riprogramimin e kredive deri në 1 vit kanë zbutur ndikimin të huamarrësit dhe bankat.

Gjithashtu, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në funksion të rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve me drejtorin e përgjithshëm ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë.

Përmes këtij Memorandumi BQK-ja dhe AMF-ja kanë vendosur një sistem bashkëpunimi reciprok dhe shkëmbim të informacioneve në mes të palëve, bazuar në rëndësinë e zhvillimit të tregjeve financiare të të dyja vendeve, i cili do të shtrihet në tregjet e sigurimeve / risigurimeve, tregjet e kapitalit, aktivitete të tjera financiare jobankare.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ka zhvilluar takim virtual me presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC-International Court of Arbitration) dhe drejtoreshën e Komisionit të Arbitrazhit për Evropë. Në takimin virtual të zhvilluar, Guvernatori ka kërkuar mbështetjen e institucionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit lidhur me çështjen e Kartonit të Gjelbër, mundësinë e heqjes së pengesave për transport ndërkombëtar, ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve të Kosovës dhe përkrahjen e ekonomisë së Kosovës përmes OEK-së në ICC-së.

Një bashkëpunim i mirë i BQK-së ka qenë edhe me institucionet ndërkombëtare dhe ambasadat që veprojnë në Kosovë.

8.2. Komunikimi dhe Edukimi Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2020 ka vazhduar të punojë në ngritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimit të publikut për punën e saj dhe të realizojë aktivitetet e saj në kuadër të komunikimit, informimit dhe edukimit financiar.

Informimi i publikut përmes të gjitha kanaleve të komunikimit ka ndikuar që BQK, në vazhdimësi të jetë një ndër institucionet më transparente, në shpërndarjen e informatave rreth të arriturave dhe rezultateve të aktiviteteve në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësive të saj.

Në kuadër të Programit të Edukimit Financiar, BQK-ja ka vazhduar të realizojë aktivitete, të përgatitë materiale edukative e projekte të cilat kanë qenë të targetuara për të gjitha grupmoshat e publikut të gjerë, me qëllim të ndikimit në ngritjen e njohurive ekonomike e financiare të publiku i gjerë.

Me qëllim të pajisjes së nxënësve të shkollave fillore me koncepte bazike ekonomikofinanciare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi për të institucionalizuar përfshirjen e koleksionit prej 5 teksteve të edukimit financiar në kurrikulën shkollore. Përgatitja e këtyre Librave është përkrahur nga Departamenti për Zhvillim i Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE). Tekstet janë përgatitur nga ekspertë përkatës të fushës, në pajtueshmëri me kurrikulën bërthamë për arsimin fillor të Kosovës. Me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve tekstet u përgatiten në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe rome. Po ashtu u publikua edhe versioni i teksteve me zë.

Në kuadër të aktiviteteve tashmë tradicionale të edukimit financiar, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës shënoi Ditën Botërore të kursimeve përmes aktiviteteve virtuale, që kryesisht iu dedikuan nxënësve të shkollave fillore. Përmes një konkursi ftuam nxënësit e klasave VI-IX të shkollave fillore të Kosovës, të marrin pjesë në përzgjedhjen e Esesë më të mirë rreth kursimit dhe financave. Motoja e shënimit të kësaj dite ishte “Me kursime të vogla për qëllime të mëdha”.

Gjatë këtij viti BQK ka shtuar numrin e materialeve edukative të publikuara në platformën e edukimit financiar në të tri gjuhët. Disa nga këto materiale janë: Koleksioni i (5 libra) librave të edukimit financiar për klasat 1-5 të shkollës fillore, mbështetur nga Departamenti për Zhvillim i Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE); Librat në formatin me zë dhe me animacion (5 video) mbështetur nga EFSE; Video animacion “Përdorimi i kartelave bankare”; Fletëpalosje informuese “Me kursim të parave deri te realizimi i ëndrrave” mbështetur nga EFSE; Fletëpalosje informuese “Çka duhet të dimë para se të marrim kredi”, mbështetur nga EFSE; Fletëpalosje informuese “A udhëhiqni ju me paratë tuaja apo paratë udhëheqin me ju”, mbështetur nga EFSE; Broshurë informuese “Transferet ndërkombëtare të parave koncepte bazike”, mbështetur nga Banka Botërore; Broshurë informative “Shërbimet dhe produktet financiare”, mbështetur nga Banka Botërore; Broshurë “Financat për të rinjtë”; Libër me zë për fëmijë “Mësimi i ketrushave”; Libri me punimet fituese të konkursit “Kursimet për një të ardhme më të mirë”.

BQK-ja, gjithashtu vazhdoi me ndarjen e çmimit tradicional “Ekonomisti i Ri” me qëllim të nxitjes së hulumtimeve mes ekonomistëve të rinj të Kosovës. Këtë vit tema e cila duhej të shtjellohej nga punimet konkurruese, ishte “Ekonomia e Kosovës në kohë Pandemie, ndikimet e COVID-19 në ekonominë vendore dhe ndërkombëtare”.

Përkundër masave shtrënguese të ndërmarra në parandalimin e shpërndarjes së virusit, BQK gjatë vitit 2020 ka qenë e fokusuar në informimin e publikut në kohë reale, duke organizuar konferenca për mediat, pjesëmarrje në emisione dhe realizim të intervistave. Gjithashtu, ka vazhduar bashkëpunimi me Bank for International Settlements, në të cilën janë publikuar fjalimet e Guvernatorit. Po ashtu të gjitha fjalimet janë titruar dhe janë publikuar në kanal zyrtar të BQK-së në YouTube. Gjithashtu, me qëllim që të jemi sa më afër informimit, BQK-ja ka vazhduar me botimin e librit “Buletini i Aktiviteteve të BQK-së”, i cili përmban informacionet për të gjitha aktivitetet e zhvilluara brenda një viti. Ky libër për të tretin vit me radhë, botohet çdo gjashtë muaj.

Në kuadër të informimit, BQK-ja përmes: publikimit të materialeve të shumta, në faqen zyrtare të saj, facebook, youtube e platformës së edukimit ka informuar qytetarët në vazhdimësi. Komunikimi me publikun ka vazhduar përmes organizimit të konferencave për shtyp, publikimit të kumtesave, përgjigjeve në pyetjet e gazetarëve dhe qytetarëve, pjesëmarrjes në emisione dhe debate televizive e përfaqësime në radio, etj.

BQK publikon të gjitha zhvillimet rreth aktiviteteve të saj, rregullativës ligjore dhe masat e ndërmarrura në kuadër të mandatit të saj në faqen zyrtare të saj www.bqk-kos.org. Faqja zyrtare gjithashtu përmban publikime, raporte e të dhëna të azhurnuara në vazhdimësi mbi zhvillimet e sektorit financiar.

8.3. Asistenca teknike

BQK-ja ka vazhduar të ketë bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe me bankat qendrore dhe agjencitë rregullatore, si në nivel rajonal ashtu edhe në rrafshin e gjerë ndërkombëtar. Kryesisht gjatë vitit 2020, bashkëpunim në rrethana të reja konform pandemisë, janë realizuar me institucionet ndërkombëtare si: FMN, BB, BQE, Thesari Amerikan, BERZH, EFSE, SECO etj.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Në kuadër të përkrahjes së vazhdueshme nga FMN-ja, gjatë vitit 2020, BQK-ja ka pranuar asistencë teknike, për projektet e mëposhtme:

- Vlerësimin e masave mbrojtëse (Safeguard assesment), i cili vlerësim ka përfshirë fushat dhe funksionet e BQK-së, si: auditimin e jashtëm, auditimin e brendshëm, kornizën ligjore, raportimin financiar dhe kontrollin e brendshme.

- Rishikimin e politikës së investimeve të BQK-së, duke përdshirë: investimin në kohë krize, alokimin dhe diversifikimin e investimeve, vlerësimin e performancës së portofolit të BQK-së gjatë viteve të kaluara, vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe operacionale, vlerësimin e menaxhimit të rrezikut etj.
- Trajnimin për zbatimin e kërkesave të SNRF 9, e cila asistencë teknike ka pëfshirë fushat si në vijim: qeverisja e rrezikut kreditor dhe kornizat e kontrollit, vlerësimi i modeleve të rrezikut kreditor, vlerësimi i adekuatshmërisë së humbjeve të pritura kreditore etj.

Banka Botërore (BB)

Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes nga Banka Botërore edhe në vitin 2020 ka vazhduar mbështetja në projekte, si: programi i përbashkët i financuar në kuadër të programit të financuar nga SECO për Remitencat dhe Pagesat - RPP.

Ky program ka vazhduar me fokus në:

- Studimin lidhur me vlerësimin e kostos për pagesat me vlerë të vogël për ofruesit e shërbimeve të pagesave (BQK, bankat, IFJB-të për pagesa) dhe për përdoruesit e shërbimeve të pagesave (Institucionet qeveritare, bizneset, konsumatorët);
- Përgatitjen e draft-strategjisë kombëtare për pagesat me vlerë të vogël;
- Fuqizimin e kornizës së mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave.
- Projekti Greenback, për të cilin BQK-ja mbështetet nga Banka Botërore dhe Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO), ka për qëllim rritjen e efikasitetit të shfrytëzimit të remitancave përmes një qasje inovative dhe të ndikojë në ngritjen e informatave për emigrantët përmes aktiviteteve të edukimit financiar.

Programet e financuara nga BE-ja

Gjatë vitit 2019 BQK-ja përmes programeve të asistencës së donatorëve, Dukata e Madhe e Luksemburgut dhe Mbretëria e Norvegjisë, është bërë pjesë përfituese e projekteve që po mbështesin Qeverinë së Republikës së Kosovës për të përmbushur kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Kosovës. Për këtë qëllim, ata kanë ngritur një Mekanizëm për Zhvillimin e Kapaciteteve Njerëzore (HCDF) për të mbështetur zbatimin e MSA-së. Më këtë rast është nënshkruar letër zotimi edhe nga BQK-ja, e cila shërben si bazë ligjore për zbatimin e aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve nga të cilat do të përfitojë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) dhe agjencitë e tjera të caktuara, sipas Planeve Zbatuese relevante. Projekti financohet nga Qeveria e Luksemburgut 1.685 milion euro dhe ajo e Norvegjisë 1.466 milion euro, dhe që të dyja mbulojnë kapituj të ndryshëm të ACQUIS, derisa BQK-ja bën pjesë tek pjesa e financimit nga qeveria e Norvegjisë. Një numër i konsiderueshëm i trajnimeve që ishin parapare të mbahen gjatë vitit 2020, janë prolonguar të realizohen për vitin 2021 (për shkak të pandemisë), dhe pritet që në vitin 2021 të realizohen të gjitha trajnimet sipas planit të programit mbështetës.

Nga viti 2019, BQK-ja është palë e marrëveshjes me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore “Programme for Strengthening the Central Bank Capacities in the Western Balkans with a view to the integration to the European System of Central Banks” (Programi për Forcimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor me synim integrimin në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore), ku përfshihen trajnime të specializuara të stafit, punëtori profesionale të nivelit të lartë, programe praktikash të stafit, si dhe masa bilaterale të bashkëpunimit me banka qendrore të vendeve të BE-së. Programi i këtillë kishte vazhduar në

muajt e parë të vitit 2020, por për shkak të rrethanave të krijuara nga Covid-19, trajnimet, punëtoritë dhe praktikat e stafit janë pezulluar në muajin mars të vitit 2020, ndërsa masat bilaterale të bashkëpunimit janë proceduar online. Ky program bashkëpunimi, me ndryshimet eventuale të nevojshme në rrethanat e krijuara nga Covid-19, pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2021.

Po ashtu, BQK-ja gjatë këtij viti është përfshirë si pjesë e dy projekteve në kuadër të IPA fondeve në mesin e shumë institucioneve tjera, si Njësia për Inteligjencë Financiare, Policia e Kosovës, Ministria e Financave, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës etj. Këto Projekte janë:

- “Projekti Kundër Krimit Ekonomik (PECK II)”, i financuar nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkimit Evropian dhe
- Programme for Strengthening the Central Bank Capacities in the Western Balkans with a view to the integration to the European System of Central Banks (Bilateral measure between the Central Bank of the Republic of Kosovo and the Bulgarian National Bank).

EFSE & Finance & Motion

- Projekti i përgatitjes së setit të Librave – për të cilin BQK-ja u mbështet nga Zyra e Finance in Motion (EFSE) në Kosovë. Përmes këtij projekti është përgatitur seti prej 5 librave për nxënësit e shkollave fillore të Kosovës, në gjuhën shqipe, për klasën e I-rë deri në klasën e V-të. Projekti do të vazhdoj edhe në vitin 2021 ku do të finalizohet printimi dhe shpërndarja e librave në tërë Kosovën, edhe në gjuhët e komuniteteve tjera në Kosovë.
- Projekti për ndërtimin e platformës për krahasimin e normave të interesit - për të cilin BQK-ja u mbështet nga Zyra e Finance in Motion (EFSE) në Kosovë, është projekt i cili ka për qëllim të kontribuojë në transparencën e tregut të sektorit financiar në Kosovë rreth normave efektive të interesit dhe çmimit të produkteve dhe shërbimeve financiare në mënyrë që klientët e sektorit financiar të marrin vendime të informuara dhe të përgjegjshme në lidhje me përdorimin e produkteve dhe shërbimeve financiare.

8.4. Integrimet Evropiane

Me qëllim të realizimit të perspektivës së vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës edhe këtë vit ka vazhduar t’i përmbushë obligimet e saj në kuadër të procesit të integritimit evropian. Monitorimi i zhvillimeve kryesore legjislative dhe praktikave mbikëqyrëse, respektivisht harmonizimi i legjislacionit të BQK-së me ACQUIS, si dhe zhvillimet e fundit makroekonomike janë raportuar në vazhdimësi përmes dokumenteve raportuese, si dhe takimeve me palët vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e integritimit evropian në Kosovë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020 ka bashkëpunuar me institucionet relevante duke ofruar mbështetje të vazhdueshme, në avancimin e procesit të integritimit evropian në Republikën e Kosovës. Rol të rëndësishëm në këtë fushë ka bashkëpunimi me Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZKM), e cila është koordinatore kryesore e procesit të integritimit evropian në Republikën e Kosovës. BQK-ja gjithashtu ka pasur bashkëpunim edhe me ministri dhe institucione tjera që veprojnë në Kosovë, si: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Zyra e BE-së në Prishtinë. BQK-ja gjatë gjithë vitit 2020 ka vazhduar raportimet e rregullta me qëllim të realizimit të konkluzioneve në kuadër të strukturave të Stabilizim Asociimit. BQK-ja ka raportuar për takimin e Këshillit të Stabilizim Asociimit, duke raportuar inputet e kërkuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Këto inpute janë pjesë e qëndrimit zyrtar shtetëror (Position Paper), ku prezantohet progresi dhe të arriturat në fusha të caktuara (përfshirë sektorin financiar).

Gjatë vitit 2020, BQK-ja ka raportuar edhe në kuadër të Nënkomitetit për tregun e brendshëm dhe mbrojtje të konsumatorit, si dhe Nënkomitetin për ekonomi, çështje financiare dhe statistika.

Përpos strukturave të përbashkëta me Komisionin Evropian, BQK-ja ka raportuar në baza të rregullta edhe në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA). Në këtë kontekst, BQK-ja ka raportuar për kapitujt përbërës të PKZMSA-së, që kanë për qëllim zbatimin e reformave që kërkohen me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA): Kapitullin e lëvizjes së lirë të kapitalit si dhe kapitullin e shërbimeve financiare. Në kuadër të MSA-së, rrjedhin detyrimet për Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në fushën e shërbimeve financiare si:

- me të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve bankare;
- lirinë e ofrimit të shërbimeve të sigurimeve dhe shërbimeve tjera në fushën financiare; dhe
- përafrimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me legjislacionin e Bashkimit Evropian, statutin e Bankës Qendrore Evropiane dhe Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Kërkesat tjera nga MSA-ja përpos atyre të përmendura më sipër, tek lëvizja e lirë e kapitalit përfshinë:

- Rregullat për pagesa ndërkuftare dhe ekzekutimin e urdhërave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Detyrimet që rrjedhin në lidhje me çdo pagesë apo transfer në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave/kapitalit ndërmjet BE-së dhe Kosovës; dhe
- Lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me transaksionet tregtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së;

Tek kapitulli i shërbimeve financiare më specifiku janë të pëfshira çështjet si:

- Në fushën bankave dhe konglomerateve financiare - autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve kredituese, kërkesat në lidhje me llogaritjen e kapitalit të institucioneve kredituese dhe firmave investuese, standardet ndërkombëtare Bazel III;
- Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve të punës - direktivat evropiane që përcaktojnë rregulla lidhur me autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sigurimit të jetës dhe të jojetës si dhe risigurimin e ndërmarrjeve;
- Në fushën e tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve rreth investimeve - Direktiva 2004/39/KE mbi tregjet në instrumente financiare (MiFID).

Nga sfera e Integritimit Evropian në takimet me Komisionin Evropian, BQK-ja ka bërë raportime të rregullta lidhur me zhvillimet kryesore nga fushat e sipërpërmendura. Kapituj të tjerë në të cilët BQK-ja në vazhdimësi ka kontribuar janë:

- Kapitulli i të drejtës së themelimit të kompanive dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve,
- Kapitulli i politikave ekonomike dhe monetare, kapitulli i statistikave, kapitulli i lirisë, sigurisë dhe drejtësisë (neni 89 Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit), si dhe kapitullin e kontrollit financiar.

BQK-ja ka përgatitur Inputin për Raportin për Komisionin Evropian (KE) dhe në përputhje me afatet e parapara, janë ofruar inputet e kërkuara nga KE. Inputet janë formë uniforme e raportimit për të gjitha vendet candidate dhe candidate potenciale, të cilat mbulojnë zhvillime specifike gjatë gjithë vitit. Janë raportuar zhvillimet kryesore ligjore nëpërmjet pyetësorit të hartuar nga Komisioni Evropian për të gjitha fushat e kritereve politike dhe ato të ACQUIS-së.

BQK-ja është institucion përfitues në kuadër të programeve të asistencës së donatorëve nga Dukata e Madhe e Luksemburgut dhe Mbretëria e Norvegjisë, që po mbështetin përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve të saj për të përmbushur kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Kosovës. Për këtë qëllim është ngritur Mekanizimi për Zhvillimin e Kapaciteteve Njerëzore (HCDF) për ta mbështetur zbatimin e MSA-së. Në fund vitit 2020 është bërë edhe përgatitja e draftit të konsoliduar të PKZMSA-së, në të cilin draft, BQK-ja ka bërë një përmbledhje të legjislacionit primar dhe akteve sekondare, të cilat pritet të aprovohen gjatë vitit 2021.

Propozimet legjislative derivojnë nga kërkesat e takimeve me anëtarët e Komisionit Evropian, si dhe nga nevojat e identifikuara nga BQK. Bazuar në këtë, drafti i PKZMSA-së përmban legjislacion primar dhe sekondar që transponon direktiva apo që përmban sugjerime të caktuara nga Komisioni Evropian. BQK mbetet e përkushtuar në adresimin e të gjeturave nga Raporti për Vendin (ish raporti i progresit), si rezultat ka pasur një numër të konsiderueshëm të të gjeturave të Raportit të KE-së të vitit 2020, të cilat janë adresuar për t'u realizuar gjatë vitit 2021. Raportet për vendin të KE-së kanë vlerësuar kontributin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në drejtim të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik, ruajtjes së stabilitetit financiar, përmirësimit të praktikave mbikëqyrëse dhe të përmirësimit të sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës. BQK-ja edhe më tej mbetet e angazhuar në realizimin e reformave prioritare strukturore, që do t'i kontribuojnë edhe më shumë arritjes së standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian.

BQK vazhdon të ketë një rol të rëndësishëm duke kontribuar në realizimin e agjendës së Integritimeve Evropiane të Republikës së Kosovës

9. Pasqyrat Financiare

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
me Raportin e Auditorit të Pavarur

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1-2
Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	6
Shënime për pasqyrat financiare	7 - 48

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të BQK-së më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara në mënyrë më të detajuar në paragrafin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga BQK-ja në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne poashtu kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e BQK-së për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë BQK-në ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të BQK-së.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionimi mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të BQK-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që BQK-ja mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që BQK-ja të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,

6 maj 2021



Suzana Stavrik
Auditor ligjor

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e pozicionit financiar

Më 31 dhjetor 2020

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2020	2019
Pasuritë			
Paraja e gatshme	7	308,090	302,166
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	313,343	108,863
Letra me vlerë (bono thesari dhe obligacione qeveritare)	9	587,794	576,616
Depozita me bankat e huaja	10	58,324	248,864
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	268,199	298,345
Prona dhe pajisjet	12	4,888	4,967
Pasuritë e paprekshme	13	1,700	1,945
Pasuritë tjera	14	1,883	1,700
Gjithsej pasuritë		1,544,221	1,543,466
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave komerciale në vend	15	566,426	414,942
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	269,138	297,236
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	508,446	719,819
Detyrime ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	138,661	52,167
Huamarrja/et	19	2,154	2,266
Detyrime të tjera	20	2,539	1,778
Gjithsej detyrimet		1,487,364	1,488,208
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	21	30,000	30,000
Fondi i rezervave	21a	23,903	22,622
Rezerva nga rivlerësimi	21a, 29	792	527
Fitimet e mbajtura		2,162	2,109
Gjithsej kapitali dhe rezervat		56,857	55,258
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		1,544,221	1,543,466

Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe lëshuar nga Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 5 maj 2021 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga¹:



Fehmi Mehmeti

Guvernator



Faton Ahmetaj

Drejtor për Planifikim dhe Raportim Financiar

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

¹ Duke ju referuar Ligjit për BQK nr. 03/L209, aprovimi i Pasqyrave Financiare sipas nenit 59, paragrafi 2.1 të ligjit në fjalë është në proces dhe do të realizohet pas plotësimit të kuorumit për vendimmarrje në Bord të BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Më 31 dhjetor 2020

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2020	2019
Të ardhurat nga interesi			
Të ardhurat nga interesi		3,829	3,529
Shpenzimet nga interesi		(965)	(1,599)
Të ardhurat neto nga interesi	22	2,864	1,930
Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat			
Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat		2,719	2,798
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(387)	(576)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe ndalesat	23	2,332	2,222
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ dhe të ardhurat tjera operative			
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ	24	5,382	4,956
Të ardhurat nga grantet	20, 25	119	120
Të ardhurat tjera operative	26	11	8
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit	29	(663)	248
Të hyrat operative		10,045	9,484
Shpenzimet administrative (operative)			
Shpenzimet personelit	27	(4,833)	(4,989)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(1,040)	(1,041)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	28	(1,346)	(1,451)
Shpenzimet administrative (operative)		(7,219)	(7,481)
Rezultati financiar para pritjeve për humbjet kreditore		2,826	2,003
Provizioni për humbjet e pritura kreditore (neto rritja/(zvogëlimi)	4	(664)	106
Fitimi / (Humbja) vjetore		2,162	2,109
Të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin		2,162	2,109

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
<i>Në mijë Euro</i>					
Gjendja më 1 janar 2019	30,000	21,215	-	1,934	53,149
Transferimi në fondet rezervë	-	1,407	527	(1,934)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	1,407	527	(1,934)	-
Fitimi për vitin	-	-	-	2,109	2,109
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	2,109	2,109
Gjendja më 31 dhjetor 2019	30,000	22,622	527	2,109	55,258
Gjendja më 1 janar 2020 (ashtu siç është paraqitur)	30,000	22,622	527	2,109	55,258
Rregullimi për përfitimet afatgjata të punonjëseve dhe rivlersimi valutor si fitim (EUR/SDR) për huazimin nga Banka Botërore	-	(580)	17	-	(563)
Gjendja më 1 janar 2020 (riparaqitur)	30,000	22,042	544	2,109	54,695
Transferimi në fondin rezervë	-	1,861	248	(2,109)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	1,861	248	(2,109)	-
Fitimi për vitin	-	-	-	2,162	2,162
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	2,162	2,162
Gjendja më 31 dhjetor 2020	30,000	23,903	792	2,162	56,857

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2020	2019
Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi vjetor		2,162	2,109
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin	12	628	645
Amortizimin	13	412	396
Të ardhurat nga grantet	25	(119)	(120)
Provizionet për humbjet e pritshme kreditore		664	(106)
Të ardhurat nga interesi	22	(3,829)	(3,529)
Shpenzimet nga interesi	22	965	1,599
		883	994
Ndryshime në bono thesari		(11,435)	180,657
Ndryshime në depozita me bankat e huaja		190,000	(65,000)
Ndryshime në pasuritë e ndërlidhura me FMN-në		29,854	27,520
Ndryshime në pasuritë tjera		(184)	(289)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave komerciale		151,484	71,548
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura		(27,800)	(24,434)
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		(211,373)	(43,082)
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve publike		86,495	(58,696)
Rritja/(rënia) nga huazimet		(95)	-
Ndryshime në detyrimet e tjera		279	80
		208,108	89,298
Interesa të marra		3,932	4,814
Interesa të paguara		(1,263)	(1,783)
Paraja neto e gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet operacionale		210,777	92,329
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve	12	(549)	(596)
Blerja e aseteve të paprekshme	13	(167)	(551)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(716)	(1,147)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Të hyrat nga grantet		20	21
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		20	21
Rritja/(zbritja) neto në para dhe ekuivalentet e saj		210,081	91,202
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		420,109	328,907
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	30	630,190	420,109

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK" ose "Banka Qendrore"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Banka vepron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 "Ligji mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" të cilit tash e tutje i referohemi si ("Ligji për BQK-në"). Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë dhe të mbajë një sistem të qëndrueshëm financiar, duke përfshirë një sistem të sigurt, të shëndetshëm dhe efikas të pagesave.
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve.
- të mbështes politikatat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK vepron nga zyrat e saj që gjenden në Prishtinë. Adresa e regjistruar e zyrës së BQK-së është si më poshtë:

Rr. Garibaldi nr. 33

Prishtinë, Kosovë.

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas nenit 34, paragrafit 2, si dhe dispozitës së përkohshme të nenit 79, paragraf 2, të Ligjit për BQK-në, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga Guvernatori, dhe katër² anëtar jo-ekzekutiv dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2020, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Flamur Mrasori – Kryetar i Bordit (jo-ekzekutiv)
- Fehmi Mehmeti – Guvernator

Ndërsa, me 31 dhjetor 2019, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Flamur Mrasori – Kryetar i Bordit (jo ekzekutivë)
- Fehmi Mehmeti – Guvernator
- Behxhet Brajshori – Anëtar (jo ekzekutivë)
- Nuhi Ahmeti – Anëtar (jo ekzekutivë)

Në qershor të vitit 2020, dy prej anëtareve të Bordit të BQK-së ju ka skaduar mandati dhe BQK është në proces të plotësimit të vendeve të lira të krijuara pas kësaj.

Bordi Ekzekutiv me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhet nga Guvernatori, i cili është Kryesues dhe dy Zëvendësguvernatorët dhe është përgjegjës për implementimin e politikave të BQK-së dhe të operacioneve të saj. Nuk ka pasur lëvizje funksioneve dhe zyrtareve që përbejnë Bordin Ekzekutiv gjatë vitit 2020 dhe në vitin 2019.

² Më 31 dhjetor 2020 janë të lira pozitat për tre anëtarë jo-ekzekutivë

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF-ja për secilin lloj të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë shpalosur më në detaje në politikat kontabël në shënimin 3 më poshtë.

c) Valuta funksionale dhe e prezentimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro (“EUR”), e cila është valuta funksionale e BQK-së, përveq nëse është specifikuar ndryshe në ndonjë shënim analitik. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është rrumbullakësuar në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informatat në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe vendimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të konsiderueshëm në shumat e pranuar në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë në shënimin 5.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezentuara në këto pasqyra financiare.

3. Politikat e rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj vlerësohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së transaksioneve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga valutat e huaja për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë rivlerësohen në monedhë funksionale në kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar ajo vlerë e drejtë. Diferencat nga valutat e huaja që rrjedhin nga rivlerësimi njihen si fitim ose humbje.

b) Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen si fitim apo humbje bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pasurisë ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të pasurisë ose detyrimit financiar. Norma e interesit efektiv përcaktohet në njohjen fillestare të pasurisë ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

b) Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi (vahdim)

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo kostot e transaksioneve të pranuar dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejtë për blerjen, emetimin apo largimin e një pasurie apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje apo fitim përfshijnë interesat nga pasuritë ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

c) Tarifa dhe komisione

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një mjet apo detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të hyrat tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, tarifat e transferimit të fondeve dhe të licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to. Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

d) Përfitimet e punonjësve

BQK aplikon kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, që përcaktohen si kontributet pensionale të punonjësve kur ata dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve të kontributit të përcaktuara, bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së ngarkohen si shpenzim në të ardhura në momentin kur ato ndodhin.

Po ashtu BQK ndan përfitime të punonjësve në baza jubilarë dhe në formë të shumës së paracaktuar në momentin e pensionimit. BQK njih këto shpenzime sipas ndodhjes së këtyre ngjarjeve sipas planeve për përfitime afatgjata.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e liruar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010. Shih shënimin 4 (f) se si BQK-ja alokon fitimin e saj.

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare

Klasifikimi i pasurive dhe detyrimeve financiare

BQK ka aplikuar SNRF 9 Instrumentet Financiare (të rishikuar në korrik 2014) dhe ndryshimet pasuese të lidhura me Standardet e tjera të SNRF-ve që janë efektive për një periudhë vjetore që fillon më ose pas 1 janarit 2018.

Për më tepër, BQK-ja miratoi ndryshime pasuese në SNRF 7 Instrumentet Financiare: Shpалosjet që u aplikuan tek shpалosjet për vitin 2020 dhe për periudhën krahasuese.

BQK vazhdon të aplikoj kërkesat nga SNRF 9 për:

- 1) Klasifikimi dhe matja e pasurive dhe detyrimeve financiare,
- 2) Zhvlerësimi i pasurive financiare, dhe
- 3) Kontabiliteti i përgjithshëm mbrojtës.

Analitika e tyre si dhe ndikimi i tyre në pasqyrat financiare të BQK-së përshkruhen dhe shpalosen më poshtë.

(a) Klasifikimi dhe matja e pasurive dhe detyrimeve financiare

Data e aplikimit fillestar (d.m.th. data në të cilën BQK-ja ka vlerësuar pasuritë dhe detyrimet financiare të saj ekzistuese për sa i përket kërkesave të SNRF 9) është 1 janari 2018. Prandaj, BQK-ja ka aplikuar kërkesat e SNRF 9 në instrumentet që vazhdojnë të njihen që nga 1 janari 2018 dhe nuk ka zbatuar kërkesat për instrumentet që tashmë janë ç'regjistruar që nga 1 janari 2018.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Pasuritë financiare të BQK-së të përfshira në këto pasqyra financiare klasifikohen si instrumente financiare me kosto të amortizuar (modeli mbaj për të mbledhur flukset monetare kontraktuale) në përbërjen e parasë dhe ekuivalentët e saj, letrat me vlerë, llogaritë e depozitave në bankat jorezidente, asetet e lidhura me FMN dhe pasuritë tjera.

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDFH (Vlera e drejtë përmes Humbjes së Fitimit):

- pasuria mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe

- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të specifikuar tek flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI) mbi shumën e mbetur të papaguar.

BQK-ja klasifikon të gjitha detyrimet e saj financiare të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të ardhurat nga interesi ose shpenzimet e interesit nga detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar, njihen në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare të matura me kosto të amortizuar përfshijnë detyrimet ndaj bankave vendase, institucioneve qeveritare, subjekteve publike dhe tregtare, për shkak të FMN-së, huazimeve dhe detyrimeve të tjera financiare.

i. Njohja

Në njohjen fillestare, një pasuri financiare klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar (KA), vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDAGJ) ose vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Pasuria financiare apo detyrimi financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për zë jo me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

Siç u përmend më lartë, BQK-ja ka në librat e saj vetëm instrumente financiare me kosto të amortizuar, të cilat plotësojnë kriteret e modelit të mbajtjes për të mbledhur flukset monetare kontraktuale.

ii. Riklasifikimi

Pasuritë financiare të bankës varësisht nga rrethanat respektivisht ndryshimi i modelit të saj te biznesit për administrimin e pasurive financiare mund të ri klasifikoj këto të fundit edhe pas njohjes fillestare të tyre.

Në qoftë se banka ri klasifikon një pasuri financiare apo grup të pasurive financiare nga kategoria e matjes me koston e amortizuar tek kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë e tyre do të matet në datën e ri klasifikimit. Çdo fitim ose humbje neto që rrjedh nga një diferencë midis koston së amortizuar dhe vlerës së drejtë të aktivitetit financiar njihet në fitim ose humbje.

iii. Ç'regjistrimi

BQK-ja ç'regjiston një pasuri financiare kur skadojnë të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin në thelb janë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare. transferuar ose në të cilat BQK as nuk transferon dhe as mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e asetit financiar.

Për ç'regjistrimin e një pasurie financiare, diferencën midis vlerës kontabël të pasurisë (ose vlerës së mbartur të alokuar për pjesën e pasurisë së ç'regjistruar) dhe shumës së (i) vlerësimit të marrë (përfshirë çdo pasuri të re të marrë më pak çdo detyrim të ri supozuar) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që ishte njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ('OCI') njihet në fitim ose humbje. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që është krijuar ose mbajtur nga BQK-ja njihet si pasuri ose detyrim i veçantë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

BQK-ja hyn në transaksione me të cilat transferon asete të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurive të transferuara ose një pjesë të tyre. Në raste të tilla, pasuritë e transferuara nuk ç'regjistrohen. Shembuj të transaksioneve të tilla janë kreditimi i letrave me vlerë dhe transaksionet e shitjes dhe të riblerjes.

Në transaksionet në të cilat BQK as nuk mban dhe as transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një pasurie financiare dhe ai mban kontrollin mbi pasurinë, BQK vazhdon të njohë pasurinë në masën e përfshirjes së tij të vazhdueshme, të përcaktuar në masën tek e cila është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

BQK-ja ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale përfundohen ose anulohen, ose skadojnë.

iv. *Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimeve financiare*

Nëse kushtet e një pasurie financiare janë modifikuar, BQK vlerëson nëse flukset monetare të pasurisë së modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Nëse flukset e parave janë në thelb të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga pasuria financiare origjinale konsiderohen të kenë skaduar. Në këtë rast, pasuria fillestare financiare ç'regjistrohet (shiko (iii)) dhe një pasur e re financiare njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset e parave të pasurisë së modifikuar të mbartura me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim të pasurisë financiare. Në këtë rast, BQK-ja rillogarit vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe njeh shumën që lind nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje e modifikimit në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ai paraqitet si të ardhura nga interesi.

BQK-ja ç'regjistron një detyrim financiar kur kushtet e saj modifikohen dhe flukset e parave të detyrimit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast, një detyrim i ri financiar bazuar në kushtet e modifikuara njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar të shuar dhe detyrimit të ri financiar me termat e modifikuar njihet në fitim ose humbje. Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si ç'regjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke zbritur flukset e modifikuara të parasë me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

v. *Netimi*

Mjetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

vi. *Matja e kostos së amortizuar*

Kostoja e amortizuar e një mjeti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën mjeti ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim) f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

vii. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë (reale) është çmimi që do të merret për të shitur një pasuri apo që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë e një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përfaqësojnë transaksionet që ndodhin aktualisht dhe rregullisht në treg në bazë të vullnetshme midis palëve.

Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të midis palëve të mirë informuara dhe në formë të vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e zbritjes së rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i merrnin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranura ekonomike për vendosjen e çmimit të instrumenteve financiare. Të dhënat për teknikat vlerësuese paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritjet e tregut dhe masat e faktorëve të riskut që ekzistojnë në instrumentin financiar. BQK-ja kalibron teknikat vlerësuese dhe i teston ato për vlefshmërinë duke shfrytëzuar çmimet nga transaksionet aktuale të dallueshme të tregut në të njëjtin instrument apo në bazë të të dhënave tjera të dallueshme dhe të disponueshme në treg.

viii. Lejimet e humbjeve

BQK njeh lejimet e humbjeve për humbjet e pritura të kredisë "HPK" për pasuritë financiare që maten sipas koston se amortizuar dhe nuk maten në VDFH. BQK-ja mat lejimet e humbjes në një shumë të barabartë me HPK të jetës, përveç rasteve të mëposhtme për të cilat ato maten si HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë të investimeve të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët kredie në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

BQK e konsideron një garanci të borxhit si një rrezik të ulët kredie kur rreziku i saj i kredisë është ekuivalent me përkufizimin e kuptuar globalisht të "shkallës së investimeve". HPK 12-mujore është pjesa e HPK që rezulton nga ngjarje të paracaktuar në një instrument financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet një HPK 12-mujore, quhen "Faza 1 e instrumenteve financiare".

HPK përgjatë gjithë jetës së instrumentit financiar janë HPK që vijnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të paracaktuar gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet një HPK gjatë gjithë jetës, por që nuk janë të efektuar (dëmtuara) nga humbjet kreditore, klasifikohen të "Faza 2 e instrumenteve financiare".

Matja e (HPK-së)

Modeli i zhvlerësimit të HPK-së është një matje e bazuar në probabilitet dhe përfshin ndikimin e rezultateve të ndryshme të mundshme. Operacionalisht, kjo mund të jetë e vështirë për tu zbatuar dhe zgjedhja e skenarëve përkatës ekonomik mund të jetë sfiduese.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

Për implemetimin e hollësishëm të HPK-së kemi përdorur metodën e thjeshtë që utilizon mundësinë e parashikimit të qasjes së humbjes e cila është:

Humbjet e pritura të kredisë (HPK) = Vlera a ekspozuar (VE) x Humbja e pritur (HP)

x Probabiliteti i humbjes së pritur (PHP).

VE – Vlera e ekspozuar, është vlera kontabël bruto e pasurive financiare që bien në model për tu rivlerësuar.

HP - Humbja e pritur, ne jemi bazuar në gjykimin tonë të brendshëm dhe pritshmëria se nga vlera e ekspozuar mund të mos kthehet edhe nëse ndodh humbja, gjithashtu jemi mbeshtetur në disa qasje ndaj rrezikut sipas përcaktimeve të Bazelit për vlerësimin e huamarrësve që dështojnë të mbyllin obligimet.

PHP - Probabiliteti i humbjes së pritur, është variabla më e ndjeshme dhe paraqet gjasën e mos pagesës nga pala e tjetër për një periudhë të observuar (12 mujore apo gjate gjithë jetës së instrumentit).

Modeli humbjeve të pritura (HPK) është një vlerësim i ponderuar i humbjeve të kredisë dhe vlerësohen si më poshtë:

- pasuritë financiare që janë korigjuar në vlerë në datën e raportimit: si vlera aktuale e të gjitha pritjeve me pak të parasë së gatshme (d.m.th. ndryshimi midis rrjedhës së parave të gatshme ndaj BQK-së, në përputhje me kontratën dhe rrjedha e parave që BQK-ja pret të marrë);
- pasuritë financiare që janë vlerësuar sipas humbjeve kreditore të pritura në datën e raportimit: si ndryshim midis vlerës së tyre bruto dhe pritjes së humbjes kreditore për të njëjtat.

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat gatshme, depozita me bankat dhe pasuri financiare me rrjedhje të madhe me maturitet origjinal për më pak se tre muaj, të cilat janë objekt i një risku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga BQK-ja në menaxhimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiare me kosto të amortizuar.

h) Letrat me vlerë të investimeve

Letrat me vlerë të investimeve, të përbëra nga bonot e thesarit dhe obligacionet, fillimisht maten me vlerën e drejtë plus shtesat për kostot e transaksionit direkt dhe më pas maten sipas koston se amortizuar (mbajtja e pasurive me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale) duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të gjitha blerjet dhe shitjet e letrave me vlerë të investimeve njihen në datën e shlyerjes, d.m.th. data kur pasuria është marrë, ose dorëzuar tek pala tjetër.

Kostoja e amortizuar/ mbajtja e pasurive me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale janë investime në pasuri jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturim fiks që BQK ka qëllimet pozitive dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë të caktuara në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. .

i) Depozitat dhe huamarrjet

Depozitat dhe huazimet fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit direkt shtesë, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

j) Prona dhe pajisjet

i. Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e mjetit. Kosto e mjeteve të ndërtuara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejtë, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e mjetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesor) të pronës dhe pajisjes.

ii. Kosto pasuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të pronës ose pajisjeve njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij mjete të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të përditshëm të pronës dhe pajisjes (pasurive afatgjata materiale) njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

	2020	2019
Investimet në objekte me qira	20 vite	20 vite
Pajisje	5 vite	5 vite
Kompjuterë	3 vite	3 vite
Automjete	5 vite	5 vite

Jetëgjatësia e pajisjeve tjera vlerësohet rast pas rasti. Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

k) Asetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë, nëse ka.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij asemi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike bazohet në vlerësimin për shfrytëzimin e atij programi pa qenë nevoja për ndonjë përmirësim të madh, aktualisht nga 3 deri në 10 vite.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

l) Rënia në vlerë e pasurive jo-financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për ndryshim në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aseti/pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i asetëve që gjeneron rrjedhë të parasë që janë të pavarura nga mjetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësive gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis asetëve të tjera të njësisë (grupi të njësive) në baza proporcionale. Vlera e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë. Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më.

Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

m) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

n) Të ardhurat nga grantet

Grandet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grandin. Grandet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grandet që BQK-ja përfiton për koston e një aseti njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të asetit.

o) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtar të caktuar dhe financiar për një afat të shkurtër nga organizatat ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtar. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në këto pasqyrat financiare.

p) Provizionet

Provizioni njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e zbritur rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, riskun specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga BQK-ja nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis koston së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e asetit të lidhur me atë kontratë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

q) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël

(i) Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që kanë hyre në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Përcaktimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e pasurive që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe),
- **Ndryshimet në SNRF 7, 9 dhe SNK 39** – Reforma e Vlerësimit të Interesit (efektiv për periudhat vjetore që kanë filluar më ose pas 1 janarit 2020),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),
- **Ndryshimet në Referencat në Kornizën Konceptuale në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"** - Koncesionet e Qirave që lidhen me Covid-19 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Qershorit 2020 por aplikimi i mëparshëm është i lejuar, duke përfshirë edhe në pasqyrat financiare që nuk janë autorizuar ende për tu lëshuar në 28 maj 2020 (ndryshimi është gjithashtu në dispozicion për raportet e ndërmjetme).

Aplikimi i këtyre standardeve, ndryshimeve dhe interpretimeve nuk ka pasur ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të BQK-së Qendrore në periudhën raportuese.

ii) Standardet dhe interpretimet nuk kanë datë efektive në periudhën e raportimit

Sikurse në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, rishikimet dhe interpretimet janë botuar nga BSNK, por ende nuk janë efektive për periudhën e raportimit dhe si të tilla nuk janë aplikuar akoma nga Banka Qendrore:

- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose Kontributi i Pasurive midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri në metoda e kapitalit është përfunduar),
- **Cikli i përmirësimeve vjetore të SNRF-ve 2018-2020** i cili është një përmbledhje e ndryshimeve në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41 (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022),
- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNK 1 – "Prezentimi i Pasqyrave Financiare"** - Klasifikimi i detyrimeve si detyrime afat-shkurta ose detyrime afat-gjata (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023)
- **Ndryshimet në SNK 37 – "Provizionet, Pasuritë dhe Detyrimet Kontigjente"** - Kontratat e mëdha Kostoja e përmbushjes së një kontrate (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022),
- **Ndryshimet në SNK 16 – "Prona, Impiantët dhe Paisjet"** -Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

Banka Qendrore ka zgjedhur të mos aplikoj këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Banka Qendrore parashikon që aplikimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës Qendrore.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

a) Hyrje dhe vështrim

BQK është ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku operacional
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme, objektivave, politikave dhe procedurave të BQK-së për matjen dhe menaxhimin e riskut si dhe administrimi i kapitalit nga BQK-ja. Shënime të tjera sasiore dhe cilësore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Struktura e menaxhimit të rrezikut

Krijimi dhe mbikëqyrja e administrimit të rrezikut të BQK-së është përgjegjësi e Bordit të Bankës Qendrore. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht nëpërmjet Bordit Ekzekutiv të BQK-së tek Bordi i Bankës mbi praktikën e administrimit të rrezikut. Bordi Ekzekutiv, Komiteti i Investimeve dhe Departamenti për menaxhimin e rrezikut e kanë për detyrë të bëjnë hartimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika zbatohen më pas nga njësitë përkatëse organizative.

Politikat e administrimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet BQK-ja, si dhe të vendos kufizime dhe kontroll të duhur për rreziqe, dhe të monitoroj rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e ofruara të tregut. BQK-ja, me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, synon të zhvilloj një mjedis kontrolli efektiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të BQK-së është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e pajtueshmërisë me politikën dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet që përballet BQK-ja. Komiteti i Auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmer auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe ad-hoc, rezultatet e të cilave raportohen përmes Shefit të Auditimit të Brendshëm tek Komiteti i Auditimit.

b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj, dhe mund të rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera. BQK për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut të kredisë, BQK-ja konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (siç është rreziku i detyrueshëm i detyrimeve individuale, rreziku i vendit dhe sektorit).

Menaxhimi i rrezikut kreditor

i. Investimet dhe ekspozimi ndaj riskut kreditor në BQK

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra të lëshuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të cilave i janë vlerësuar në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur parasysh vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

Menaxhimi i rrezikut kryhet përmes:

- Kufizimi i fushëveprimit dhe kohëzgjatjes së instrumenteve financiare,
- Kufizimi i emetuesve të palëve, me vlerësim të pranueshëm kredie në klasën investente dhe më lartë,
- Kufizimi dhe sasia maksimale dhe përqendrimi me palët

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim) Menaxhimi i rrezikut kreditor (vazhdim)

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi më i lartë ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2020, paraqitet nga vlera e bartur e llogarive rrjedhëse me bankat jo-rezidente, e bonove të thesarit dhe depozitave me bankat jo-rezidente. Për detaje mbi ekspozimin referohuni edhe te shënimet 8, 9 dhe 10.

Vlerësimi kreditor për instrumentet financiare që BQK ka ekspozim për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2020 është prej AAA deri BBB+/ Aaa deri A3.

Vlerat bartëse të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor të ndara sipas llojit dhe të shprehura edhe pjesmarrja në përqindje me gjithsej, janë si më poshtë :

2020						
Rangimi kreditor (S&P/Moody's)	Llogaritë nostro	Depozitat me bankat e huaja	Letrat me vlere	Llogaritë e ndërlidhura me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i fondeve)	Gjithsej vlere bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa	128,168	8,394	105,714	-	242,276	21.42%
AA+/Aa1	86,666	-	147,567	-	234,233	20.71%
AA/Aa2	-	-	10,017	-	10,017	0.89%
AA-/Aa3	-	-	-	-	-	0.00%
A+/A1	460	-	-	-	460	0.04%
A/A2	-	-	103,282	-	103,282	9.13%
BBB+/A3	98,412	50,000	222,180	-	370,592	32.76%
N/A (pa vlerësim - IFN ³)	-	-	-	58,761	58,761	5.19%
N/A (pa vlerësim) ⁴	-	-	-	111,652	111,652	9.87%
Gjithsej	313,706	58,394	588,760	170,413	1,131,273	100.00%

2019						
Rangimi kreditor (S&P/Moody's)	Llogaritë nostro	Depozitat me bankat e huaja	Letrat me vlere	Llogaritë e ndërlidhura me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i fondeve)	Gjithsej vlere bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa	248	9,080	79,207	-	88,535	7.83%
AA+/Aa1	-	-	88,978	-	88,978	7.86%
AA/Aa2	1,827	-	99,335	-	101,162	8.94%
AA-/Aa3	-	-	125,770	-	125,770	11.12%
A+/A1	-	-	-	-	-	0.00%
A/A2	-	-	-	-	-	0.00%
BBB+/A3	106,788	240,000	183,845	-	530,633	46.90%
N/A (pa vlerësim (IFN))	-	-	-	63,651	63,651	5.63%
N/A (pa vlerësim)	-	-	-	132,610	132,610	11.72%
Gjithsej	108,863	249,080	577,135	196,261	1,131,339	100.00%

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është në vonesë. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditor.

Pasuritë financiare që bien nën objektin e humbjes së pritshme të kredisë me BQK janë:

- Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankat e huaja

- Letrat me vlerë,

- Të arkëtueshmet tjera që lidhen me mbi dy elemente, nëse ka.

Kriteret themelore të përcaktimit të ekspozimit janë vlerësimi kreditor. Vlerësimi kreditor merret nga agjensitë për vlerësim kreditor. Klasifikimi kreditor minimal i lejuar për investim në afat të shkurtër është P-2 (Moody's ose A-2 Standard & Poor's, ndërsa në afat të gjatë është Baa2 (Moody's) ose BBB (Standard & Poor's). Sa i përket kësaj, ne nuk investojmë nën atë klasë.

³ IFN – Institucione financiare ndërkombetare.

⁴ Nuk ekziston ndonjë vlerësim kreditor (as i jashtëm as i brendshëm), për pasuritë në fjalë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim) Menaxhimi i rrezikut kreditor (vazhdim)

Modeli i dëmtimit të pasurive financiare në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut kreditor respektivisht ndryshimeve në rrezik kreditor që nga njohja fillestare të pasurive financiare përcakton tre faza në modelin e vlerësimit të humbjeve të pritshme kreditore. Këto faza mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Faza 1 (Performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - pasuritë financiare të cilat trajtohen si ekspozim i rrezikut të ulët ose të mesëm, të gjitha ato që përfshihen në këtë, ndahen në fazën 1 në njohjen fillestare. Bazuar në procedurat tona të brendshme, nuk na lejohet të investojmë në ekspozimin e rrezikut më të lartë të kredisë. Bazuar në këtë, çdo investim në njohjen fillestare i alokohet Fazës 1 të ekspozimit.
2. Faza 2 (Nën performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - nëse kemi një rritje të konsiderueshme që nga njohja fillestare, pasuria financiare e cila ndodhet në shkallën 1, transferohet në fazën 2.
3. Faza 3 (Jo performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - transferimi në fazën 3 bëhet vetëm atëherë kur ka evidenca objektive që klienti do të dështon në përmbushje të obligimeve.

Vlerësimi bëhet në njohjen fillesate dhe në datën e periudhës së raportimit. Banka në fazë 1 do të masë provizionin për humbjen e atij instrumenti financiar HPK në atë shumë të barabartë me humbjen e pritshme kreditore për 12-muaj. Nëse kemi një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare, instrumenti financiar do të transferohet në fazën 2 (nën performuese). Banka në fazën 2 do të masë provizionin për humbjen e atij instrumenti financiar HPK në atë shumë të barabartë me humbjen e pritshme kreditore për përgjatë gjithë jetës së tij.

Kriteret e dështimit të përmbushjes së obligimeve respektivisht për transferim në fazë 3, duhet të bazohen në provat objektive si mëposhtë:

- Debitorëve, kanë vështirësi të konsiderueshme financiare,
- Kur është fjala për shkelje të detyrimeve kontraktuale, në lidhje me kryegjënë dhe interesin,
- Kur të ndodhë me ndonjë ristrukturim të kushteve ekzistuese të përmbushjeve të detyrimit nga një instrument financiar,
- Dëshmim/probabilitet i qartë që debitori po kalon në falimentim dhe/ose likudim,
- Shenjat e të qenit jo aktiv në tregtim (në tregjet financiare).

Tabela e mëposhtme paraqiten vlerat e ekspozimit në nivel të fazave. Në datën e raportimit nuk kemi ndonjë ndryshim material në rrezik kreditor që nga njohja fillestare prandaj të gjitha pasuritë financiare janë në fazën 1.

	2020			2019		
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Depozitat me banka jo-vendore	313,706	-	-	108,863	-	-
Letrat me vlerë	588,760	-	-	577,135	-	-
Llogaritë depozituese me bankat	58,394	-	-	249,080	-	-
Vlera bartëse bruto	960,860	-	-	935,078	-	-
Vlera korigjuese sipas HPK	(1,399)	-	-	(735)	-	-
Neto vlera bartëse	959,461	-	-	934,343	-	-

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim) Menaxhimi i rrezikut kreditor (vazhdim)

Lëvizjet e HPK përkatëse për instrumentet financiare që BQK ka ekspozim janë si më poshtë:

	2020			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2020	735	-	-	735
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK ngarkesa për vitin	664	-	-	664
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç' regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	1,399	-	-	1,399

	2019			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2019	841	-	-	841
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK ngarkesa për vitin	(106)	-	-	(106)
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç' regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	735	-	-	735

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja të ketë vështirësi në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve nga detyrimet e saj financiare.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jete e mundur, që vazhdimisht të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi Ekzekutiv i Bankës. BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jo-rezidente dhe duke mbajtur shuma të mjaftueshme të mjeteve monetare në kasafortat e saj. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të keqësura BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj. Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testimet rregullta të likuiditetit kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit iu nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet mujore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i paraqiten rregullisht anëtarëve të Komitetit të Investimeve nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Maturiteti i mbetur kontraktual për detyrimet financiare, më përjashtim të pagesave të ardhshme të interesit:

31 dhjetor 2020	Shënim	Neto Vlera e bartur	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vjet deri në 5 vite	mbi 5 vite
<i>Pasuritë jo-derivative</i>							
Paraja e Gatshme		308,090	308,090	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat Jo-rezidente	8	313,343	313,343	-	-	-	-
Letrat me vlerë	9	587,794	15,690	4,021	49,613	518,470	-
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	10	58,324	8,388	-	49,936	-	-
Llogarit ne FMN	11	187,828	80,335	11,720	35,160	60,613	-
		1,455,379	725,846	15,741	134,709	579,083	-
<i>Detyrimet jo-derivative</i>							
Ndaj bankave komerciale në vend	15	(566,426)	(566,426)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	(195,113)	(4,415)	(11,720)	(35,160)	(60,613)	(83,205)
Ndaj institucioneve qeveritare	17	(508,446)	(508,446)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	(138,661)	(138,661)	-	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	(2,154)	-	-	-	(1,077)	(1,077)
Detyrime tjera vendore	20	(756)	(756)	-	-	-	-
		(1,411,556)	(1,218,704)	(11,720)	(35,160)	(61,690)	(84,282)
		43,823	(492,858)	4,021	99,549	517,393	(84,282)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c. Rreziku i likuiditetit

31 dhjetor 2019		Neto vlera e	Më pak se 1	1 deri ne	3 muaj	1-5	mbi
	Shënim	bartur	muaj	3 muaj	deri ne një vit	vite	5 vite
<i>Pasuritë jo-derivative</i>							
Paraja e Gatshme		302,166	302,166	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat Jo-rezidente	8	108,863	108,863	-	-	-	-
Letrat me vlerë	9	576,616	-	100	150	486,309	90,057
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	10	248,864	9,080	20,000	219,784	-	-
Llogarit ne FMN	11	214,090	90,162	-	58,411	65,517	-
		1,450,599	510,271	20,100	278,345	551,826	90,057
<i>Detyrimet jo-derivative</i>							
Ndaj bankave komerciale në vend	15	(414,942)	(414,942)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	(219,664)	(8,942)	-	(58,411)	(65,517)	(86,794)
Ndaj institucioneve qeveritare	17	(719,819)	(719,819)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	(52,167)	(52,167)	-	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	(2,266)	-	-	-	(907)	(1,359)
Detyrime tjera vendore	20	(756)	(756)	-	-	-	-
		(1,409,614)	(1,196,626)	-	(58,411)	(66,424)	(88,153)
		40,985	(686,355)	20,100	219,934	485,402	1,904

Tabela e mëparshme tregon rrjedhjet e parasë të pa-zbritura të detyrimeve financiare të BQK-së bazuar në mundësinë më të hershme të maturitetit të tyre kontraktual. Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK-ja mban mjete likuide që përfshijnë para dhe kuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhim i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet që përhapen në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe kreditë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtur nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin e investimeve.

Menaxhimi i rreziqeve të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në atë masë që pasuritë dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Mjetet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e riçmimit të indekseve të shumëllojshëm me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistent me strategjitë e veprimit të BQK-së. Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portfolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portfolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portfolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e rivlerësimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve.

Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portfolios jo të tregtueshme paraqitet tabelën e mëposhtme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

31 dhjetor 2020	Shënim	Neto vlera e	Më pak se	3-6	6-12	1-5 vite	mbi 5 vite
		bartur	3 muaj	muaj	muaj		
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	313,343	313,343	-	-	-	-
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	9	587,794	-	-	-	501,505	86,289
Depozita me bankat e huaja	10	58,324	8,388	-	49,936	-	-
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	11	187,828	76,176	-	-	111,652	-
Gjithsej		1,147,289	397,907	-	49,936	613,157	86,289
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(566,426)	(566,426)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(195,113)	(16,135)	-	-	(95,773)	(83,205)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(508,446)	(508,446)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(138,661)	(138,661)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(2,154)	-	-	-	-	(2,154)
Detyrime të tjera vendase	20	(756)	(756)	-	-	-	-
Gjithsej		(1,411,556)	(1,230,424)	-	-	(95,773)	(85,359)
Ndryshimi		(264,267)	(832,517)	-	49,936	517,384	930

31 dhjetor 2019	Shënim	Neto vlera e	Më pak se	3-6	6-12	1-5 vite	mbi 5 vite
		bartur	3 muaj	muaj	muaj		
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	108,863	108,863	-	-	-	-
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	9	576,616	-	100	150	486,309	90,057
Depozita me bankat e huaja	10	248,864	9,080	20,000	219,784	-	-
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	11	214,090	81,480	-	-	132,610	-
Gjithsej		1,148,433	199,423	20,100	219,934	618,919	90,057
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(414,942)	(414,942)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(219,664)	(8,942)	-	-	(123,928)	(86,794)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(719,819)	(719,819)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(52,167)	(52,167)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(2,266)	-	-	-	-	(2,266)
Detyrime të tjera vendase	20	(756)	(756)	-	-	-	-
Gjithsej		(1,409,614)	(1,196,626)	-	-	(123,928)	(89,060)
Ndryshimi		(261,181)	(997,203)	20,100	219,934	494,991	997

Pasuritë dhe detyrimet financiare që nuk bartin interes nuk janë të përfshira në tabelën më lartë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregtar i normave të interesit jo të tregtueshme menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të menaxhuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standard të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh bazë ("pb"). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

2020

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekt i parashikuar në fitim (humbje)	(2,643)	2,643

2019

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekt i parashikuar në fitim (humbje)	(2,612)	2,612

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutor të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj DVT lidhur me pasuritë dhe detyrimet e saj në FMN, të cilat i monitoron në vazhdueshmëri. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

2020

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekt i parashikuar në fitim (humbje)	(73)	73

2019

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekt i parashikuar në fitim (humbje)	(56)	56

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

31 dhjetor 2020	Euro	USD (Ekuivalent në Euro)	DVT (Ekuivalent në Euro)	Gjithsej neto vlera e bartur
Pasuritë				
Paraja e gatshme	308,090	-	-	308,090
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	313,170	173	-	313,343
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	587,794	-	-	587,794
Depozita me bankat e huaja	49,930	8,394	-	58,324
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	242	-	267,957	268,199
Mjetet e tjera	1,883	-	-	1,883
Gjithsej	1,261,109	8,567	267,957	1,537,633
Detyrime				
Detyrime ndaj bankave vendase	566,426	-	-	566,426
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	244	-	268,894	269,138
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	508,446	-	-	508,446
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	138,661	-	-	138,661
Nga huamarrja /et	-	-	2,154	2,154
Detyrime të tjera vendore	2,539	-	-	2,539
Gjithsej	1,216,316	-	271,048	1,487,364
Pozicioni neto për valuta të huaja	44,793	8,567	(3,091)	50,269
<hr/>				
31 dhjetor 2019	Euro	USD (Ekuivalent në Euro)	DVT (Ekuivalent në Euro)	Gjithsej neto vlera e bartur
Pasuritë				
Paraja e gatshme	302,166	-	-	302,166
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	108,615	248	-	108,863
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	576,616	-	-	576,616
Depozita me bankat e huaja	239,784	9,080	-	248,864
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	535	-	297,810	298,345
Pasuritë tjera	1,700	-	-	1,700
Gjithsej	1,229,416	9,328	297,810	1,536,554
Detyrimet				
Detyrime ndaj bankave vendase	414,942	-	-	414,942
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	541	-	296,695	297,236
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	719,819	-	-	719,819
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	52,167	-	-	52,167
Nga huamarrja/et	2,266	-	-	2,266
Detyrime të tjera vendore	1,778	-	-	1,778
Gjithsej	1,191,513	-	296,695	1,488,208
Pozicioni neto për valuta të huaja	37,903	9,328	1,115	48,346

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa monedhat e huaja me të cilat merret BQK-ja janë kryesisht “Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes” (“DVT”). Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 ishin si vijon:

	2020	2019
	Euro	Euro
1 DVT	1.18385	1.23588
1 USD	0.81493	0.89015

DVT-të janë pasuri rezervë shtesë si mbështetje në këmbimin/transaksionet e jashtme që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vete, ato përfaqësojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT-ve përcaktohet si mesatare e shportës së pesë valutave kryesore, euro, dollari amerikan, funta britanike, jeni japonez dhe renmindbi kinez.

USD-të janë mjete në llogari rrjedhëse dhe afatizime brenda natës (si repo) me Federal Reserve New York.

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BQK-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përveç rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullative si dhe standardet e pranuar gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative.

Objekivi i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional, si dhe dëshiron të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me menaxhimin e kostove efektive.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket çdo njësie organizative përmes stafit menaxhues të tyre. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për vlerësime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për menaxhimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve emergjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimin të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin, kur kjo është efektive.

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një program raportimi periodik i rishikuar prej Auditimit të Brendshëm. Gjetjet e vlerësimeve të Auditimit të Brendshëm diskutohen me menaxhimin e njësisë organizative me të cilën ato lidhen, me përmbledhjet e dorëzuara në Komitetin e Auditimit dhe menaxhmentin e BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Menaxhimi i kapitalit

Në përputhje me Ligjin, BQK-ja krijon dhe mban një rezervë të përgjithshme. Rezerva e përgjithshme nuk mund të përdoret, përveç për qëllime të mbulimit të humbjeve që pëson BQK-ja. Përveç kësaj, BQK-ja do të krijojë llogari të rezervës së rivlerësimit të përealizuara që të japin llogari për fitimet dhe humbjet e përealizuara për shkak të pozicioneve të saj me DVT.

Sipas Ligjit nr. 03/L-209, të ardhurat neto ose humbja neto e BQK-së llogariten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Fitimet në dispozicion për shpërndarje do të përcaktohen:

- duke zbritur nga fitimi neto, shumën totale të ardhurave të përealizuara të rivlerësimit, dhe duke ndarë një shumë ekuivalente në llogarinë përkatëse të përealizuara të rezervës së rivlerësimit, dhe
- duke zbritur nga llogaria e duhur e përealizuar e rezervës së rivlerësimit dhe duke shtuar në fitimet e shpërndara shumën e çfarëdo fitimi të përealizuar që është zbritur nga fitimi neto për një ose më shumë vitet e mëparshme dhe u realizuara gjatë vitit aktual financiar.

Humbjet e përealizuara nga rivlerësimi do të transferohen në llogaritë përkatëse rezervë të përealizuara të rivlerësimit deri në kohën kur këto llogari rezervë rivlerësimi kanë një bilanc zero, pasi që këto humbje do të mbulohen nga fitimi i vitit aktual, atëherë nga ana e rezervave të përgjithshme dhe më pas duke i autorizuar llogarisë kapitale.

Të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

(g) Menaxhimi i aseteve

Në pajtim me Ligjin 03/L-209 dhe Ligjin 03/L-048, BQK-së i është caktuar përgjegjësia për bërjen dhe menaxhimin e investimeve të autorizuar në emër të Ministrisë së Financave.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti diskuton me Bordin e Bankës Qendrore zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmërinë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat të caktuara.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shih shënimin 4).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Lejimet për humbjet kreditore

Mjetet e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen për të identifikuar rënien e mundëshme në vlerë të aktivitetit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(f)(vi). Përbërësit specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të mjeteve financiare të vlerësuara individualisht dhe bazohen në vlerësimin më të mirë të menaxhimit të vlerës aktuale të rrjedhjeve të pritshme të parasë që pritet të pranohen. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave, menaxhmenti gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali të vendosur. Çdo pasuri me rënie në vlerë, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavarur.

Pandemia COVID 19

Në dhjetor 2019, për herë të parë nga Kina erdhën lajmet për shpërthimin e virusit COVID-19. Me 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë duke e parë përhapjen e virusit me shpejtësi e cilësoi atë si pandemi. Qeveria e Republikës së Kosovës si gjithë qeveritë tjera nëpër botë, për ta ngadalësuar përhapjen e mundshme të virusit morën një sërë masash. U vendosën kufizime të ndryshme mbi aktivitetet brenda vendit. Kufizimet përfshijnë ndalimin e të gjitha udhëtimeve ndërkufitare, kufizimet mbi të gjitha udhëtimet brenda vendit gjatë orëve specifike, mbylljen e të gjithë transportit publik, ndalimin e të gjithë aktivitetit tregtar, përveç bizneseve specifike (sende ushqimore, farmacitë, bankat tregtare, pikat e karburantit, zyrat postare etj.). Masa këto të cilat rezultuan në një ngadalësim ekonomik në nivel global.

Në datën e këtyre pasqyrave financiare rezervat ndërkombëtare të bankës, të përbërë nga letra me vlerë të vlerësuara lartë dhe depozita bankare afatshkurtra, nuk janë ndikuar materialisht nga ngadalësim ekonomik në nivel global respektivisht përkeqësimi i kushteve të tregut.

Megjithatë ndikimi social dhe ekonomik i virusit COVID-19 dhe shtrirja e tij në nivel global që nga marsi i vitit 2020, mund të rezultojnë në rritje të pasigurisë në vlerësime dhe gjykime. Gjë që mund të kërkon rishikime të cilat mund të sjellin situata ku do të duhet të bëhen rregullime në vlerë kontabël të pasurive dhe detyrime brenda vitit të ardhshëm financiar. Sidoqoftë, pa pragjykuar efektin e tërësishëm global dhe vendor nga COVID-19, pritëshmeritë tona janë se këto situata/vlerësime të reja nuk do kenë efekte të themi materiale në zërat tonë financiar.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i pasurive dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që pasuritë dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e pasurive financiare si të mbajtura për tu arkëtuar, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për ti mbajtur mjetet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël 3 (h).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

6. Pasuritë dhe detyrimet financiare (klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të pasurive dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre.

31 dhjetor	Shënim	2020		2019	
		Kostoja e amortizuar	Vlera e drejtë	Kostoja e amortizuar	Vlera e drejtë
Paraja e gatshme	7	308,090	308,090	302,166	302,166
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	313,343	313,343	108,863	108,863
Letrat me vlerë	9	587,794	590,010	576,616	579,894
Depozita me bankat e huaja	10	58,324	58,324	248,864	248,864
Pasuritë lidhur me FMN	11	268,199	268,199	298,345	298,345
Pasuritë tjera	14	99	99	142	142
		1,535,849	1,538,065	1,534,996	1,538,274
Detyrime ndaj bankave vendase	15	566,426	566,426	414,942	414,942
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	269,138	269,138	297,236	297,236
